



**FRIEDRICH NAUMANN
FOUNDATION** For Freedom.
North Macedonia

METAMORPHOSIS 
Fondacion për internet dhe shoqëri

ANALIZA E **DEZINFORMATAVE** **LIDHUR ME COVID-19 NË** **MAQEDONINË E VERIUT**



Shkup
marsh
2021



**FRIEDRICH NAUMANN
FOUNDATION** For Freedom.
North Macedonia

METAMORPHOSIS 
Fondacion për internet dhe shoqëri

A n a l i z a

e dezinformatave
lidhur me Covid-19 në
Maqedoninë e Veriut

Shkup, marsh 2021

Impressum

Botues: Fondacioni për internet dhe shoqëri
"Metamorfozis" - Shkup

rr. Apostoll Gusllarov nr. 40, Shkup 1000,
Maqedonia e Veriut

<http://metamorphosis.org.mk>

Fondacioni për lirinë "Fridrih Nauman" (Friedrich
Naumann Foundaton for Freedom)

rr. Car Kallojan nr. 8, Sofje, Bullgari

<http://freiheit.org/bulgaria-north-macedonia>

Për botuesit:

Bardhyl Jashari, drejtor ekzekutiv, Fondacioni
"Metamorfozis"

Ivajllo Conev, koordinator projektsh Fondacioni për
lirinë "Fridrih Nauman"

Redaktor:

Filip Stojanovski

Autor:

Bardhyl Jashari, Filip Stojanovski, Vlladimir Petreski,
Elida Zulfeari, Teofil Bllazhevski, Bojan Bllazhevski,
Olivera Vojnovska, Suad Bajrami, Sasho Spasoski,
Silvana Zhezhova

Përkthimi dhe lektura në gjuhën shqipe:

Fatmir Sulejmani

Korrektor:

Valon Abdiu

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.776.23:[616.98:578.834(497.7)](047.31)

ANALIZA e dezinformatave lidhur me covid-19 në Maqedoninë e Veriut
[Електронски извор] / [autor Bardhyl Jashari ... [и др.] ; përkthimi në gjuhën
shqipe Fatmir Sulejmani]. - Shkup : Metamorfozis fondacioni, 2021

Начин на пристапување (URL): <https://www.metamorphosis.org.mk>. - Начин
на пристапување (URL): <http://freiheit.org/bulgaria-north-macedonia>. - Текст
во PDF формат, содржи 68 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. -
Опис на изворот на ден 09.05.2021. - Други автори: Filip Stojanovski, Vlladimir
Petreski, Elida Zulfeari, Teofil Bllazhevski, Bojan Bllazhevski, Olivera Vojnovska,
Suad Bajrami, Sasho Spasoski, Silvana Zhezhova

ISBN 978-608-263-052-6

1. Jashari, Bardhyl [автор] 2. Stojanovski, Filip [автор] 3. Petreski, Vlladimir
[автор] 4. Zulfeari, Elida [автор] 5. Bllazhevski, Teofil [автор] 6. Bllazhevski,
Bojan [автор] 7. Vojnovska, Olivera [автор] 8.
Bajrami, Suad [автор] 9. Spasoski, Sasho [автор] 10. Zhezhova, Silvana [автор]
а) Ковид-19 -- Дезинформации -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 54109189

Vërejtje lidhur me shfrytëzimin e këtij botimi

Ky botim është servis informativ i Fondacionit për liri "Fridrih Nauman" dhe Fondacionit "Metamorfozis" nga Shkupi. Ky botim është gratis dhe nuk guxon të shitet. Pikëpamjet e shpërfaqura në këtë botim janë në përgjegjësinë e autorëve dhe jo domosdoshmërisht i pasqyrojnë pikëpamjet e Fondacionit për liri "Fridrih Nauman".

Licenca

Përmbajtjet e këtij botimi janë botuar me licencën "Krijativ komons:
Përmend fjalën" <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>
– Lejohet shpërndarja e tyre, kopjimi dhe ridistribuiimi, si adaptim,
me kushtin e vetëm që të theksohet burimi dhe botuesit.



PËRMBAJTJA

Për botuesit	6
Rezimeja finale	7
1. Hyrje	8
2. Përkufizimi i problemit të dezinformatave	10
2.1. Prijetet e dezinformatave kryesore lidhur me Covid-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut	13
2.2. Pasqyra e hulumtimeve të arritshme dhe dokumenteve për politikave të hapura	18
2.3. Pasqyra e politikave të hapura lidhur me infomediet	23
2.4. Kornizat ligjore lidhur me pandeminë	25
2.5. Mekanizmat për vetërregullimin e medieve në kushte pandemie	27
3. Mësimet e nxëna	28
3.1. Roli i institucioneve shtetërore si burim i informacionesh për Covid-19	28
3.2. Roli i institucioneve shëndetësore dhe punonjësve shëndetësor	33
3.3. Roli i partive politike	37
3.4. Roli i sektorit privat	40
3.5. Roli i shoqërisë qytetare	42
3.6. Roli i bashkësisë akademike	46
3.7. Roli i sistemit shtetëror për arsimin formal	47
3.8. Roli i platformave të medieve sociale	49
3.9. Specifikat e lidhura me karakterin multikulturor të Maqedonisë së Veriut	54
3.10. Dezinformata përtej kufirit	56
3.11. Roli i organizateve të donatorëve dhe bashkësisë ndërkombëtare	58
4. Këshilla	59
Bibliografia	66

Shkurtesa

ASHAAM	Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediale
OQ	Organizata Qytetare ose Organizatat Qytetare
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
ASHAM	Akademia e shkencës dhe e arteve e Maqedonisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
IMM	Instituti Maqedonas për Mediume
MSHIA	Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
FRA	Forumi Rinor i Arsimit
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
KEMM	Këshilli për Etikë në Mediet e Maqedonisë
SPGPM	Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe punonjësve Medialë
OBSSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
UKIM	Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij"
FB	Fejsbuk (Facebook)
RNVF	Rrjeti Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve (IFCN – International Fact-Checking Network)



PËR BOTUESIT



**FRIEDRICH NAUMANN
FOUNDATION** For Freedom.
North Macedonia

METAMORPHOSIS 
Fondacion për internet dhe shoqëri

Fondacioni për lirinë “Fridrih Nauman” Zyra projektuese për Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut

Fondacioni për lirinë “Fridrih Nauman” është fondacion politik gjerman, i cili i promovon pilitikat e hapura liberale dhe dijen politike në mbi 60 vende të botës, me qëllim të konsolidimit të demokracisë liberale dhe ndërtimit të shoqërive të lira dhe të prosperitetshme. Në Maqedoninë e Veriut fokusi kryesor i punës së Fondacioni për lirinë “Fridrih Nauman” është promovimi i demokracisë, sundimi i së drejtës, risitë, liria e medieve, si dhe ndërtimi i kapaciteteve nëpërmjet partneriteteve kolaborative me palët e prekura lokale. Instrumentet standarde përfshijnë edukimin politik, përkrahjen e procesit të krijimit të politikave publike, si dhe dialogun politik. Nëpërmjet ngjarjeve dhe publikimeve tona, kemi për qëllim që ta ndihmojmë informimin më cilësor dhe ta rrisim angazhimin shoqëror të qytetarëve.

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis”

Fondacioni “Metamorfozis” është themeluar në Shkup në vitin 2004 dhe udhëhiqet nga vizioni për shoqëri në të cilën qytetarët e angazhuar dhe të vetëdijshëm shërbejnë në mënyrë aktive me mjete të reja për realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tyre qytetare, shoqëri në të cilën ata janë të kujdesshëm në raport me ndikimin dhe kërkimin e përgjegjësive nga pushteti, duke siguruar sundimin e përgatitur dhe të përgjegjshëm të demokracisë. Misioni i tij është forcimi i vetëdijes dhe kapaciteteve të qytetarëve dhe shoqërisë qytetare për ta fituar rolin më të mirë të mundshëm si aktivistë të demokracisë, duke i përkrahur institucionet shtetërore për ta kryer detyrën e tyre demokratike – punën në shërbim të shoqërisë.



REZIMEJA PËRFUNDIMTARE

Përse një numër shumë i madh qytetarësh, por edhe gazetarësh, politikanësh, profesorësh dhe personalitetesh tjera publike, ranë nën ndikimin e dezinformatave lidhur me Covid-19 gjer në atë shkallë sa edhe vetë luajtën rol aktiv në përhapjen, ndryshimin dhe shpërndarjen, riaftësimin dhe trillimin e tyre?

Kjo dukuri që paraqet problem të nivelit botëror, në veçanti u shpreh në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në shoqërinë ekstremisht të polarizuar, ku niveli i lirisë së medie dhe kultura politike janë të mbarsura me pasojat e periudhës së shtetit të zënë peng nga propaganda e pandërprerë populiste.

Studimi “Analiza e dezinformatave të lidhura me Covid-19 në Maqedoninë e Veriut” bën ndërprerjen e prirjeve të dezinformatave që i pengojnë përpjekjet për ndaljen e përhapjes së pandemisë gjatë vitit 2020 dhe i forcon faktorët që i kontribuojnë varshmërisë së qytetarëve ndaj manipulimeve të llojlojshme mediatike e politike, si dhe teorive konspirative dhe keqpërdorimeve komerciale të frikës nëpërmjet pseudomjekëve. Si kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, RMV ka karakteristika të ngjashme me vendet në tranzicion, që nga nevoja e madhe për reforma dhe modernizim të sistemit arsimor dhe përtëritja e sistemit shëndetësor si bazë për kthimin e besimit në institucionet shtetërore.

Shqyrtimet dhe udhëzimet e fituara prej këtij studimi kanë rëndësi më të gjerë, sepse janë të zbatueshme në të gjitha meset me kushte të ngjashme, por edhe në demokracitë e zhvilluara që rrezikohen nga prapaktimi nëse lejohet marrja e pushtetit nga lëvizjet jodemokratike, joliberalë dhe ekstreme, që si armë politike e shfrytëzojnë frikësimin.

Nëpërmjet analizës kuantitative dhe kualitative të pothuajse pesëqind artikujve dhe ligjëratave konkrete

shkencore, studimi ofron kahje sesi një shoqëri, nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të të gjithë faktorëve, si dhe nëpërmjet shfrytëzimit të anëve të forta të sektorit shtetëror, bashkësisë akademike, medie, shoqërisë qytetare dhe angazhimit të shtuar të vetë qytetarëve, me shfrytëzimin e mjeteve digjitale duhet ta kundërshtojë infodeminë dhe ta mbrojë shëndetin dhe jetën e më të afërmve.

Në këtë rast, me rëndësi vendimtare është theksimi i domosdoshmërisë së qasjes sistematike për kultivimin e kulturës së mendimit të lirë dhe dialogut shoqëror në të gjitha nivelet. Duke e pasur parasysh polarizimin e lartë, gjatë përgatitjes së intervenimit kundër dezinformatave është me rëndësi të sillen vendime të mbështetura në fakte me shtimin e rolit të gazetarëve dhe shkencëtarëve.

Kjo analizë e përgatitur dhe e zbatuar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet fondacioneve “Fridrih Nauman” dhe “Metamorfozis” mbështetet në përvojat e drejtpërdrejta të projekteve “Me mendim kritik gjer te qytetarët me shkathtësi mediatike – Kri Think”, shërbimin për verifikimin e fakteve “Vërtetmatës”, agjencinë e lajmeve Meta.mk dhe portalin për lajme në gjuhë shqipe Portalb.mk, si dhe në informacionet për aktivitete të gjithë faktorëve të përmendur, të cilët në periudhën e kaluar, iu kundërvunë infodemisë në mënyra të ndryshme.

Paraprakisht, të dy organizatat bashkëpunuan gjatë lokalizimit të hulumtimit “Pas perdeve të lëshuara” në gjuhën maqedonase dhe shqipe, me qëllim të mundësimit të qasjes së publikut nga Maqedonia e Veriut te vetëdija për atë sesi shfrytëzohen teknologjitë e reja, përkatësisht platformat për komunikim me porosi të shkurta për përhapjen e dezinformatave.¹



HYRJE

Lajmet e ditëpërditshme për qindra të infektuar të rinj dhe të vdekur prej Kovid-19 nuk pushojnë ta trazojnë publikun maqedonas, veçanërisht kur bëhet fjalë për mese më të vogla ku numri duket joproporcional në raport me numrin e popullatës lokale, kundrejt Shkupit si kryeqytet. Mjekët e atyre meseve thonë se shpërthimet e këtilla janë pasojë e mosrespektimit kryeneç të masave mbrojtëse prej koronavirusit të ri dhe apeleve drejtuar bashkëqytetarëve për të shmangur grupimet nëpër tubime familjare dhe për të mbajtur maskat. Ndërkohë, qytetarët që luajnë rolin e shpërndarësve potencialë dhe të mundshëm të virusit, gjejnë arsyeime për sjelljet e tyre ndaj korpusit të dezinformatave në rritje me të cilat bombardohen të gjithë.

Qëllimi i këtij studimi është rritja e qëndrueshmërisë së opinionit në Maqedoninë e Veriut ndaj fushatave dezinformuese dhe formave të tjera të manipulimeve mediatike të lidhura me pandeminë e Kovid-19 nëpërmjet prodhimit dhe promovimit të analizës së dezinformatave.

Studimi i dokumenton dhe analizon tiparet e dezinformatave lidhur me Kovid-19 në Maqedoninë e Veriut, me përqendrim në grupet kryesore të synuara të qytetarëve, si pikënisje për zhvillimin e udhëzimeve për politika të hapura dhe për materiale edukative. Ekipi i “Metamorfozis” filloi me analizat e dezinformatave që nga fillimi i pandemisë, kurse “Vërtetmatës” ishte pjesë e grupit iniciativ të Rrjetit ndërkombëtar për verifikimin e fakteve (RNVF), që në janar të vitit 2020 e formoi aleancën për fakte për koronavirusin (#CoronaVirus Facts Alliance), iniciativën më të madhe të përbashkët në këtë fushë në nivel global, të cilës gjatë vitit të ardhshëm iu bashkangjiten 99 organizata të më shumë se 70 vendeve.



“Informata e gabuar i zvogëlon përpjekjet për pengimin e përhapjes së një sëmundjeje infektive, kudo që të përhapet, e siç duket dezinformatat përhapen më shpejtë se vetë sëmundja”, deklaroi Margaret Haris, zëdhënësjja e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe mjekja e cila ka ndihmuar luftën me ebolën në Kongo, kurse tani punon për të mposhtur Kovid-19. “Kjo mund të kushtëzojë sjelljet e rrezikshme, që e rrisin mundësinë për infektim ose e pamundësojnë shpëtimin e jetëve nëpërmjet intervenimit medicinal në kohën e duhur”.²

Përvojat e luftës kundër dezinformatave dëshmojnë se është e nevojshme sinergjia e më shumë qasjeve dhe metodologjive – verifikimi i fakteve, edukimi mediatik dhe mendimi kritik, lajmet ditore gazetareske në të cilat vetëdijshëm janë ndërthurrur këto vlera si dhe rrjetëzimi në nivel lokal, kombëtar dhe regjional si mjet për ndërtimin e kapaciteteve dhe punës së përbashkët.

Përkundër të dhënës se “Metamorfozis” paralajmëroi trendin e rritjes së dezinformatave dhe manipulimeve mediatike qysh në vitin 2011, kur edhe nisi aktivitetet për ballafaqimin me efektet e tyre në sferën publike, spinet dhe propaganda, që viteve të fundit u bënë trend i rëndësishëm global, në publikun maqedonas nuk njiheshin si kërcënime serioze për demokracinë. Edhe pse kohëve të fundit këto tema janë më prezente në diskursin publik, shpesh përpunohen sipërfaqësisht dhe në mënyrë jogjithëpërfshirëse, me abstenim të më shumë faktorëve të rëndësishëm dhe me “heshtje të zëshme” të autoriteteve të njëjta institucionesh të lidhura me nevojën e reformave, të cilat janë pjesë e procesit të aderimit në Bashkimin Evropian me qëllim të tejkalimit të politizimit dhe partizimit të tyre.

Tregues i asaj situate është ajo që për një numër të madh të termave të kësaj sfere nuk ekziston përkthim zyrtar në gjuhën maqedonase, që ndërlidhet me shkallën e diskutimeve të ngritura edhe me reagimet e autoriteteve. Gjegjesisht, ndërsa për fjalën „disinformation“ ekziston përkthimi i drejtpërdrejtë “dezinformim”³ (i sqaruar si i kundërt me informatën e saktë, që në literaturën e huaj ka edhe elemente të gënjeshtrës së qëllimshme), për termin më të gjerë „misinformation“ nuk ka përkthim zyrtar, ndaj faktorë të ndryshëm shfrytëzojnë zgjidhje të ndryshme përshkruese, si lajme, informacione ose qëndrime të “pasakta” ose të “pavërteta”, që s’është e thënë të jenë të qëllimshme.

Analiza e dezinformatave të lidhura me pandeminë Kovid-19 tregon se fuqia e tyre varet nga faktorët ekzistues shoqërorë, që janë të përshtatshëm për përhapjen e formave të ndryshme të manipulimit (kohezioni shoqëror, niveli i arsimit, besimi në institucione, shkalla e respektimit të të drejtave njerëzore, përfshirë dhe lirinë e shprehjes) dhe nga e

dhëna se në Republikën e Maqedonisë së Veriut tanimë qenë krijuar kushtet e përshtatshme për përhapjen e infodemisë edhe nëpërmjet strukturave ekzistuese propagandistike (të lidhura me abuzimin në kontekst lokal politik) edhe nëpërmjet rrjeteve sociale nga ana e personave dhe grupeve pa ndonjë lidhje me qendrat e forcës. Një numër i jashtëzakonshëm i dezinformatave nuk ishin origjinale, por të importuara nga sfera globale mediatike ose ishin dezinformata ndërkufitare, që u përhapën në rajonin e Ballkanit.

Për përhapjen e dezinformatave është veçanërisht e përshtatshme situata në të cilën një pjesë e madhe e popullsisë është mësuar të mendojë se anshmëria politike është më e rëndësishme se e vërteta. Gjatë kësaj perceptimi më i shpeshtë i gabuar për ndonjë përfitim ideologjik ose partiako-politik është kriteri kryesor për të vlerësuar format e reagimit në situatat në të cilat qytetari është i vetëdijshëm në mënyrë racionale se i ofrohen përmbajtje të pasakta, gjysmë të sakta ose të ngatërruara. Një pjesë e madhe e qytetarëve i kuptojnë manipulimet, por refuzojnë t’i pranojnë vlerat e të drejtave të njeriut dhe interesin publik si prioritet në marrëdhëniet e tyre me to.

Verifikimi i fakteve edhe si lloj i veçantë gazetarie edhe si aktivitet që është pjesë integrale e raportimeve ditore është i domosdoshëm në kësi situatash, por u dëshmuar se nuk është i mjaftueshëm për t’u mbuluar të gjithë aspektet e “infodemisë”. Përballja me këtë problem duhet të kombinohet me edukimin mediatik, në të cilin bën pjesë edhe edukimi digjital, por edhe informimi për funksionimin e shkencës, mjekësisë dhe sistemeve të përshtatura shtetërore për publik të ndryshëm, që e kanë humbur besimin tek sistemi. Transparenca komplete e institucioneve shtetërore dhe bashkëpunimi me mediet, që gjithashtu kanë nevojë për forcimin e kapaciteteve, paraqesin bazë për formimin e vijës së parë të mbrojtjes nga dezinformatat për Kovid-19.

Në afat më të gjatë, problemet e këtilla mund të zgjidhen vetëm me ndryshime të thella të sistemit arsimor, kornizave ligjore dhe rrethanave ekonomike në të cilat punojnë mediet, si dhe me zvogëlimin e shkallës së korrupsionit dhe rritjes së shkallës së kohezionit në shoqëri.



2

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT TË DEZINFORMATAVE

Teoritë konspirative, dezinformatat dhe propaganda nuk janë dukuri e re. Ato janë përhapur gjithmonë, veçanërisht kur ndodhnin ngjarje negative, dukuri të reja ose pjesërisht të panjohura. Pikërisht kjo po ndodh me rastin e pandemisë Kovid-19. Për ta kuptuar dhe për t'i dhënë kuptim zhvillimit të panjohur të ngjarjeve dhe ndryshimeve përreth vetes, njerëzit e dëshpëruar janë përpjekur prora ta gjejnë "shkakun" ose të identifikojnë dikë ose diçka që është fajtorë për paraqitjen e sëmundjes. Kjo që ndodh sot është shumë e ngjashme me reagimet e njerëzve në të shkuarën kur paraqiteshin sëmundje – megjithatë, ajo që ka ndryshuar nga, bie fjala, pandemia e fundit zyrtare e shpallur në vitin 2009 me H1N1 (gripi i derrave) nuk është vetëm numri i rasteve dhe vendeve në të cilat ndikoi virusi, por edhe zhvillimi teknologjik i medieve sociale dhe ekzistimi i eko-sistemit *online* të forcave djathtiste të botës.

Problemi i dezinformatave nuk janë sot vetëm ueb-faqet e rreme dhe faqet që prodhojnë vizita, klikime dhe *like* me tituj dhe përmbajtje *klikbejt*. Ai shkon përtej kësaj, dhe shpesh lidhet me struktura politike djathtiste e populiste (parti politike, qeveri), që e eksploatojnë rrjetin personal mediatic dhe ndikimin për të përhapur dezinformata për burimet dhe prejardhjen e krizës nëpërmjet fushatës së fortë të komunikimit, duke ua hedhur fajin të tjerëve për dështimet personale në ballafaqimin me krizën. Në Maqedoninë e Veriut, një numër i madh ueb-faqesh, faqesh në FB dhe profilesh qenë instrumente për përhapjen e dezinformatave të këtij lloji dhe pjesë e fushatave të bëra nga mediet që janë nën ndikimin e partive politike.

Karakteristikat e problemit me dezinformatat për Kovid-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Faktorët kryesorë që e mundësojnë përhapjen e dezinformatave në sferën publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë: kohezioni i ulët shoqëror, niveli i ulët i arsimimit dhe besimit në institucionet e sistemit, si dhe kualiteti i ulët i prodhimit mediatic. Faktori i fundit buron nga ndikimi politik në sferën mediaticke, si dhe biznes-modeli i medieve në kushtet e krizës disadecadëshe ekonomike që thekson popullaritetin (klikimet dhe format e ndikimit), që nxit sensacionalizmin, jo finansimin që përfshin transparencën ndaj publikut dhe kualitetin sipas kriterëve profesionale.

Në RMV, aktivitetet dezinformative i shfrytëzojnë faktorët strukturorë që shpiejnë deri te nënshtrimi i popullatës ndaj rrëfimeve alternative (ndërmjet tjerash edhe teorive të konspiracionit). Ato e shfrytëzojnë dhe thellojnë nivelin e ulët të besimit në institucionet e sistemit, si dhe format e ndryshme të përçarjes së shoqërisë në baza fetare, ideologjike, kombëtare dhe në vija të tjera.

Niveli i ulët i investimeve në forcimin e kapaciteteve të redaksive të medieve sjell mbështetjen e një pjese të madhe të prodhimit mediatic nga pirateria – kopjimin e përmbajtjeve nga mediet tjera nga vendi dhe bota, pa përmendur burimet, por dhe pa verifikimin elementar të fakteve, që duhet të jenë pjesë integrale e procesit gazetaresk. Kështu një pjesë e medieve luajnë rolin e forcuesve të manipulimeve të botuara nga burimet ose mediet tjera të cilat i piratizojnë.

Faktor i rëndësishëm është e dhëna se në Maqedoninë e Veriut niveli i edukimit mediatik dhe mendimit kritik si shkathtësi jetësore është relativisht i ulët, kurse zhvillimi i tyre nuk është pjesë e arsimimit formal. E njëjta vlen edhe për edukimin digjital, që përfshin jo vetëm njohuritë teknike për shfrytëzimin e sistemeve informatike, por edhe vetëdijësimin për implikimet e tyre shoqërore, veçanërisht në kontekst të drejtave njerëzore të shfrytëzuesve. Ky është konkluzioni përfundimtar i shumë hulumtimeve të bëra edhe në nivel kombëtar edhe në nivel rajonal, të elaboruara në pjesën 2.2.

Mbindërtimi i praktikave ekzistuese, manipulimet dhe dezinformatat për Kovid-19

Rrjetet ekzistuese propagandistike të krijuara ndërmjet viteveve 2006 dhe 2017, pjesë e të cilave ishin dhe grupimet mediatike të lidhura me partitë politike që asokohe ishin në pushtet, si dhe rrjetet e trolleve partiake, luajnë role të rëndësishme edhe në përhapjen e dezinformatave të lidhura me pandeminë, duke i modifikuar ato me qëllim të pengimit dhe sabotimit të përpjekjeve shtetërore. Rrërimi i besimit në sistem si armë për fitimin e pikëve politike, hedhja e fajit për gjendjen mbi kundërshtarin politik u bë dukuri e rëndomtë.

Shembull konkret për përhapjen e dezinformatave nga ana e strukturave politike dhe burimeve vendore dhe raportit të përgatitur për Parlamentin Evropian është partia VMRO-DPMNE, që gjatë vitit 2020 pati rolin e partisë më të madhe opozitare në shtet. Kjo strukturë politike që nga fillimi i pandemisë/epidemisë në RMV përhap në kontinuitet (dez)informata se pushteti politik shëndetësor e drejton gabimisht procesin e parandalimit dhe shërimit nga Kovid-19. Pavarësisht fakteve, gjatë gjithë këtyre muajve, në vazhdimësi, që nga mesi i marsit deri në fund të vitit 2020, ata shfrytëzuan në hapësirën publike fjalët: “të paaftë”, “komisioni politik” (mendohet në komisionin ekzistues për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse), deri të “ministri për infektim dhe vdekje” (mendohet për ministrin e shëndetësisë). Këto kualifikime që shpiejnë tek dezinformatat sipas të cilave pushteti politik e shëndetësor nuk janë të aftë ta mbrojnë shëndetin e qytetarëve, forcoheshin edhe me dezinformata konkrete si: “mungojnë mjetet mbrojtëse për punonjësit shëndetësor”, “nuk ka respiratorë, kurse pushteti u furnizua me respiratorë të rinj në mënyrë korruptive”, “mungojnë testet për koronavirusin” dhe “protokollet e gabuara për shërim” ose “nuk ka protokolle për shërim”, “rekorderë me vdekjet e të sëmurëve nga Kovid-19” etj.⁴

Dezinformatat e këtilla në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jokritike janë bartur në medie. Më shpesh në mediet onlajn të afërta me këtë ose me strukturat tjera politike opozitare. Por, si dezinformata të përcjellura nëpër konferencat e rregullta të shtypit ose në Kuvend, përhapen edhe në hapësirën e gjerë mediatike edhe nga ana e televizionit dhe radiove.

Në kundërshtim me standardet gazetareske, këto transmetime bëheshin shpeshherë pa e respektuar palën tjetër dhe verifikimin e thënieve me arsyetime të lloj-llojshme të tipit: “informata e përcjellur në kohë reale”, përmbajtje informative e tipit “janë lajme, ndaj patjetër të transmetohen”. Në vend të verifikimit gazetaresk, opinioni zakonisht bënte polemikë me përgjigjet e të dhënave në konferenca shtypi të institucioneve ose të personave drejtues të transmetuara me vonesë disa orëshe. Në rastin më të mirë verifikimi bëhej ditën e njëjtë me hulumtimin e pavarur dhe kërkimin e anës tjetër të lajmit, kurse në rastin më të keq me neglizhimin redaktorial të palës së dytë, madje edhe kur ajo u përcillej medieve në formë të konferencave të shtypit nga autoritetet shëndetësore ose shtetërore.

Simbioza e këtyre mes politikës dhe medieve sjell gjer te mbizotërimi i dezinformatave në hapësirën bujlike, sepse të transmetuara në mediet e zakonshme ose ato online, përhapen pastaj natyrshëm, kurse, jo rrallë edhe me qëllim nëpërmjet rrjeteve sociale, me çka lufta kundër dezinformatave ngadalësohet në mënyrë të dukshme dhe bëhet shumë e vështirë.

Një pjesë e madhe e medieve sensacionaliste, gjithashtu, promovon manipulime mediatike në lidhje me pandeminë si mjet për të tërhequr klikime, të cilat pastaj i shndërron në para nëpërmjet reklamave online ose nëpërmjet marrëveshjeve me kompanitë për marketing, që kërkojnë nivel të lartë të ndjekësve.

Dezinformatat për Kovid -19 i përhapin po ata që janë pjesë e rrjetit të themeluar për përhapjen e dezinformatave për secilën temë e cila ka të bëjë me lëvizjen e shtetit përpara, me emrin, me integrimet në BE, NATO dhe të ngjashme.

Interneti mundësoi mënyra edhe më të rrezikshme për faktorët e këtyre, por edhe për oportunistët tjerë, pika nismëtare e të cilëve është shkasi komercial, përfitimi nga kriza nëpërmjet mbledhjes së pikëve politike dhe nëpërmjet zgjerimit të publikut të vet (kapitalit social – numrit të ndjekësve në rrjetet sociale ose lexuesve nëpërmjet klikbejt-it), që sjell në derdhjen konkrete të parave nga reklamat dhe sponsorizimet prej entiteteve politike ose private.

Ende më i rëndësishëm është përqendrimi në **teknologjinë e qeverisjes nëpërmjet frikësimit**, që promovohet nga qarqe ekstremiste dhe populiste të djathtistëve të shteteve ish-jugosllave, qysh nga fundit i viteve të tetëdhjeta, që gjatë tri dekadave të fundit u shndërrua në *mejnstrim* edhe në jetën politike të RMV, ku u përkrah nga një pjesë e madhe e popullatës si “normale” dhe e dëshiruar. (Metoda të ngjashme të qeverisjes zbatohen edhe jashtë Ballkanit, p.sh.: nga regjimet joliberales të Evropës Qendrore dhe të SHBA-së, me narracione raciste të lidhura me Luftën qytetare të shekullit XIX dhe Qanon, si dhe një sërë vendesh të tjera si: Brazili, Rusia, India...).

Kur njëanshmëria politike është më e rëndësishme se e vërteta

Njerëzit nisin të mendojnë në korniza të ngushta nga frika e invazionit të fqinjëve ose nga lufta qytetare. Kurse të papërshtatshmit në aspektin politik i konsiderojnë si tradhëtarë, duke i zbatuar me lehtësi skemat e njëjta si ato në raport me pandeminë e politizuar.

Njerëzit që destabilizimin e kundërshtarit të perceptuar politik nëpërmjet përhapjes së frikës dhe dezinformatave e konsiderojnë legjitime dhe si armë politike, kurse veten e konsiderojnë si ushtarë të një “luftë të qetë qytetare” (me të cilën vazhdojnë betejën për korrigjimin e padrejtësive të së shkuarës) verifikimin e fakteve dhe formave të tjera të gazetarisë profesionale e konsiderojnë si aktivitet armiqësor. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me “ushtarët partiakë”, por edhe me një rreth më të gjerë njerëzish të motivuar jo vetëm me lojalitetin ndaj të “vetëve”, por edhe me urrejtjen ndaj të “tjerëve”.

Në kuadër të politikës kulturore, vetëdija për nevojën e sjelljes së vendimeve të mbështetura në analizën logjike të të dhënave të mbledhura empirike ekziston vetëm në nivelin teorik, kurse në praktikë mendimi kritik shfrytëzohet vetëm si formë e sufizmit gjatë sulmit të pozicioneve të kundërshtarit politik ose ideologjik.

Analiza e komenteve në “Facebook” me të cilët reagojnë qytetarët për verifikimin e fakteve flet se për njerëzit e mësuar me këtë lloj funksionimi të sferës politike dhe mediatike, **anshmëria politike është më e rëndësishme se e vërteta**. Në formën e saj të thjeshtë në RMV, përkatësia politike ka të bëjë me lidhjen me një parti të caktuar dhe/ose me urrejtjen e një partie të caktuar.

Dinamika e përhapjes së dezinformatave tregon se qytetarët identifikohen edhe me lëvizje aktive politike në vendet e huaja edhe me ideologjitë e tyre, sidomos nëse qarqet partiake në mënyrë zyrtare apo jozyrtare kanë lidhje me ta.

Pranueshmëria e përhershme e opinionit vendor për dezinformatat për Covid-19 do të mund t’i përshkruhej gjithsesi edhe ofenzivës së gjatë të antivaksinistëve, të cilët më intenzivisht se në vitin 2015 nisën të bëjnë postime dhe tekste për dëmet nga vaksinat. Te një pjesë e madhe e opinionit ky “bombardim” gjithsesi kontribuoi për përkrahjen e konsiderueshme të teorive të konspiracionit, në versionin e ndryshimit të nënvetëdijshëm të bindjeve nëpërmjet reçetës “rrena e përsërritur 100 herë bëhet e vërtetë”.

Kjo tendencë është e lidhur edhe me format tjera për krijimin e mosbesimit në sistemin shëndetësor të mbështetur në shkencë, nga promovimi i pseudomjekësisë si “mjekësi alternative”, deri te riafirmimi i ritualeve religjioze ose magjive të shëruesve popullorë, si zëvendësim i shërimit nëpër repartet mjekësore. Qëndrimet e këtilla imponohen nëpërmjet medieve dhe rrjeteve sociale, sidomos tek njerëzit e shtresave më të varfëra, të cilët nuk mund t’ia lejojnë vetës shërimin në institucionet private shëndetësore, për të cilat është krijuar perceptimi se janë më kualitative se ato shtetërore.

2.1. Tendencat kryesore të dezinformatave të lidhura me Kovid-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Për nevojat e këtij studimi, ekipi i "Metamorfozis" bëri analizën e pothuajse pesëqind (479) artikujve antidezinformativë, prej të cilëve 391 drejtëpërsëdrejti kishin të bëjnë me zbulimin e dezinformatave të lidhura me pandeminë, që u publikuan si verifikim faktesh dhe si artikuj analitikë nga "KriThink-u" (138) dhe "Vërtetmatës-i" (139) ose ishin pjesë integrale e informimit të përditshëm nga "Meta.mk" dhe "Portalb"(114).

Zgjedhja e rasteve që u përfshinë në mostrën e artikujve është bërë sipas kriterëve që lidhen me pohimet që përmbajnë fakte të verifikueshme, përkatësisht me ato të dhëna, që mund të verifikohen me metoda profesionale gazetareske. Kriter tjetër për zgjedhje ishte viraliteti i botimeve – çfarë jehone kanë te opinioni ose në rrjetet sociale, si dhe niveli i vlerësuar i dëmit potencial që mund ta shkaktojë dezinformatat konkrete. Një pjesë e këtyre përmbajtjeve u identifikuan prej verifikuesve të fakteve nëpërmjet mjeteve softuerike



Milosh Dragojevi,
"Strip kundër diktaturës"⁵



By MILOŠ

dhe aplikacioneve për zbulimin e viralitetit (p.sh. Crowd Tangle), në kombinim me përvojën shumëvjeçare gazetareske me qëllim të arritjes të efektit më të madh dhe ballafaqimit me dezinformatat më të dëmshme, të lidhura me pandeminë globale, kur dezinformatat mund të shkaktojnë përhapjen e infektimit, madje edhe humbje jete të njerëzve.

Mostra e këtyllë e artikujve nuk është gjithëpërfshirëse, sepse numri i përgjithshëm i përmbajtjeve dezinformuese është me qindra mijëra dhe do të nevojiteshin resurse të jashtëzakonshme për “regjistrim” dhe analizim. Duke e pasur parasysh se një pjesë e madhe e dezinformatave janë kopje ose mutacione minimale të përmbajtjeve tashmë të publikuara, mostra jep fotografinë e qartë të rrethanëve në terren, sepse mbështetet në zgjedhjen e ekipeve profesionale (gazetarëve dhe ekspertëve për të drejta digjitale) sipas kriterëve të ndikimit në opinion, përkatësisht viralitetit në rrjetet sociale.

Nga aspekti i mendimit kritik, përhapja e dezinformatave për pandeminë gjatë vitit 2020 kryesisht mbështetet në disa teknika propagandistike dhe manipulative, përkatësisht në eksploatimin e gabimeve logjike si: thirrja në autoritet (ang. appeal to authority), sulmi i personaliteteve (ad hominem), analogjitë dhe metaforat e gabuara si terren i rrëshqitshëm (slippery slope fallacy), keqpërdorimi i përhershëm i anshmërive dhe animoziteteve, si dhe qasja ndaj “dëshmisë shoqërore” (social proof) – ajo që është e popullarizuar me gjasë është e vërtetë/ e rëndësishme (me pritje që përhapja e përmbajtjeve të ndikojë në popullaritetin e transmetuesit – mediumit ose shfrytëzuesit të rrjetit social).

Prejardhja e storjeve keqinformuese


Për gati një të tretën e dezinformatave për Covid-19, të transmetuara nëpërmjet medieve dhe rrjeteve sociale të RMV, mund të konstatohej se nuk ishin origjinale, por përfaqësonin versionet e përshtatura të rrëfimeve që qarkullojnë nëpër gjithë botën, kurse kryesisht vijnë nga SHBA, vendet e BE, Rusia dhe Kina. Rreth një e treta e dezinformatave të mostrës ishin marë nëpërmjet transmetimeve sekundare nga rajoni i Ballkanit, bashkë me dezinformatat nga vendet fqinje, të sajuara kryesisht nga autoritetet e atjeshme politike ose entitetet antishkencore (mjekët popullore dhe njerëzit që janë kundër vaksinës).

Dezinformatat e sajuara brenda vendit kryesisht kanë të bëjnë me diskreditime dhe zënka mes partive politike në nivel kombëtar, përkatësisht mes opozitës dhe pushtetit, të lidhura kryesisht me masat mbrojtëse dhe efikasitetin e zbatimit të tyre, si dhe me katranosjen e BE-së (dhe në mënyrë implicite të NATO-s, gjegjësisht “Perëndimit”). Përveç masave, një numër i madh i manipulimeve politike qenë të lidhura edhe me zgjedhjet në RMV, zgjedhjet në SHBA, ose qenë shprehje e propagandës nga Serbia, shpesh të lidhura me zgjedhjet e atjeshme.

Fija e përbashkët e gati një të tretës (32%) së dezinformatave të hulumtuara ishte përpjekja për t'u shkatërruar tanimë besimi i dobët në sistemin shtetëror, nëpërmjet krijimit sensibilizues të panikës dhe nxitjes së tensioneve ose rritjes së urrejtjes ndaj grupeve të caktuara nëpërmjet nxitjes së padureshmërisë, diskriminimit, nganjëherë gjer në shkallën e gjuhës së urrejtjes, në forma të ndryshme (shpeshherë të kombinuara).

Kështu, dezinformatat vendore mbështeteshin më shpesh në përcaktimin politik (veçmas në atë partiak), por edhe në përkatësinë kombëtare, përkatësinë etnike dhe fetare me qëllim të nxitjes së “gjuajtjes së shtrigave” (witch hunt, scapegoating). Një pjesë e teorisë të komplotit promovuan demonizimin e jobashkëmendimtarëve (“satanistët”), antisemitizmin, homofobinë dhe format tjera të etiketimit.


Stimujt më të zakonshëm të padurueshmërisë, diskriminimit, gjuhës së urrejtjes



Pas shpërthimit të pandemisë së Covid-19, në përpjekjen për minimizimin e sëmundjes, në medie dhe në rrjetet sociale ndodhi një vërshimë spekulimesh dhe mashtrimesh, të plotësuar me teori komplotiste për atë se pandemia është rezultat i aktiviteteve të planifikuara të qendrave të fuqisë. “Pandeminë” (ang. Plandemic, sipas emrit të videos virale me ndikim), në mënyrë plotësuese dhe me kombinime të ndryshme e lidhën me koronavirusin e ri dhe me teknologjinë 5G, me filantropin dhe themeluesin e “Mikrosoft-it”

Bill Gejtsin, implementimin e çipave, manipulimet e ADN-së, riciklimin e rrëfimeve të vjetra për stërpikjen masive kimike të popullatës nga ajri – si pjesë e planit për zvogëlimin e numrit të popullatës së planetit gjer në vitin 2030 ose për fitimin e shtetasve të dëgjueshëm. Në detin e dezinformatave pandemia konsiderohet e rrejshme, koronavirusi mashtrim i madh, kurse dolën në sipërfaqe edhe lajme për mjekësinë popullore, për dëmet që sjell maska, testet PCR, vaksinat dhe një sërë gënjestrash të tjera.

Përfaqësimi i teorive të konspiracionit në mostër




Marrja e masave kundër pandemisë u ndoq nga dezinformatat e lidhura me to, që shpesh promovuan qëndrimin se vetë masat janë shprehje e pushtetit arbitrar dhe problemit gjithnjë e më të madh të sëmundjes.

Format më e shpeshta të manipulimeve lidhur me masat qenë spekulimet e lidhura me kufizimin e lëvizjes, shpalljen e orës policore, mbylljen e institucioneve dhe komunikimit ndërkuftar. Diskreditimi i personaliteteve si fajtorë të përhapjes së infektimit, qoftë si kinse pacientë ose funksionarë që nuk e kryejnë mirë punën ishte tema e dytë "e preferuar". Një numër jo i vogël dezinformatash u orientuan drejtpërdrejtë për shkatërrimin e besimit në sistemin shëndetësor dhe punonjësit e medie. Manipulimet me numrin e të infektuarve dhe shkallën e vdekshmërisë u shfrytëzuan në shumë nivele, nga ai lokal deri në atë global, ndërmjet tjerash edhe me pohime se vende të caktuara janë "liderë në rajon", qoftë për të mirë, qoftë për të keq. Temat tjera të shpeshta përfshinin kinse problemet me maskat dhe testimet, si dhe akuzat për profiterët dhe frikësimin e popullatës me shkatërrimin ekonomik, kurse gjatë muajve të fundit të vitit 2020 u shtuan dezinformatat lidhur me vaksinat që ishin duke u përgatitur.

Me kalimin e kohës, një pjesë e konspiratorëve pushuan me mohimin e sëmundjes dhe u hodhën në spekulime për natyrën e saj (si funksionon infektimi, simptomat, a dallon nga virusi i ftohjes/gripi ose bakteriet...) ose në drejtim të mjekësisë popullore – promovimin e praktikave ose mjeteve me të cilat qytetarët zbrapsen nga shfrytëzimi i shërbimeve mjekësore të mbështetura në shkencë, që është shumë e rrezikshme, sepse e shtynë shkuarjen tek mjeku të njerëzve të rrezikuar.

Mjerisht, autoritetet medicinale e përmendin shpesh se vdekjet ndodhin për shkak se pacientët kërkojnë me vonesë ndihmë mjekësore, duke humbur paraprakisht kohën me qasjet alternative si inhalacionet ose djegia e temjanit, pirja e alkoolit ose gargara me ujë të njelmët, qepë ose hudhra, ngrënia e perimeve dhe barëra. Dezinformimet e këtilla arrijnë gati 5% të rasteve, me ç'rast një pjesë e tyre kanë të bëjnë edhe me gjoja barërat e magjishme për sëmundje të tjera (shpesh të paarrtshme në vend), ritualet fetare dhe magjike ose shpëtimin nëpërmjet rrezitjes ose ndryshimit të stinëve të vitit (rrezet UV, borë).

Manipulimet në lidhje me masat




Dezinformatat lidhur me pandeminë janë pjesë e skemave të propagandës kundër BE-së dhe NATO-s që është prezente në rajon

Si fajtorë për pandeminë dhe disa dukuri negative të lidhura me të, përmbajtjet me teori konspirative shpesh i përmendin vendet konkrete ose grupet më të gjera, të përkufizuara me lehtësi si “qeveri evropiane”. Te dezinformatat vendore “fajtorët kujdestar” më të shpeshtë janë institucionet shtetërore ose partitë në pushtet (shpesh nuk bëhet dallimi i saktë), kurse në nivel ndërkombëtar më së shpeshti është nxitur jotoleranca ndaj “Perëndimit” (BE-së, NATO-s, vendeve anëtare), kurse më pak ndaj Kinës dhe Rusisë.

Institucionet ndërkombëtare si OBSH, OKB dhe MMF përmenden gjithashtu në kontekste negative, shpesh si një lloj trupash të huaj që imponohen dhe rrënojnë sovranitetin, kundrejt faktit se shteti ynë është anëtar me të drejtë vote.

Fajtorët e përmendur, gjegjësisht “personat negativë” në narrative



2.2. Pasqyra e hulumtimeve dhe dokumenteve të disponueshme për politikat publike

Hulumtimet e lidhura me problemin e dezinformatave në Maqedoninë e Veriut, i bëjnë kryesisht organizatat qytetare ose shoqatat e esnafëve, kurse bashkësia akademike deklarohet shumë rrallë për këtë temë. E nëse botohen hulumtime në revistat shkencore qoftë brenda vendit, qoftë jashtë tij, debati eventual i tyre bëhet brenda qarqeve të ngushta profesionale, pa ndonjë promovim të gjerë publik. Përveç përjashtimeve të rralla, shkencëtarët dhe profesorët, si nga institucionet e arsimit të lartë shtetëror ashtu edhe nga ato privatë, rrallë marrin pjesë në diskursin publik me këto tema.


Hulumtimi në nivel kombëtar

Hulumtimi i RESIS “Manipulimi në nivelet e edukimit mediatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut te popullata me moshë mbi 16 vjet”⁶ e realizuar nga OBSE në partneritet me ASHAAM-in në bazë të anketës në terren të bërë në shtator të vitit 2019 tregoi dallime të rëndësishme ndërmjet gjeneratave në nivelin e shkollimit dhe mënyrën e përvetësimit dhe shfrytëzimit të medieve tradicionale dhe atyre digjitale në mostrën

përfaqësuese të popullatës së RMV me moshë mbi 16 vjeçe. Ky hulumtim, që është i ngjashëm me një anketë të vitit 2016, mundëson ndjekjen e zhvillimit të shembujve individualë të shfrytëzimit të medieve, shprehitë e komunikimit dhe shkashëtisë e opinionit, nivelet e njohurive dhe të kuptuarit kritik të përmbajtjeve mediatike, si dhe praktikave krijuese dhe pjesëmarrëse të opinionit në mjedisin bashkëkohor të komunikimit.

Në aspekt të potencialit të rënë pre e dezinformatave gjatë periudhës së pandemisë, e cila nisi vitin e shkuar, hartëzimi tregoi se edhe pse “brezat e rinj posedojnë shumë më tepër shkathtësi dhe aftësi digjitale sesa grupet më të moshuara të shoqërisë, shkathtësitë e lidhura me arsimimin funksional u mungojnë gjithë grupeve të moshuara”. Ky hulumtim tregoi se një pjesë e madhe e opinionit vëren dallime të mëdha dhe thelbësore në informimim e medieve, kurse strategjia më e shpeshtë e analizës është biseda me të afërmit dhe miqtë, e “më rrallë angazhohen të gjejnë vetë burime tjera të besueshme”. Kurse sa i takon pjesëmarrjes është vërejtur përmirësimi në raport me vitin 2016 “një pjesë e vogël e të anketuarve janë të gatshëm të reagojnë personalisht me qëllim që t’i kundërvihen përhapjes së mëtutjeshme ose t’i zbërthejnë qëllimet

A kanë nevojë gazetarët në Maqedoninë e Veriut për ngritjen e kapaciteteve për edukim mediatik?



e autorit” në rastet e shpeshta kur në rrjetet sociale vërejnë “përmbajtje që fyejnë grupe ose individë ose shkelin të drejtat e dikujt”.

Dezinformatat për pandeminë gjejnë terren të përshtatshëm në RMV, sepse gjithë sfera mediatike është e varur paraprakisht ndaj manipulimeve të këtij lloji. Rezultatet e **hulumtimit “Rëndësia, prania dhe vetëdija për mendim kritik dhe shkathësi mediatike në industrinë mediatike”** të kryer nga KriThink⁷, të cilin me ndihmën e BE-së e udhëheqin “Metamorfozis” dhe “Eurothink”, tregojnë se gjendja e vështirë ekonomike në të cilën gjenden mediumet, si dhe shtypjet politike dhe manipulimi me përmbajtjet mediatike për realizimin e qëllimeve politike, janë shkaktarët kryesorë për rënie e kualitetit të gazetarisë në RMV. Kjo ndihmon që punonjësit e medie të jenë lehtësisht të cenueshëm para shtypjes së drejtëpërdrejtë ose indirekte. Ngritja e vetëdijes për rolin e medie si shtytës të demokracisë në shoqëri është vendimtare, kurse përmirësimi i situatës së medie duhet të trajtohet si një qëllim strategjik. Përndryshe, mbi 95% të gazetarëve të anketuar mendojnë se është e nevojshme që në mënyrë plotësuese të ndërtohen kompetencat dhe kapacitetet e gazetarëve nga fusha e edukimit mediatik (në mënyrë të konsiderueshme - 45,45%, rregullisht – 49,49%).

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut botoi në prill **raportin e monitorimit të rregullt të gjuhës së urrejtjes**, që zbatohet nëpërmjet platformës www.govornaomraza.mk, në të cilën thuhet se “gjatë marsit të vitit 2020, janë regjistruar 110 raste, që janë 100% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të shkuar. Numri më i madh i rasteve që u regjistruan në mars kanë të bëjnë me situatën e pandemisë së Covid-19, shpalljen e situatës së jashtëzakonshme nga ana e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me të edhe të orës policore, si dhe me reagimin e publikut lidhur me masat që ndërmerren nga ana e Qeverisë. Komunikim më i madh digjital dhe reagime në mediet sociale janë verëjtur pas përfundimit të konferencave

zyrtare të shtypit të ministrit të shëndetësisë në emër të Shtabit të Krizës”.⁸

Instituti i Maqedonisë për medime (IMM), nëpërmjet hulumtimit **“Baza politike dhe ekonomike e modeleve mediatike dhe komunikuese që përhapin dezinformata dhe gjuhë të urrejtjes”** në shtator tregoi se shpërthimi i krizës globale i shkaktuar nga koronavirusi në RMV “u përputh me periudhën para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare. Këto dy tema dhe situata shëndetësore në vend shkaktuan rritjen e dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes në baza politike dhe etnike. Gjatë periudhës së festimit të Pashkëve dhe Ramazanit nuk mungoi as nxitja e retorikës religjioze e ndërthurur me politikën ditore”.⁹

Këshilli për etikë në medime në Maqedoni (KEMM), në bashkëpunim me UNESCO-n, në tetor botoi **analizën e shkeljeve më të shpeshta të standardeve gazetareske gjatë kohës së pandemisë** për periudhën korrik-shtator të këtij viti, sipas përvojave të organeve vetërregulluese të medie-anëtarëve të rregullatorit mediatik. Analiza tregoi se problemet e paraqitura më së shpeshti të këshillat për etikë në Ballkan dhe në Evropë janë “raportimet sensacionale në medie, mbrojtja e pamjaftueshme e privatësisë dhe të dhënave personale si dhe qasja e vështirësuar tek informatat”.¹⁰

KEMM vërejtë se në RMV, “si gjithkund në botë, kriza i gjeti të papërgatitur gazetarët dhe mediet – u mungonte përvoja paraprake për punë në situatë krizash, mjetet adekuate dhe njohuritë për shfrytëzimin e teknologjive digjitale. U shfaqën dhe trysnitë ekonomike dhe problemet me masat e caktuara restriktive të vendosura nga Qeveria”, që patën për pasojë “informatat gjysmake dhe të gabuara, dezinformatat dhe animin gjatë informimit, sensacionalizmin dhe plagjiaturën”.



Në kuadër të projektit KriThink, në tetor u publikua edhe **hulimtimi “Pandemi apo infodemi? Mendimi kritik dhe teoritë konspirative gjatë kohës së pandemisë”**, që tregoi se narrativet alternative, veçanërisht teoritë konspirative të lidhura me pandeminë, janë jashtëzakonisht të përhapura dhe të “ngjitshme” për qytetarët maqedonas.¹¹

Ky besim në narrativet alternative, paradoksalisht, eci dorëpërdore me nivelin e lartë të besimit në mënyrën në të cilën shteti përballë me krizën, që kuptohet nga vlerësimet e larta që dhanë qytetarët për Qeverinë, e cila narrativet alternative i dhunon dhe i dekurajon si një rrezik të njohur për demokracinë. Këtë paradoks fokus-grupet e sqaruan nëpërmjet konceptit të identifikimit të një pjese të madhe të qytetarëve me Qeverinë, për të cilën mendojnë se është viktimë e pafuqishme për lojërë globale tek të cilat nuk ka asnjë ndikim.

Ky hulimtim tregoi se është problem edhe vet koncepti i “infodemisë”, që flet për nevojën për sqarimin alternativ dhe të depolitizuar të narrativeve alternative. Një kohë, kriza shëndetësore solli në opinion edhe debatin për gjoja ekzistimin e autoritarizmit nga poshtë, të inspiruar nga thirrjet për restriksione më të mëdha se restriksionet edhe ashtu të ashpra të Qeverisë, të shpjeguara si dëshirë për “politikë të dorës së fortë”. Megjithatë, “hulimtimit kualitativ (fokus-grupet) tregoi se thirrjet për dorë të fortë janë në të vërtetë asociacione për luftë kundër jondëshkueshmërisë, dëshirës për sundimin e ligjit etj.”

Përfundimi kryesor i këtij hulimtimi është se teoritë endemike të konspiracionit e kanë racionalitetin e tyre psikologjik. Për këtë shkak është e nevojshme që ato të shihen si pasojë e formave strukturore që i krijojnë dhe i bëjnë “të ngjitshme”. Vetëm programet e orientuara në adresimin e faktorëve strukturorë mund të jenë efikase dhe efektive. Patologjizimi i këtyre rrëfimeve nuk ndihmon, por vetëm i ushqen ato.


Hulimtimit në nivel rajonal

Edhe studime të tjera lidhur me gjendjen, të bëra në nivel rajonal dhe të botuara gjatë vitit 2020, i konfirmojnë shqyrtimet e përgjithshme të studimeve të bëra në nivel kombëtar se situata në RMV nuk është e mirë.

Në këtë rast duhet të merret parasysh se as në nivelin evropian as në nivelin e Ballkanit, tanipërtani nuk ekziston metodologjia e harmonizuar me të cilën do të mund të beheshin krahasime ndërmjet niveleve të edukimit mediatic në vende të caktuara. Kjo më së shpeshti bëhet në mënyrë indirekte nëpërmjet shfrytëzimit të indikatorëve të llojllojshëm, kurse shpesh termi edukim mediatic shfrytëzohet si sinonim për gërshtim më të gjerë shkathtësishtë, njohurishë dhe situatash të lidhura me prekshmërinë nga manipulimet.

Shembull për qasjen e këtyre është **“Indeksi i edukimit mediatic”** i iniciativës për politika evropiane në Institutin Shoqëria e Hapur – Sofje, me të cilin në fakt, përcaktohet “potenciali për qëndrueshmërinë e lajmeve të rreme në 35 vende evropiane, nëpërmjet indikatorëve për lirinë e medieve, arsimin dhe besimin tek njerëzit”.

Sipas tij, vendet ballkanike janë ndër më të prekurat nga dezinformatat dhe më inferioret ndaj lajmeve të rreme. Ky rangim, nuk mbështetet në hulimtimin e drejtpërdrejtë të nivelit të edukimit mediatic të qytetarëve nëpërmjet anketave ose testimeve, por në krahasimin e indikatorëve si rezultatet e PISA-testeve, indeksit të “Reporterëve pa kufij” dhe rezultatet e “Eurobarometrit”, që e ka ranguar RMV në vendin e fundit në vitin 2019.¹²




Përfundimi i këtij hulumtimi është se qytetarët e RMV, në krahasim me vendet tjera, kanë kapacitet më të vogël që t'i vlerësojnë në mënyrë kritike përmbajtjet mediatike, gjegjësisht nuk kanë shumë dije për të analizuar çfarë ju servojnë mediet, si janë "paketuar" ato, të njohin spinet dhe tendencat, dhe gjatë kësaj edhe si t'i shfrytëzojnë mediet për të marë pjesë në jetën publike. Metodologjia ngre pyetje a mund të përgjithësohet vlerësimi i shkallës së aftësisë për mendimin kritik të gjithë popullatës, anëtarët e së cilës janë të më shumë brezave dhe janë edukuar në rrethana të ndryshme (disa prej tyre në vende të huaja) vetëm nga rezultatet e PISA-testeve, në të cilat hyjnë fëmijët 15 vjeçar.¹³ Aspekti i lirisë së medieve është gjithashtu i rëndësishëm, por është vështirë të kuptohet lidhja e saj e drejtpërdrejtë me nivelin e edukimit mediatic të qytetarit të thjeshtë, sepse indeksi i "Reporterëve pa kufij" është i lidhur ngushtë me situatat politike të cilat ndikojnë në punën e qytetarëve, që mund të ndryshojnë shumë.¹⁴

Përkundër faktit se përdorimi në emër i termit "edukim mediatic", si dhe metodologjia e këtij rangimi për rezistencë ndaj dezinformatave, mund të jenë lëndë diskutimi, ai viteve të fundit në opinion edhe në rajonin e RMV, veçmas mes donatorëve dhe analistëve të sektorit qytetar, shfrytëzohet si vegëz për atë fushë, për shkak të mungesës së hulumtimeve të tjera më gjithëpërfshirëse dhe më të sakta të mbështetura pikërisht në metodologjinë për matjen e nivelit të edukimit mediatic, që do të harmonizohet për të gjithë shtetet e përfshira.

Studimi **"Harta e lajmeve të rreme dhe dezinformatave në Ballkanin Perëndimor dhe identifikimi i mënyrës për kundërvënien e efikase ndaj tyre"**, të cilën në dhjetor e publikoi Sektori për politikën e marrëdhënieve të jashtme të Parlamentit Evropian (PE)¹⁵, për RMV tregon se edhe në shoqëri edhe në politikë nuk mungojnë çarjet në të cilat "ngulet me sukses pyka e dezinformatave", e fushatat me dezinformata që u analizuan për qëllimet e studimit të përgatitura për Parlamentin Evropian, kishin për qëllim ta forcojnë konfliktin e brendshëm (veçmas ndërmjet maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë), të dëmtojnë marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit (veçmas me Bullgarinë, Greqinë dhe BE-në), si dhe të shkatërrojnë ose rrënojnë proceset zgjedhore me rëndësi primare – si referendumin për emrin e Republikës së Maqedonisë.

Dezinformatat e lidhura me pandeminë në rajon shfrytëzohen për realizimin e qëllimeve politike "mes tjerash, për ndryshimin e mendimit publik, për përkeqësimin e konflikteve të brendshme, si dhe për të ndikuar pozitivisht apo negativisht në imazhin e liderëve politikë".

Edhe pse "në Maqedoninë e Veriut, ndryshimi i paradokohshëm i qeverisë në masë të madhe i marginalizoi dezinformatat e medieve shtetërore dhe medieve kryesore, ato vazhdojnë të jenë forcë e madhe që e shkatërron politikën e brendshme". Ky studim tërheq vërejtjen se ato shumë shpesh përhapen prej faktorëve të brendshëm.¹⁶



Karakteristike për dokumentin është përmendja e shembujve konkretë dhe burimeve të dezinformatave në Maqedoninë e Veriut që është përmendur edhe nga kryetari i partisë politike VMRO-DPMNE, Hristijan Mickovski dhe ish-kryetari i partisë Nikolla Gruevski, si dhe mediet e afërta me këtë parti të financuar nga Hungaria.

Sipas **hulumtimit të mendimit publik për "Trendet GLOBSEK 2020"**¹⁷, ku janë përfshirë nëntë vende të Evropës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor, çdo i treti qytetar i Maqedonisë së Veriut beson në teoritë konspirative të lidhura me Kovid-19.¹⁸ Tema kryesore është ndikimi i pandemisë së Kovid-19 nga këndvështrimi i lojtarëve të mëdhenj në rajon, si: SHBA-ja, Rusia dhe Kina; popullariteti i NATO-s dhe BE-së; gjendja e demokracisë në Evropën Qendrore; gatishmëria e popullatës për të marrë vaksinat kundër Kovid-19 dhe mundësia për nxitjen e saj; ndikimi i teorieve konspirative për Kovid-19 në përpjekjet për t'u kundërvënë pandemisë.

Teoritë konspirative të lidhura me Kovid-19, e ngulftatin besimin e popullatës në demokraci, "projektimi" i përshtypjeve ndaj ndonjë faktori bëhet pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe gjeopolitikës, thonë autorët e studimit. Me 35% përkrahës të teorieve konspirative, RMV është në vendin e tretë në rajon. Në grupin e gjithë vendeve të përfshira, besimi i qytetarëve në pushtet e tejkalon gatishmërinë e njerëzve për t'u vaksinuar prej Kovid-19. Vetëm 29% e të anketuarve në RMV janë të gatshëm t'i marrin vaksinat për Kovid-19, kurse ky numër është dukshëm më i lartë – 48% – mes njerëzve që njëkohësisht u përgjigjën se do të vaksinoheshin kundër Kovid-19 dhe se i besojnë pushtetit. Gjatë kësaj 39% e qytetarëve të anketuar maqedonas shprehën besimin se numri i të sëmurëve me Kovid-19 në vend është më i ulët prej atij që e thonë pushtetarët, kurse 35% se Kovid-19 është trillim për manipulimin e popullatës.

GLOBSEK konkludon se "dezinformatat dhe teoritë konspirative do ta pengojnë në masë të dukshme tejkalimin e pandemisë", se gatishmëria e popullatës për t'u vaksinuar do të tregojë sa janë shtetet të afta për të ngritur nivelin e besueshmërisë së qytetarëve, por edhe atë se situata ofron rastin për një rol më të madh të BE si faktor kyç në mbrojtjen e shëndetit.

Rezultatet e **hulumtimit të mendimit publik "Virusi i dyshimtë: Konspiracionet dhe Kovid-19 në Ballkan"**, të

cilat në nëntor i publikoi rrjeti BIPAG,¹⁹ tregojnë se më shumë se gjysma e të anketuarve në RMV pohojnë se nuk kanë ndër mend të vaksinohen, përkatësisht se nuk i besojnë vaksinës kundër Kovid-19, njëres prej temave kryesore të fushatave dezinformuese. Sipas kësaj ankete, pothuajse 50% e maqedonasve të anketuar besojnë se koronavirusi është prodhim laboratorik kinez ose i industrisë farmaceutike, pothuajse 30% se virusi ka të bëjë me teknologjinë 5G. Gati 40% besojnë se armata amerikane e zhvilloi koronavirusin si armë biologjike, kurse gjithashtu se Bill Gejtsi e shfrytëzoi koronavirusin për ta "imponuar" vaksinën me mikroçipe me të cilën do të ndiqen njerëzit.

BIPAG konstatoi se fakti që përgjithësisht, mbi gjysma e të anketuarve në Maqedoninë e Veriut "besojnë shumë" në teoritë konspirative të cilat ua prezantuan, kurse mbi 60% besojnë në disa teori të këtuilla, paraqet kanosje edhe për përpjekjet për përballje me pandeminë dhe e rrezikon demokracinë në rajon.²⁰

Gjithë përpjekjet e sipërpërmendura hulumtuese i kontribuojnë kuptimit të situatës me dezinformatat për aspekte të ndryshme. Nevojiten investime më të mëdha sistemore në këtë fushë që të mund të gjenden zgjidhjet që do ta mundësojnë përcaktimin akoma më të saktë dhe më gjithëpërfshirës të gjendjes, në të cilën bëjnë pjesë dhe zhvillimi i metodologjisë për vlerësimin e drejtpërdrejtë të shkallës së edukimit mediatic dhe shkathhtësitë e përafërta tek kategoritë e ndryshme të popullatës, që do të zbatohen në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.

Analogjikisht me matjen e koeficientit të intelegjencës, kjo nuk është një ndërmarrje për shkak se një pjesë e këtyre çështjeve janë të lidhura edhe me dallimet kulturore dhe me një sërë rrethanash të tjera të lidhura me kontekstet lokale, ndaj çfarëdo krahasimi duhet të bëhet me shumë kujdes, në të kundërtën i jepet mundësi shtrembërimit, spineve ose shfrytëzimit të tyre si lëndë për sajimin e dezinformatave.

Duke i pasur parasysh këto rreziqe, Rrjeti për edukimin mediatic i Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë nëntorit të vitit 2010, miratoi Udhëzimet e obligueshme për etikën e hulumtimeve të edukimit mediatic²¹

Është e domosdoshme përkrahja për debatin e hapur dhe të gjerë profesional për këto çështje, veçmas në drejtim të motivimit për përfshirjen e bashkësisë akademike, institucioneve shtetërore dhe medimeve.

2.3. Pasqyrë e politikave publike të lidhura me infodeminë


Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2018, inicioi **Planin aksional për veprim të vendosur kundër përhapjes së dezinformatave dhe kundër sulmeve ndaj demokracisë**.²² Plani aksional parasheh zbatimin e masave proaktive dhe atyre të sigurisë. Sipas Planit aksional, Qeveria do ta nisë procesin e krijimit të strategjisë kombëtare për edukimin mediatik në kuadër të së cilës do të përfshihen aktivitete të institucioneve, medieve dhe sektorit qytetar, si dhe përfshirja e edukimit mediatik në programet mësimore.

Plani aksional parasheh që përmes masave proaktive, Qeveria në mënyrë aktive ta "nxisë diskutimin ndërmjet medieve, bashkësive mediatike dhe sektorit qytetar, me qëllim të vetërregullimit, bashkërregullimit dhe forcimit të standardve mediatike për internet-portalet, në pajtim

me udhëzimet e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës". Në planin aksional, Qeveria angazhohet për diskutim të vazhdueshëm me mediet për forcimin e modelit të përkrahjes për produksionin e programeve dhe përmbajtjeve edukative, si dhe bashkëpunimin me të gjithë organizatat dhe projektet që punojnë për verifikimin e fakteve. Nëpërmjet bashkëpunimit me Komisionin Evropian, Qeveria do të nxisë përfshirjen në sistemin për paralajmërimin e shpejtë të përhapjes së dezinformatave.

Megjithatë, këtij Plani aksional i mungojnë udhëzimet konkrete për zbatimin e masave të propozuara, si dhe korniza kohore në të cilën do të zbatoheshin aktivitetet e planit. Plani parashikon edhe formimin e Grupit aksional kundër përhapjes së dezinformatave dhe

A mendoni se këto masa do ta përmirësojnë situatën aktuale, duke e forcuar edukimin mediatik dhe duke e zvogëluar përhapjen e dezinformatave?



Pjesë e hulumtimit "Rëndësia, prezenca dhe vetëdija për mendim kritik dhe shkathësi mediatike në industrinë mediatike" (KriThink")

kundër sulmeve mbi demokracinë, por ekzistojnë vetëm informata të pakta për funksionimin e tij.

Më 21 nëntor kryeministri Zoran Zaev e paralajmëroi programin qeveritar për vitin 2021 të quajtur **"Aksioni 21 – për standarde evropiane në shtëpi!"**, për të cilin njëri prej dhjetë prioritetëve është quajtur "Aksioni 21 – Stop dezinformatave". Ai paralajmëroi aktivitete të forta në periudhën në vijim, konsultim të gjerë me punonjësit e medie dhe sektorin qytetar dhe një luftë akoma më serioze me dezinformatat, me gjuhën e urrejtjes dhe format tjera të kanosjeve hibride kundër demokracisë në shoqërinë tonë, në kuadër të Planit për aksion të vendosur kundër përhapjes së dezinformatave dhe kundër sulmeve ndaj demokracisë, që përfshijnë edhe sulmet kibernetike.

Kryeministri e theksoi rëndësinë e protokollit për komunikime në kohë krize ndërmjet shërbimit qendror qeveritar për komunikim dhe ministrive, të zhvilluar mbi bazën e Planit, që ka ndihmuar shumë çështjen e ballafaqimit "me lajmet e rreme, që në një numër tejet të madh u plasuan nëpërmjet kuazimedie". Sipas tij, tendencat për dezinformata mbeten aktuale, p.sh.: "lajmet e lidhura me vaksinën kundër Covid-19 me qëllim të dëmtimit të besueshmërisë së qytetarëve dhe të zhvlerësimit të përpjekjeve të forta të institucioneve dhe mjekëve në luftën me pandeminë".

Zaevi paralajmëroi bashkëpunim të forcuar me verifikuesit e fakteve dhe qasje më transparente për mediet në burimet e besueshme të informatave për krijimin e përmbajtjeve objektive mediatike me interes publik.

Gjatë vitit 2020 funksionarë të lartë qeveritarë e kanë thënë shumë herë se janë duke u përgatitur ndryshimet e politikave dhe reformave që do ta mundësojnë përfshirjen e sektorit arsimor në zgjidhjen e problemit të ndikimeve negative të dezinformatave.

Ky është hap prapa në raport me periudhën paraprake, që mund të kuptohet nga e dhëna se dokumentet si Strategjia dhe Plani aksional për arsimin për vitin 2018-

2025 nuk e përmendin fare termin edukimi mediatik. Sipas paralajmërimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, **Koncepti i ri për arsimin fillor**, që pritej të miratohet në fund të vitit 2020 ose në fillim të vitit 2021, mbështetet në integrimin e mendimit kritik dhe edukimin mediatik si vlerë themelore dhe pjesë e planeve mësimore.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e qasjes strategjike në nivel shtetëror, veçanërisht në drejtim të përgatitjeve për zbatimin e resurseve shtetërore dhe veçmas mjetet nga Buxheti i RMV gjatë zgjidhjes së një problemi të caktuar, një pjesë e organizatave qytetare që merren me përparimin e demokracisë, promovimin e pluralizmit mediatik dhe me nxitjen e edukimit mediatik rekomandojnë fillimin e procesit për përgatitjen e **Strategjisë së luftës kundër dezinformatave** nëpërmjet procesit inkluziv, me të cilin do të përfshihen të gjithë palët e prekura.

Përvojat e Fondacionit "Metamorfozis", që mbështeten në nxitjen/ ose pjesëmarrjen gjatë zhvillimit dhe miratimit të një mori dokumentesh strategjike, duke nisur nga Strategjia kombëtare për zhvillimin e shoqërisë informatike të miratuar në vitin 2005, gjer te Strategjia për transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019-2021)²³ e miratuar në vitin 2019, tregojnë se vetëm përpjekja e përbashkët dhe përfshirja e grupeve të ndryshme të interesit nga institucionet shtetërore dhe shkencore e arsimore, si dhe sektorit qytetar e privat, sigurojnë suksesin dhe qëndrueshmërinë e iniciativave të tilla.

2.4. Kornizat ligjore lidhur me pandeminë

Ligjet dhe dispozitat janë të rëndësishme për përhapjen e dezinformatave lidhur me pandeminë

Në raport me përgjigjen institucionale të provokimeve lidhur me pandeminë nga aspekti i përballjes me dezinformatat më të rëndësishme janë dy ligje: Kodi Penal dhe Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuele Mediatike.

Në Kodin Penal²⁴ për veprat e përshkruara në të, si përhapja e lajmeve të rreme në kohëra epidemish ose pandemish, më konkretisht, në nenin 205, paragrafi 5, thuhet:

“Ai që do ta rrezikojë sigurinë e tjetrit me kërcënim të rremë për përhapjen ose me shpërndarjen e lajmeve të pavërteta për egzistimin e sëmundjes së pashërueshme ngjithëse do të ndëshkohet me dënim në para ose me burg deri në gjashtë vjet”.

Ligji i dytë është Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuele Mediatike²⁵, sipas të cilit në fushën e kontrolleve profesionale që i bën Agjencia për medie, organi kryesor rregullator ka të drejtë ose ta ndalojë ose ta kufizojë emetimin dhe rriemtimin e përmbajtjeve audiovizuele nga shtete të tjera (neni 45), ku është paraparë se kjo mund të ndodh edhe nëse janë ndërmarrë masa “për shkak të mbrojtjes së shëndetit publik”, ose neni 53, i cili e kufizon të drejtën për lajme komerciale audiovizuele “që e dëmtojnë shëndetin dhe sigurinë”, ose neni 110 nga pjesa ku rregullohen obligimet e transmetuesit publik, i cili “është i obliguar të informojë, edukojë dhe emetojë emisione për... shëndetin e njerëzve...”.

Ligjet dhe dispozitat që u ndryshuan si përgjigje ndaj pandemisë

Njëri prej ligjeve kryesore që u ndryshua ishte Ligji për Mbrojtjen e Popullatës nga Sëmundjet Infektive²⁶, për të cilin gjatë kohë u debatua në Parlament dhe në publik. Në këtë ligj për herë të parë inkuadrohet termi Kovid-19 si sëmundje konkrete dhe u mundësuan nëpërmjet ndryshimit të ligjit dy gjëra. Sipas njëres, të sëmurit mund të shërohen edhe në institucionet

private shëndetësore që kanë kushte për ta bërë këtë, kurse sipas tjetres, Qeveria posedon fushë më të gjerë masash të cilat mund t'i propozojë si preventivë për pandeminë, dhe nuk është e detyruar që për secilën masë veçmas të hapë të gjithë procedurat parlamentare.

Parësor për këtë ligj ishte edhe ajo që nëpërmjet ndryshimeve, me akte dhe dokumente nënligjore, u mundësohen autorizime shumë më të mëdha shërbimeve inspektorale dhe më shumë personave juridikë në raport me shkelësit e masave ligjore ose dekreteve të Qeverisë.

Ky ligj, edhe pse ka të bëjë me përmirësimin e rregullimit, kur është fjala për sëmundjet infektive, ndihmon shumë në luftën me dezinformatat e lidhura me Kovid-19, para së gjithash, në dy drejtime kryesore:

- a) pushtetet politike dhe shëndetësore kanë një spektër të gjerë mundësishë të përballen me parandalimin e koronavirusit me akte nënligjore, pa u akuzuar ose dyshuar se masat i sjellin jashtë Kushtetutës dhe ligjeve me qëllim të përfitimit të pikëve politike;
- b) I shkurton mundësitë për dezinformatat e lidhura me rolin e institucioneve private shëndetësore, vë në pah lidhjen e tyre me institucionet e shëndetësisë publike si pjesë e tërësishme e sistemit shëndetësor në shtet.

Në një sërë rastesh, përhapja e dezinformatave lidhur me pandeminë u ndërlihd me indikacionet për vepra të tjera penale, si përhapja e gjuhës së urrejtjes, e cila sipas Kodit Penal (neni 319 - Nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose padurueshmërisë në baza kombëtare, racore, fetare ose baza të tjera diskriminuese dhe nenit 394-g Përhapjes së materialeve raciste ose ksenofobe nëpërmjet sistemit kompjuterik) që mund të bëhet edhe mbi bazë të gjendjes shëndetësore.²⁷

Në shumë raste dezinformimesh u vërejtën përpjekjet për shenjimin e anëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike ose fetare si fajtorë për përhapjen e infektimit dhe pasojave të tij, ndërmjet tyre edhe rritja e ashpërsisë së masave restriktive, si pjesë e rrëfimeve

se masat janë formë e shtypjes nga ana e Qeverisë ose në kontekstin ndërkombëtar.

Zbatimi ligjeve kundrejt pandëshkueshmërisë

Përkundrejt paralajmërimeve nga MPB-ja²⁸, gjatë kohës së pandemisë nuk u zbatua asnjëherë Kodi Penal në kuptimin e përhapjes së dezinformatave sipas nenit 205. Në vend të kësaj, Qeveria zgjodhi strategjinë e përgjigjes ndaj dezinformatave me transparencë aktive për pandeminë.

Për shkak të rregullimit të medieëve kryesore, para së gjithash, transmetuesve radiodifuzivë, tek ata nuk janë vërejtur lëshime më të mëdha në kuptimin e dezinformatave, që ndodhin shumë më tepër në mediet onlajn që nuk janë të mbuluar nga organi rregullator. Ky është konstatim i përgjithshëm i gjithë subjekteve të involvuara në sferën e medieëve.


Vërehet përmirësim në raport me situatën e viteve paraprake, kur televizionet e caktuara i promovonin në mënyrë jokritike qëndrimet antivaksinës nga autoritetet shëndetësore, pa iu nënshtruar sanksioneve ligjore nga organi rregullator.²⁹

Nga ana tjetër, edhe një pjesë e medieëve tradicionale, pa asnjë verifikim të fakteve ose kornizimit dhe sqarimit adekuat, përhapin deklarata paushalle dhe hutuese politikanësh të paverifikuara shkencërisht dhe/ose deklarata mjekësh, si nga vendi ashtu edhe nga jashtë, të cilët në moment nuk punonin me pacientët me Kovid-19. Ose gabime të paqëllimshme si rasti kur një transmetues radiodifuziv shumë i respektuar gjatë muajve të parë të pandemisë në RMV përhapit në mënyrë jokritike lajmin e agjencionit të madh dhe të njohur botëror për rezultatet shumë të mira të përdorimit të barit “azitromicin”, të njohur tek ne si “sumamed”. Në kësi rastesh nuk u ndërmorrën sanksione nga organet rregullatore ose organet tjera shtetërore.

Mosveprimi i drejtësisë në rastet e gjuhës së urrejtjes, që shumë rrallë përfundojnë me padi, kurse në historinë e gjertanishme me një gjykim të vetëm, është pjesë e problemit më të gjerë të pandëshkueshmërisë së veprave penale të lidhura me sferën mediatike. Nuk janë të qasshme të dhënat publike, vallë gjatë vitit 2020 prokuroria dhe gjyqet ndërmorrën ndonjë masë në rastet e shumta të kombinimit të dezinformatave për Kovid-19 me gjuhën e urrejtjes ose thirrjet për diskriminim.

2.5. Mekanizmat për vetërregullimin mediatic në kushte pandemie

Në fillim të pandemisë Këshilli për etikë në medie bëri thirrje për informim të përgjegjshëm³⁰ dhe bashkë me Shoqatën e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) botoi udhëzimet për mbrojtjen e punëtorëve mediaticë në kohën e Kovid-19,³¹ kurse në muajt në vijim SHGM organizoi aksione për ndihmë dhe testime gratis për gazetarët.



Promovimi i botimit të UNESCO-s “Udhëzime për informim inkluziv në medie për Kovid-19 në ueb-faqen e KEMM.³²

Mekanizmi për vetërregullim luajti rol të rëndësishëm në kuptimin e shenjimit të shkëljes së Kodeksit gazetaresk, para së gjithash, në sferën *online*, por punonte edhe në rastet e paraqitjes së dezinformatave tek mediet tradicionale.

KEMM i promovon zgjidhjet në rrjetet sociale edhe në ueb-faqe-n personale, kurse bëri dhe publikime të veçanta me statistikata e rasteve të lidhura me dezinformatat në kushte pandemie, udhëzime për informimin e medieve dhe gazetarëve dhe disa apele e deklarata kur u vërejt piku i disa kahjeve negative.

Si përgjigje e epidemisë në rritje të lajmeve të rreme ose “infodemisë”³³, projekti KriThink botoi artikuj të shumtë

edukativë me udhëzime praktike për gazetarët³⁴ dhe qytetarët – konsumuesit e përmbajtjeve mediaticke³⁵.

Në krahasim me shfrytëzimin e mekanizmave rregullatore, është e rëndësishme të thuhet se sipas Rregullores së tij, Këshilli për Etikë në Mediet e Maqedonisë (KEMM) guxon të veprojë vetëm sipas kallëzimit të bërë prej personave fizikë joanonimë, të cilët mund të vepronë edhe në emër të personave juridikë. Në numrin më të madh të rasteve kallëzimet ishin të individëve të prekur drejtpërsëdrejti, përkatësisht që kishin mosmarrëveshje me mediet për veprimet e të cilave ankoheshin (në raste shpifjesh apo fyerjesh).

Qëndrimi i këtyllë njekohësisht do të thotë se, për të pasur Komisioni mbështetje për sjelljen e një vendimi, duhet patjetër që dikush nga jashtë të bëjë ankesë kundër një mediumi konkret për të cilin ka dyshime se përhap dezinformata. Kjo ndikon në kufizimin e qytetarëve, të cilët, duke pasur parasysh lidhjen e medieve të caktuara me qendrat politike dhe kriminale, që mund të kenë potencial për reperkusione dhe hakmarrje, përmbahen nga komunikimi formal me KEMM dhe nga ngritja e akuzave për çështje me interes publik.

Nga ana tjetër, edhe pse një sërë keqpërdorimesh mediaticke kalojnë kështu “nën radarin” e Komisionit, gjatë vitit 2020 janë vërejtur dhe shembuj të qytetarëve që parashtruan ankesa për çështjet me interes publik, p.sh.: kur televizioni emetoi dezinformata për ilaçin “sumamed”.

Nga ana tjetër, që KEMM të ketë mundësi të mbulojë një numër të madh ankesash, duhet seriozisht ta rrisë kapacitetin e Komisionit (në kuptimin e kohës së punës në disponim, financave, resurseve njerëzore) që të mund me kohë të merret me shumë raste të dezinformatave mediaticke. Kjo nënkupton proces të komplikuar dhe të gjatë për të cilin është i nevojshëm koncensusi i të gjithë anëtarëve të KEMM, si dhe ndryshimet e procedurave të lidhura me karakterin e veprës.



3

MËSIMET E NXËNA

3.1. Roli i institucioneve shtetërore si burim informacionesh për Kovid-19

Sjellja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut prej shpalljes së pandemisë në mars të vitit 2020 e tregoi rëndësinë e transparencës si parim prijës i qeverisjes së mirë.

Gjatë pjesës së parë të vitit, gjersa nuk ishte vendosur dhe përpunuar plotësisht sistemi i menaxhimit të krizës, pati disa situata në të cilat gabimet apo veprimet tjera u shfrytëzuan nga mediet dhe grupet e rrjeteve sociale për rrënimin e besimit ndaj sistemit ose funksionarëve të caktuar të shtetit. Duke pasur parasysh atë që u bë gjatë periudhës parazgjedhore, funksionimi i institucioneve shtetërore ishte ngarkuar edhe me strukturën e përkohshme të qeverisë, në të cilën kishin pozita me përgjegjësi edhe përfaqësuesit e pushtetit edhe ata të opozitës, që në shumë raste sharruan në akuzat e ndërsjella në vend të punës së përbashkët.

Në pjesën e dytë të vitit, kur pas zgjedhjeve në pozicionet adekuate u emëruan funksionarë me mandate të qarta dhe përgjegjësi politike, u pakësua edhe numri i incidenteve të atij lloji (por jo në tërësi³⁶). Rritja e transparencës solli në zvogëlimin e tensioneve dhe dezinformatave. Kjo u bë në veçanti e evidente kur, pëveç transparencës në nivel qendror, gazetarëve

iu mundësua të kenë më shumë qasje edhe tek institucionet shëndetësore, për të intervistuar mjekë dhe pacientë, me çka në mënyrë drastike u zvogëlua intensiteti i teorive konspirative sipas të cilave virusi nuk ekzistonte.

The screenshot shows the official website for COVID-19 information in North Macedonia. The page is titled "Официјални информации за коронавирус во Северна Македонија" (Official information for coronavirus in North Macedonia). It features a navigation menu with options like "Почетна", "Заштети се", "Мери на Владата", "Ишти прашања?", "Новости", "Транспарентност", "Статистики", and "Кои". The main content area includes a section for "последните 24 часа" (last 24 hours) with a table of statistics:

Датум	Нови случаи	Заболени	Излечени	Активни	Починати	Тестови	Вс
24.01	67	90.020	79.040	8.981	2.791	677	68

Below the table, there are three buttons: "Ковид. АИ се заштитам?", "Кои се симптомите?", and "Правилна изолација".

koronavirus.gov.mk është vendi qendror i internetit, nëpërmjet të cilit organet shtetërore i prezantojnë informacionet zyrtare për pandeminë në RMV.

Përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, që nga zyra e kryetarit të qeverisë dhe ajo e ministrit pa portofol e pa resor - përgjegjësit për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë (kjo pozitë u ndërpre në gusht), si bazë për qasjen e tyre në kundërshtimin e dezinformatave, fillimisht e theksuan rritjen e transparencës dhe hapjes për bashkëpunim me të gjitha mediet, organizatat mediatike, individët. Gjatë kësaj kohe përfaqësuesit e saj treguan se Qeveria “nuk e ka vendin ekskluziv në luftën me dukurinë e dezinformatave, teorive konspirative dhe manipulimeve”, por bëhet fjalë për “luftë të përbashkët” nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të të gjitha palëve të prekura të mbarë shoqërisë.³⁷

Në bazë të Planit për aksion vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave dhe kundër sulmeve mbi demokracinë, Qeveria përgatiti dhe protokolin për komunikime në kohë krizash ndërmjet shërbimit qendror qeveritar të komunikimit dhe ministrive, që zbatohet nga fillimi i krizës me Covid-19.

Gjatë muajve të parë të pandemisë në fokus të këtyre përpjekjeve ishte sigurimi i informatave të qarta dhe gjithëpërfshirëse, me çka në publik rolin kryesor e kishte ministri i shëndetësisë Venko Filipçe. Ministri, që është mjek me profesion, ishte i angazhuar për mbajtjen e konferencave ditore për mediet, gjatë të cilave i sqaronte detajet e disa masave dhe situatave, ndonjëherë edhe me përsëritje të shumta.

Në mënyrë paralele u zhvillua sistemi për informimin e qytetarëve nëpërmjet internetit, nëpërmjet prezencës zyrtare në rrjetet sociale dhe kanalit në aplikacionin e popullarizuar për mesazhe “Viber”, i cili gjer në fund të vitit arriti të ketë mbi 50.000 anëtarë. Në këtë kanal, në bazë ditore emetohen edhe shpallje që u dërgohen edhe medieeve me informacione për numrin e të infektuarve, të shëruarve, të vdekurve në nivel shteti dhe nëpër komuna.

Në dallim prej vendeve të tjera të rajonit, si Serbia, ku gazetarët e pavarur pohonin se statistikave zyrtare në nivel shteti nuk përputhen me të dhënat nga terreni³⁸, në RMV nuk u shfaqën dyshime të rëndësishme në lidhje me këtë aspekt të informimit.



KONFERENCË PËR SHTYP E MINISTRIT TË SHËNDËTËSISË
VENKO FILIPÇE (22.06.2020) 53:26

Konferencë për shtyp e ministrit të shëndetësisë,...

224 views •

Streamed 6 months ago



ПРЕС-КОНФЕРЕНЦИЈА НА МИНИСТЕРОТ ЗА ЗДРАВСТВО
ВЕНКО ФИЛИПЧЕ (22.06.2020) 52:11

Прес-конференција на министерот за здравство,...

6.5K views •

Streamed 6 months ago

Konferencat për shtyp të përfaqësuesve të shtetit për Covid-19 u përcollën nëpërmjet kanalit oficial në YouTube të Qeverisë në gjuhën maqedonase dhe shqipe, dhe me gjuhën e shenjave. (YouTube.com/user/VladaMakedonija)

Institucionet shtetërore krijuan sistemin e buletinit të rregullt informativ, nëpërmjet të cilit çdo qytetar mund të marrë rregullisht të dhëna të detajuara për numrin e të infektuarve, të shëruarve dhe të vdekurve, gjer në nivelin komunal, si dhe informata nga shërbimi, të lidhura me sjelljen dhe zbatimin e masave mbrojtëse. Kjo i kontribuoi në masë të madhe zbutjes së ndjenjës së panikut dhe parrugëdaljes të popullata e ushqyer nga burimet e ndryshme dezinformatash.

Përkundër përpjekjeve gjithëpërfshirëse për transparencë në nivel kombëtar, në disa raste deklaratat kuturu të krerëve të institucioneve shtetërore ose funksionarëve se gjithçka është nën kontroll, situata me numër të madh rastesh të qytetarëve pozitivë dhe të vdekur për shkak të Covid-19, në publik konsiderohet si mungesë sinqeriteti. Përpjekjet e ngathta dhe voluntariste që nëpërmjet spinit ose prezantimit selektiv të fakteve të krijohet ndjenja e sigurisë shkakton huti në publik dhe mosbesim të qytetarëve ndaj institucioneve. Përpjekjet e tilla i shtyjnë qytetarët të kërkojnë informata gjithandej, pa vendosjen e kriterëve për kredibilitetin e burimeve.

Aspekti tjetër që kishte ndikim të jashtëzakonshëm në perceptimin e qytetarëve për masat ishin thashethemet politike nëpërmjet të hedhjes së fajit mes partive, që e rënduan punën e qeverisë teknike të formuar në janar, njëqind ditë para mbajtjes së zgjedhjeve të parashikuara e të parakoshme parlamentare, që më në fund u mbajtën në mesin e qershorit.


Veçanërisht i dëmshëm ishte konflikti në kuadër të qeverisë teknike për çështje të përgjegjësisë për pandëshkueshmërinë e organizimit të tubimeve publike, në të cilat nuk respektohen ndalesat dhe grupimet, mbajtja e distancës, bartja e maskave dhe higjiena elementare, mes tjerash edhe në kuadër të ceremonive fetare. Periudha e përhapjes fillestare të infektimit në vend koicidoi me periudhën parazgjedhore dhe me periudhën e solemniteteve fetare e familjare, veçmas ato që rëndom përfshijnë tubime masive si Pashkët dhe Ramazani. Në një sërë rastesh pushteti i toleroi insitucionet fetare ose klerikët e caktuar që nuk i respektuan masat duke predikuar dezinformata, si

dhe organizatorët e tubimeve politike të përmasave të mëdha ose të vogla, që kanë të bëjnë me qasje populiste të përmbajtjes nga aktiviteti që mund ta rrënojë popullaritetin e subjekteve të caktuara politike.

Rast karakteristik që e ilustron mosbashkëpunimin ndërmjet forcave të rendit dhe pushtetit shëndetësor është deklarata kontraverse e majit e ministrit teknik të punëve të brendshme Nase Çulevit nga VMRO-DPMNE se nuk do t'i dënojë qytetarët të cilët nuk i respektojnë masat³⁹. Mediet e afërta me atë parti e konsideronin vendimin e tij si gjest trimëror kundër "shtypjeve", kurse, në anën tjetër, të njëjtat i tërhoqën akuza për përgjegjësi për përhapjen e Covid-19 nga ana e ministrit të LSDM-së.⁴⁰

Kjo praktikë e mosmarrëveshjeve lidhur me masat shëndetësore në kuadër të vetë qeverisë ndikoi fuqishëm në politizimin e gjithë krizës, duke krijuar hapësira për dezinformata që buronin prej faktorëve të ndryshëm vendorë, por edhe për kuptimin, aftësimin dhe përhapjen e dezinformatave nga vendet e huaja të cilat konsideroheshin se janë kompatible me opcionet e caktuara politike. Për shembull, dezinformatat që vinin prej qarqeve djathtiste nga SHBA-ja ose Serbia, ishin të mirëpritura për djathtistët lokalë, po edhe anasjelltas për qytetarët e orientuar nga e majta.

Pandëshkueshmëria endemike është gjithashtu faktor i zvogëlimit të besimit të qytetarëve në institucione, përkatësisht forcimit të perceptimeve për selektimin e tyre dhe anshmërinë sipas kriterëve politike përkundëjt atyre shkencore-shëndetësore. Kështu, në më shumë raste të tubimeve të lidhura me qendrat e fuqive politike apo fetare, nga protestat tek festat, nuk u respektuan masat si vendosja e maskave dhe mbajtja e distancës fizike, gjë që u regjistrua nga video dhe foto materialet e xhiruara në vendngjarje. Nuk u zbatuan as sanksionet e parapara për organizatorët. Perceptimet e këtilla nuk janë përherë të kufizuara sipas vijës partiake, por janë bërë dhe pjesë e perceptimit të qytetarëve të "papërcaktuar", të cilët si burim të korrupsionit e shohin bashkë gjithë "elitën" politike e shoqërore, (ku bëjnë pjesë politikanët, funksionarët, krerët e fesë dhe njerëzit tjerë).



Xhirime nga kanali qeveritar “Korona-virus MK” në aplikacionin për telefonat celularë “Viber”, me pjesë nga informimet ditore.

Rasti i fushatës së dezinformimeve kundër aplikacionit “Stop Korona”

Aplikacioni “Stop korona” ka qasje vetëm tek informata për lokacionin



Përkundër informimeve që u shpallën në Politikën për privatësi (dhe të verifikuara në mënyrë plotësuese prej ekspertëve të softuerëve të cilëve ua dhanë për mbikëqyrje kodin programor) u përhapën dezinformata se aplikacioni shërben për spiunim të qytetarëve nga ana e qeverisë, që e dekurajoi një pjesë të madhe të shfrytëzuesve potencialë.^{41,42}

Krahas artikujve të ndryshëm onlajn, statuseve dhe tuitereve, kishte hise edhe një medium mejnstrim. Televizioni nacional TV “Alfa”, për të cilin ka indikacione se financohet nëpërmjet firmave nga Hungaria, më 22 prill ia kushtoi një emision të tërë – tok shout të mbrëmjes⁴³ për përhapjen e spekulimeve për aplikacionin. Në emision, me gjasë për shkak të mbrojtjes nga padia për shpifje, nuk u bë në mënyrë eksplicite akuza e rrejshme se me aplikacionin bëhen përgjime.

Udhëheqësit shprehën “mendime personale” se vet ata nuk do ta shfrytëzonin, kurse akuzat i bënin në formë të pyetjeve orientuese të llojit “përse do të duhej që me këtë aplikacion t’na i shohin fotografitë, kamerën ose mikrofonin?”.

Me këtë rast, persona anonimë të prezantuar si ekspertë të informatikës gjithashtu bënin spekulime, pa përmendur faktin konkret se në secilin telefon është e lehtë të vërtetohet se cili aplikacion te cilat informata ka qasje (te “android 3 nëpërmjet opcioneve të Arr info në pjesën Permissions), kurse për aplikacionin “Stop korona” thuhet se ka qasje vetëm te lokacioni i telefonit dhe te asnjë funksion tjetër.

Niveli i ulët i instalimit të aplikacionit në raport me paralajmërimin solli gjer tek ndërprerja e fushatës qeveritare për shfrytëzimin e tij. Në këtë rast nuk u publikuan informatat për efikasitetin e tij, që gjithashtu është një faktor i cili ndikon në besueshmërinë e qytetarëve si shfrytëzues potencialë, krahas spekulimeve dhe dezinformatave.⁴⁴



3.2. Roli i institucioneve shëndetësore dhe punonjësve të shëndetësisë

Institucionet vendore dhe ndërkombëtare të shëndetësisë luajnë rol vendimtar në ballafaqimin me dezinformatat që kanë të bëjnë me shëndetësinë, veçmas kur qendra të caktuara e të fuqishme politike ose ekonomike përpiqen të krijojnë ndikim politik ose fitime nëpërmjet formave të ndryshme të manipulimit, që sharrojnë madje edhe në format e sharlatanizmit dhe pseudomjekësisë. Në situatat e kohezionit të dobët shoqëror dhe polarizimit të fuqishëm, të lidhura me përpjekjet aktive që të rrenohet besimi në institucionet e sistemit, institucionet shëndetësore ballafaqohen me sfidën që në segmente të caktuara ta ndërtojnë autoritetin në popullatë pothuajse nga zeroja, përkundër teorieve të konspiracionit.

Pandemia e Kovid-19 e nxori në shesh në mënyrë plotësuese situatën lidhur me perceptimet negative për rolin e sistemit shëndetësor te segmenti i rëndësishëm i popullatës gjatë tri dekadave të fundit, në dallim nga periudha e socializmit para vitit 1990, kur ishte e pamundshme të vihet në pyetje kredibiliteti i shkencës dhe veçmas i institucioneve shëndetësore vendore e ndërkombëtare, si Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh).


Importi i teorieve utradjathtiste të konspiracionit anti-OKB-së për rendin e ri botëror nga SHBA-ja dhe ndërthurja e tyre me propagandën lokale gjeti terren të përshtatshëm në Ballkan për shkak të faktorëve si rënia e besimit në gjithë sistemin e OKB-së në vitin 1990 dhe perceptimeve të pranura përgjithësisht për kualitetin e rrënuar të shëndetit publik, frustrimin për shkak të paarritshmërisë së shërbimeve të shtrenjta në shëndetësinë private, tek e cila janë mbështetur me dekada promovimi shoqëror dhe mediatik i “mjekësisë alternative”⁴⁷, mjekëve popullore dhe antivaksinistëve.

OBSh-ja si pjesë e sistemit të OKB-së, ishte qëllim i veçantë i dezinformatave të mbështetura në mashtrimet dhe spine për strukturën dhe kompetencat e saj. Gjatë kësaj, sipas yrnekut të propagandës utradjathtiste në SHBA, ajo u prezantua si një trup i huaj që imponohet, në vend se të perceptohet si organizatë në të cilën bën pjesë vendi.

Si reaksion i iniciativave për verifikimin e fakteve, edhe në botë edhe në RMV, qendra të caktuara të forcës ose grupe joformale që përfitojnë prej përhapjes së dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes nisën fushatën e dezinformatave ose llojet tjera të reaksioneve sporadike, por me të ngjashmit si vetja. Një pjesë e tyre

Ndryshimi i perceptimit për OBSh-në

Paraprakisht një besim me nivel të lartë në institucione është demonstruar në vitin 1972, kur RSFJ, me ndihmën e OBSh ia doli nëpërmjet karantinës në viset e rrezikuara dhe me vaksinime masive ta mposhtë epideminë e fundit të frutit të madh në Evropë.⁴⁵



Dy dekadat e ardhshme, OBSh-ja dhe profesioni i mjekësisë gëzuan autoritet të madh, të forcuar edhe nëpërmjet produkteve kulturore, si: filmat vendore (Variola Vera, 1982) dhe stripeve të importuar, si stripi francës “Doktor Zhystis”⁴⁶ (Docteur Justice), në të cilin figura kryesore është mjeku i OBSh-së, që njëkohësisht është dhe mjeshtër i sporteve luftarake, i botuar në kuadër të stripit të popullarizuar “Strip zbavitës” të “Dnevnikut” nga Novi Sadi, prej 1979 deri në vitin 1988.

i keqpërdorin faktet e parashtruara nga verifikuesit, puna e të cilëve është e kufizuar në faktet e verifikuara, që edhe në mënyrë empirike mund lehtësisht të verifikohen me metodat e hulumtimeve objektive gazetareske, gjatë të cilave si burime të dorës së parë shfrytëzohen OBSH-ja, institucionet mjekësore dhe shkencore dhe informatat zyrtare nga institucionet shtetërore.

Si sfidë në këtë fushë u paraqit dhe mungesa e konkluzioneve të pakontestueshme shkencore për natyrën e Covid-19, përkundër nevojës së pjesës së madhe të opinionit publik për “të vërtetën” e thjeshtë, të qartë dhe njëkuptimëshe. Për njerëzit e tillë, teoritë konspirative me qasjen e tyre dogmatike u treguan më tërheqëse se shpjegimet më të komplikuar shkencore (që, mes tjerash, nënkuptojnë dhe njohjen paraprake të metodës shkencore, si dhe statistikës dhe të mundshmes). Në kësi rrethanash, ndryshimi i qëndrimeve të OBSH-së në varshmëri të evolimit të koncensusit shkencor e vështirësoi punën e verifikuesve të fakteve.

Për shembull, OBSH-së i nevojiteshin muaj për të vërtetuar se virusi bartet nëpërmjet ajrit ose për t’i ndryshuar udhëzimet fillestare se vetëm disa grupe të rrezikuara janë të detyruar të mbajnë maskat (të pengojnë mungesën në treg në kushtet e mospasjes së tyre në dispozicion). Shi për këtë, verifikuesit e fakteve nuk mund të mbështeten vetëm në thëniet e autoriteteve zyrtare, por duhet ta sqarojnë dhe kontekstin më të gjerë dhe të verifikojnë edhe studime të tjera shkencore dhe mendime profesionale – për çka është e nevojshme një aktivitet më i madh publik i institucioneve mjekësore dhe bashkësisë së gjerë akademike, e cila informatat e tilla do t’i bëjë të arritshme edhe jashtë qarqeve të ngushta shkencore.

Përgjigja shtetërore për nevojën për informim lidhur me pandeminë në RMV fokusohej në krijimin e sistemit në të cilin informatat zyrtare do të barten nga një burim – Ministria e Shëndetësisë, që deri diku ndikoi pozitivisht në zvogëlimin e kakofonisë së medieive. Gazetat ditore me numrin zyrtar të të infektuarve dhe të vdekurve, si dhe transparencën për t’u diskutuar detajet e kërkuara prej gazetarëve, kontribuan në uljen e shkallës së konfuzionit dhe panikut në publik.

Apel për transparencë nga ASHAAM-i

Në fillim të qershorit trupi regullator ASHAAM përmendi rastin e “praktikës së vërejtur sesi institucionet kompetente shëndetësore favorizojnë medie të caktuara që ata t’i marrin të parit informatat lidhur me koronavirusin”⁴⁸. Agjencia apeloj që organet kompetente të distribuojnë informata të plota tek të gjitha mediet, që njëkohësisht t’ua mundësojnë të gjithëve qasjen e njëjtë gjer tek ato. Në këtë rast nuk u tha për cilat institucione bëhet fjalë konkretisht. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020 nuk u vërejtën ankesa të këtij tipi, as prej medieive proopozitare as prej medieive të pavarura.

Në aso kushtesh, shumica e institucioneve shëndetësore (Instituti për shëndet publik, Qendra për shëndet publik, spitalet shtetërore dhe klinikat...) si dhe institucionet private shëndetësore (spitalet, ordinancat...) nuk u paraqitën në publik me shpjegime të veçanta për gjendjen e përgjithshme, përveç deklaratave për mediet në rastet që kishin të bëjnë drejtpërdrejt me ta.

Përgjithësisht, nivel të ngjashëm diskrecioni mbajtën edhe Fakulteti i Mjekësisë, si dhe Dhoma e Mjekëve, që diskutimet shkencore për natyrën e sëmundjes dhe temat tjera i bënë brenda qarqeve të tyre të mbyllura – vetëm në kuadër të esnafit, me qëllim të shmangies së shpjegimeve të gabuara dhe konfuzionit në mesin e laikëve. Sipas kësaj logjike, individë pa arsimim medicinal, të cilët vetëm pjesërisht mund t'i kuptojnë arritjet profesionale, këmbimin e mendimeve të kundërta profesionale, mund ta shpjegojnë si konflikt që dekurajon zbatimin e masave, me çka gjykimi i tyre do të kufizohej vetëm në përzgjedhjen e një pjese të fakteve që u përgjigjen paragjykimeve të pranuar paraprakisht.

Nga ana tjetër, kur mjekë të caktuar ose individë të fushës shkencore e arsimore dalin jashtë këtyre kornizave dhe plasojnë qëndrime të pabaza shkencore ose shpjegime të pasakta personale, që ato deklarata i bënin të varura nga interpretimet e gabuara plotësuese, institucionet mjekësore publikonin rrallë reagime dhe demante. Kjo e vështirësoi punën e verifikuesve të fakteve dhe të gazetarëve të tjerë profesionistë.

Dhoma e mjekëve të Maqedonisë së Veriut e shfrytëzonte kohëpaskohe faqen e saj të FB për publikime të orientuara për demantimin e dezinformatave, si në rastin e prezantimit të rrejshëm të pacientes si mjeke⁴⁹ ose në rastin e apelit të 8 qershorit me të cilin treguan se një pjesë e mjekëve "bindjet e tyre personale i vënë akoma para njohurive dhe udhëzimeve të rekomanduara nga OBSH-ja dhe pushtetet dhe autoritetet shëndetësore shtetërore, duke u sjellur në kundërshtim me protokollet zyrtare, mjekësisë së bazuar në dëshmi dhe kodeksin e deontologjisë mjekësore. Këta kolegë nuk i paraqesin të sëmurët për të bërë testimet dhe t'i shërojnë në kushte shtëpiake, kurse disa të tjerë mendojnë se virusi nuk ekziston ose se bëhet fjalë për konspiracione, me çka rritet rreziku për përhapjen e infeksionit"⁵⁰.



Storjet gazetareske si fotoreportazhi "Dymbëdhjetë orë me Ndihmën e shpejtë: Natë e gjatë dhe e lodhshme me dinamikë molisëse dhe trysni të padurueshme"⁵¹ i "Meta.mk" kontribuan për thyerjen e miteve sipas të cilëve "sëmundja nuk ekziston".

Gjatë vitit 2020, autoritetet shëndetësore kohë pas kohe reagonin drejtpërdrejt ndaj dezinformatave të lidhura me barërat. Bie fjala, në fillim të dhjetorit si reaktion i indikacioneve se nëpërmjet internetit shiten “në të zezë” barërat për shërimin e koronavirusit “Ramdesivir” dhe “Favira”, ministri i shëndetësisë Venko Filipçe, tregoi se ato janë barëra të dëshmuara që ndihmojnë në shërimin e disa sëmundjeve dhe situatave të tjera, duke theksuar se nuk mund të rekomandohen barëra që nuk ndihmojnë diagnozat konkrete.⁵²

Institucionet shëndetësore i demantojnë rrallë dezinformatat që i akuzojnë punonjësit e tyre për keqpërdorime, duke nisur nga qëndrimet se virusi nuk është diçka më shumë se një formë e gripit, se prej Covid-19 vdiset për shkak të trajtimit të gabuar të të sëmurëve, se infektimi përhapet për shkak të paaftësisë së Komisionit për sëmundje ngjitëse, që përbëhet prej mjekëve të kyçur në politikë, të cilët u nënshtrohen porosive të pushtetit.

Mjekët dalin rrallë në publik me deklarata me të cilat i kundërvihen mjekësisë popullore - udhëzimeve për ujë të njelmët, për produkte të ndryshme ushqimore dhe këshillave të pambështetura nga shkenca e mjekësisë, që jo vetëm që mund ta shtyjnë trajtimin spitalor të dikujt që e shëron veten në shtëpi, por në asnjë mënyrë nuk kontribuojnë që t'i shpallet luftë koronavirusin brenda organizmit.



Storjet gazetareske si “Heronjtë e robëruar në luftën me Kovid-19: portretet e të punësuarve në Ndhimën e shpejtë mjekësore”⁵⁴ të “Meta.mk” që kontribuan në forcimin e empatisë në opinion.

Rëndësia e formave të ndryshme të informimit gazetaresk

Gjatë vitit munguan gjithashtu informatat publike me të cilat do të afirmohej puna e personelit shëndetësor, të cilët vërtet u angazhuan në luftën kundër Covid-19. Përveç rasteve të rralla relative në rrjetet sociale edhe vetë mjekët e përfshirë në këtë luftë janë përmbajtur prej veprimeve që mund të shtrembërohen si “vetëlavdërime”. Kjo solli tek mungesa e përgjithshme e vetëdijes për situatën edhe në nivel sistemi edhe në nivel individual, e cila bëri që informatat për përpjekjet vetëmohuese të personelit shëndetësor të shfaqen publikisht vetëm në mënyrë sporadike, si në rastin e dr. Trajçe Neshkovskit nga Klinika e pulmologjisë dhe alergologjisë për rolin e të cilëve edhe në Dibër edhe në Shkup opinionin e kuptoi vetëm pjesërisht pas vdekjes së tij në një fatkeqësi komunikacioni.⁵³

Fokusimi në të dhënat statistikore (“numrat”) në komunikimin publik të autoriteteve shëndetësore gjatë gjysmës së parë të vitit, pati efekt negativ të një pjesë e popullatës me arsimim më të ulët. Te individët me shkathtësi të ulëta matematikore lajmet e bazuara në statistika qenë thjesht refuzuese, dhe kjo ndikoi për përcaktimin e perceptimeve të gabuara se gjoja flitet për konstruksione burokratike, sidomos për shkak se manipulimi me të dhënat zyrtare gjatë dekadave të shkuara ishte pjesë e arsenalit të qendrave të korruptuara politike të fuqisë.

Duke e parë nevojën e qytetarëve për prezantimin e gjendjes jo vetëm nëpërmjet numrave të dhënë në konferencat për shtyp, por edhe nëpërmjet informimit kredibil nga terreni, medie të caktuara profesionale motivuan krijimin e dokumentarëve me foto dhe videongjarje me të cilat u prezantuan përpjekjet vetëmohuese të punonjësve të shëndetësisë dhe dëshmitë personale të mjekëve, motrave medicinale, infermierëve, si dhe rastet e rralla të pacientëve që ishin të gatshëm të shpërfaqin publikisht përvojat e tyre (përkundër frikës nga stigmatizimi mbizotërues në disa mese).

3.3. Roli i partive politike

Për fat të keq, gjatë vitit 2020, partitë politike dhe makineria e tyre për marrëdhënie me publikun nuk u përfshinë plotësisht në luftën kundër pandemisë dhe dezinformatave të lidhura me të, kurse një pjesë e tyre në mënyrë të hapur u përpoqën ta shfrytëzojnë gjendjen për përfitime të "pikëve politike" dhe/ose katranosjen e oponentëve politikë. Këto synime konfliktuoze nuk u tejkaluan madje edhe në periudhën parazgjedhore (janar-korrik), kur të gjithë partitë parlamentare u bënë pjesë e strukturave të pushtetit si pjesë e të ashtuquajturës "Qeveria e Përzhinës", me marrjen e ministrive kryesore nga ana e opozitës.

Në përgjithësi, partitë abstenuan nga lufta e hapur kundër dezinformatave të lidhura me Covid-19 edhe në kontekst më të gjerë. Në asnjërin prej rasteve të shumta kur në publik nëpërmjet argumenteve u tha se partia ose funksionarët partiakë, me qëllim ose pa qëllim, luajtën role për përhapjen e dezinformatave, nuk pati publikime të njoftimeve partiake me të cilat partia distancohet prej veprimeve të tilla, kërkon ndjesë nga publiku dhe me emetimin e fakteve të verifikuara ndihmon demantimin e dezinformatave. Ky konstatim i përgjithshëm ka të bëjë edhe me rastet kur parti dhe politikanë të caktuar u shndërruan në burime aktive të dezinformatave, si dhe në rastet kur ata ishin viktime, përkatësisht kur "ranë në kurthin" e manipulimeve të huaja.

Përpjekja për shfrytëzimin e qëndrimeve dhe frustrimeve të qytetarëve lidhur me pandeminë dhe masat preventive për qëllime partiake, veçmas përpjeket për orientimin e fajit drejt kundërshtarit politik nëpërmjet ngulfatjes së besimit në institucionet e sistemit kontribuan edhe në uljen e efikasitetit të masave si dhe zmadhimin e polarizimeve ekzistuese dhe thellimin e ndarjeve të shoqërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Vazhdimi i praktikës së fajësimit dhe sulmeve verbale, përkatësisht bërja me çdo kusht e fushatës negative, destruktive, të vazhdueshme dhe ngulmuese ndaj kundërshtarit politik, madje edhe me çmimin e përhapjes së dezinformimeve për Covid-19, tregoi se prioriteti kryesor i disa partive është përfitimi i pikëve politike, qoftë edhe me çmimin e së vërtetës, qoftë edhe me çmimin e jetëve njerëzore dhe përhapjes së pandemisë.

Në suazat e kësaj shprehie bën pjesë edhe përzjerja e qëndrimeve në lidhje me Covid-19, me insistimin me çdo kusht për hakmarrje verbale, madje edhe për padrejtësitë e imagjinuara prej para pesë vitesh ose dekadës së tërë në të shkuarën. Partitë politike kanë mbamendje të gjatë në drejtimin më të keq të mundshëm dhe pandehin se kanë të drejtë të përhapin dezinformata për Covid-19, nëse kjo ua mundëson ta nxijnë kundërshtarin politik për diçka që ka ndodhur në

KUNDËRSPIN

zbulimi i të gjitha spineve

Spinet për Covid-19 dhe zgjedhjet

Mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, fillimisht të caktuara për 12 prill, për shkak të situatës së jashtëzakonshme u shtynë për 15 korrik.

Në periudhën parazgjedhore mjet manipulimesh edhe nga ana e partive politike⁵⁵ edhe nga mediet e afërta me to, ishte data e mbajtjes së zgjedhjeve⁵⁶ në kombinim me akuzat se do të flijoheshin me qëllim jetë njerëzish⁵⁷, protokollet dhe procedurat⁵⁸, si dhe trajtimi i privilegjuar i grupeve të caktuara të zgjedhësve.⁵⁹

të shkuarën në kontekst krejtësisht të ndryshëm, duke shfrytëzuar metodat për defokusim, të kundërta me mendimin kritik.

Shumë parti e kanë bërë praktikë ndihmën dhe përkrahjen e fshehtë të botimeve elektronike partiake, të cilat me direktiva ose në funksion të tërheqjes së opinionit përhapin me senzacionalizëm dezinformata në rrjetet sociale. Praktika e këtyre të "pronësisë nën hije", kur de jure pronari është i entitetit komercial, kurse de facto pronari i vërtetë është vetë partia politike, e cila ka mundësi t'i shmanget përgjegjësisë ligjore dhe politike për veprimet dhe dezinformatat e përhapura të këtyre medieve.

Jokonsekuanca e partive politike të pozitës

Nga fillimi i pandemisë gjer më sot në disa raste përfaqësuesit e partive politike në pushtet (LSDM, BDI), ose pozita, me sjelljen e tyre e ndihmuan përhapjen e dezinformatave ose hutive në publik. Në përgjithësi, transparenca e pamjaftueshme në nivele më të ulëta/në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) gjithashtu paraqet faktor që pengon ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe gazetarëve, si dhe me opinionin më të gjerë.

Veprimet jokonstruktive përfshijnë humbjen e rasteve për të dëshmuar udhëheqje nëpërmjet shembullit personal për zbatimin me konsekuencë të masave ose dërgimin e porosive hutuese në opinion nëse ndonjë masë është vendim, urdhër, protokol dhe nëse mund të zbatohet ligjërisht, siç qenë pjesëmarrjet e qytetarëve në përmbushjen e lirive dhe të drejtave të tyre fetare, mbajtja e maskave në ambiente të hapura ose ndalimi/udhëzimi për ndalimin e grupimeve nëpër shtëpi, banesa, uikend shtëpiza... Për shembull, përdërisa mbajtja e maskës gjatë gjithë paraqitjeve publike në vitin 2020 u shndërrua në rregull të pashkruar, për liderët e pjesës më të madhe të Bashkimit Evropian, kjo nuk u ngulit me sistem në strategjitë për marrëdhënie me publikun të partive politike.

Një pjesë e sjelljeve të këtyra janë pjesë e kontekstit më të gjerë, kurse mungesa e një shpjegimi të pranuar gjërisht ose llogaridhënia për to ishte bazë për përhapjen e dezinformatave shtesë:

- Zbatimi i ngathtë dhe i pamjaftueshëm i vullnetit politik për ndëshkimin e personave juridikë, të cilët i keqpërdorin subvencionet shtetërore si masë për të prekurit nga pandemia.
- Nazet e kohëpaskohshme me publikun në raport me traditat fetare apo gjithëpopullore, që janë të rrezikshme për përhapjen e virusit.
- Nazet e vazhdueshme, veçanërisht në pjesën e dytë të vitit me vendosjen ose zbatimin e maseve ose protokolleve të dedikuara për sjelljen e operatorëve ose segmenteve të ndryshme të sektorit juridik në industri, hotelieri dhe turizëm.

Ndikimi partiak në rrjetet sociale – armatat opozitare të trolleve

Sipas thënieve të funksionarëve të tyre, dihet se një pjesë e partive politike kanë formuar **armata trollesh**, që janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të drejtuesve të partisë, duke punuar në simbiozë me mediet e afërta me partinë.⁶⁰ Bie fjala, ish-ministrja dhe deputetja e VMRO-DPMNE-së flet publikisht për ekzistencën e ekipit partiak për përhapjen e gjuhës së urrejtjes, linçit mediatik dhe propagandës politike në internet.⁶¹ Një sërë profilesh anonime të angazhuara në fushatën Bojkotoj në shtator të vitit 2018 (kundër referendumit për inkuadrim në BE dhe NATO me emër të ndryshuar të shtetit), më pas u zbuluan se janë drejtuar nga persona të lidhur me partinë "Levica" (e Majta).

Armatat partiake të trolleve në dukje përbëhen nga bërthama e lidhur me qendrën për komunikime të partisë së caktuar, përkatësisht me ekipin e specialistëve me përvojë dhe bashkëpunon me mediet e afërta me partinë.

Ekipi bazë drejton rrjetin e profileve të rreme, si dhe faqet dhe grupet në Facebook, lidhja e të cilëve me partinë nuk është transparente, kurse shfrytëzohen për rritjen e shikueshmërisë dhe për krijimin e iluzionit të masivitetit. Në disa raste, anëtarësia më e gjerë e partisë me metoda të ndryshme nxitet t'u ofrojë ndihmë profileve ose faqeve të tilla nëpërmjet shpërndarjes, pëlqimeve dhe komenteve (për shembull, me imponimin e përmbushjes së "normës" me reagimet e ditëpërditshme për përmbajtjet e faqeve të caktuara nëpërmjet urdhërave të drejtpërdrejtë të komiteteve komunale dhe/ose porosive private dhe grupeve të serviseve për mesazhe, të ashtuquajtur Mesenxherë).

Ekzistojnë shenja se në formimin dhe mbindërtimin e rrjeteve të tilla luajtën rol edhe specialistët të cilët në vitin 2015 bartnin ekspertiza nga Rusia.⁶² Fermat partiake të trolleve bashkëpunojnë me **fermat e trolleve komerciale** të vendeve të huaja, që funksionojnë si mercenarë dhe huazojnë shërbimet e profileve të drejtuara nga njerëzit ose në mënyrë automatike.⁶³

Brenda shtetit janë aktive edhe fermat e trolleve vendore komerciale, që përhapin dezinformata me qëllim të përfitimeve nëpërmjet shpalljeve për lexuesit nga SHBA dhe Evropa Perëndimore⁶⁴, por nuk ka të dhëna të arritshme publike për atë se në çfarë mase përputhen anëtarët e dy llojeve të këtij rrjeti.

Parti të caktuara politike e shfrytëzuan në mënyrë të hapur prezencën e tyre në rrjetet sociale për të përhapur dezinformata të publikuara paraprakisht nga armata e trolleve. Bie fjala, në **fushatën kundër verifikimit të fakteve**, me qëllim të fshehjes së perceptimeve që do ta njësonin me censurën e zbatuar nëpërmjet linçit mediatic të gazetarëve dhe aktivistëve, që përfshinë kërcënimet e drejtpërdrejta, gjuhën e urrejtjes dhe format tjera të maltretimimit dhe nxitjes së dhunës. Në këtë fushatë, të nisur në nëntor, drejtpërdrejt morrën pjesë edhe faqet e “Facebook-ut” të partive parlamentare VMRO-DMPNE (Komiteti Lokal) dhe “Levica” (e Majta), që përhapën pastime të rreme dhe shpifëse nga faqet e administratorëve anonimë.⁶⁷

Më vonë, nëpërmjet deklaratave zyrtare, kësaj fushate iu bashkangjiten dhe kryetari i VMRO-DPMNE-së, si dhe figura të sferës akademike, të cilët morën rolin e zëdhënësve. Për shembull, një profesor universitar, i cili në kohën e pushtetit të tyre u vendos në një pozitë të lartë shtetërore (ambasador). Nëpërmjet profileve në FB u inkuadruan aktivisht edhe një pjesë e drejtuesve të Maqedonisë së Vetme, parti e cila i përfaqëson interesat e Kremlinit, kurse është krijuar sipas modelit të Rusisë së Vetme të Putinit.



Fushata kundër konceptit të verifikimit të fakteve dhe gazetarët të cilët praktikojnë

Gjatë muajit nëntor medie të afërta me partitë politike djathtiste nisën fushatën me të cilën verifikuesit e fakteve, nëpërmjet shpifjeve se kane “fshirë” përmbajtjet patriotike nga “Facebook-u” dhe kanë nxitur dhunë kundër tyre. Edhe pse Këshilli për Etikë në medie këto veprime i gjykoj si joprofesionale⁶⁵, linçi mediatic vazhdoi nëpërmjet deklaratave të politikanëve⁶⁶, surrogatë dhe armatat e trilleve.

3.4. Roli i sektorit privat

Edhe pse sipas rregullit të gjithë anëtarët e shoqërisë nëpërmjet sjelljes etike mund dhe duhet të kontribuojnë në luftën kundër dezinformatave, roli i sektorit privat në këtë studim vështrohet nga aspekti i ndikimit të tij në sferën mediatike. Megjithatë, nuk ka informata të qasshme publike se firmat e RMV në kuadër të politikave të tyre për përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjeve, ose përgjegjësinë shoqërore korporative (corporate social responsibility), ose kodekseve etike, ose rregullave të sjelljes në forma të ortakërisë (asociacioneve) e kanë të përfshirë edhe këtë çështje.

Në këtë rast, është i rëndësishëm roli i subjekteve afariste, që janë pronarë të drejtpërdrejtë të medieve dhe si të tillë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në politikën redaktoriale, si dhe shumë qarqe më të gjera biznesesh që sigurojnë përkrahje financiare për mediet nëpërmjet reklamave ose sponsorimeve.

Informatat e marra nga përfaqësuesit e më shumë subjekteve afariste, si dhe nga ekspertët e sektorit qytetar që merren me përgjegjësinë shoqërore të

ndërmarrjeve, tregojnë se bizneset e orientojnë përgjegjësinë për ndarjen e mjeteve për reklama ose për pjesë të veçanta ose agjenci për marketing, përkatësisht agjenci për marrëdhënie me publikun, me çka kushti kryesor është mundësia që nëpërmjet mediumit të caktuar të ndikohet në një grup të synuar (lokalitet të caktuar, gjuhë, sipas moshës dhe fushës së interesimit) ose mbi tërë publikun.

Në nëntor të vitit 2019 u publikua Regjistri i medieve profesionale onlajn (promedia.mk), i themeluar nga KEMM dhe SHGM dhe u paralajmërua edhe bashkëpunimi me Odën Ekonomike të Maqedonisë që do ta orientojë bashkësinë afariste të mos reklamohet në mediet “të cilat nuk i plotësojnë kriteret për anëtarësim dhe rregullisht i shkelin standardet etike”.⁶⁸

Gjatë vitit nuk pati raste të njohura në publik të reklamuesve që ndërprejnë marrëveshjet për bashkëpunim me mediet për shkak të përhapjes së dezinformatave.

The screenshot displays the KriThink website interface. At the top, there are logos for the European Union, the project 'Critical Thinking for Media-wise Citizens - CriThink', and other partners like 'EY 20 TESE' and 'METAMORPHOSIS'. The main navigation bar includes links for 'НАСЛОВНА', 'ЗА ПРОЕКТОТ', 'ПРОВЕРКА НА ФАКТИ', 'ЕДУКАТИВНИ НАПИСИ', 'ВЕСТИ', 'Е-БИБЛИОТЕКА', 'ГРАНТОВИ', and 'КОНТАКТ'. Below the navigation, there is a section titled 'Едукативни написи' with a featured article: 'Кој прв почна да шири дезинформации за 5Г?' dated 11/06/2020. The article content shows a grid of images related to 5G technology. To the right of the article is a contact form with fields for 'name', 'e-mail address', and 'message', and a 'Send' button. Below the contact form is a graphic titled 'ПРЕГЛЕД НА ДЕЗИНФОРМАЦИИ И МАНИПУЛАЦИИ ЗА НОВИОТ КОРОНА-ВИРУС КОВИД-19' featuring a virus icon and a group of diverse people.

Analiza e “KriThink” “Kush nisi i pari të shpërndajë dezinformata për 5G?”⁶⁹ tregoi se firmat telekomunikative paguajnë reklama në medime që përhapin teori konspirative ose, thënë figurativisht, “gjuajnë në këmbën e vet”, sepse e financojnë vetë rrënimin e besimit edhe shërbimet e tyre (të ardhshme).

Në situatën kur faktori kryesor për sigurimin e të ardhurave për mediet është popullariteti, kriter bazë bëhet numri i lexuesve ose shikuesve të cilëve mund t'u ofrohen reklama ose t'u ofrohet ndonjë ndikim politik, e jo kualiteti i informimit gazetaresk.

Kjo, edhe te pronarët edhe te reklamuesit sjell favorizimin e politikave redaktoriale, përkatësisht shtëpive mediatike të cilat mund ta tregojnë numër publiku, që mund të arrihet më lirë nëpërmjet sensacioneve, me ç'rast shpenzimet ulen me pirateri, gjegjësisht më së shpeshti nëpërmjet marrjes së paaautorizuar të përmbajtjeve të huaja (të njohur si gazetari *copy-paste*).

Mes medieve onlajn, prirja e këtyllë rezultojnë në një "luftë të pakompromis për klikime" nëpërmjet hiperproduksionit të përmbajtjeve jokualitative, me qëllim që nëpërmjet kuantitetit të ndikohet mbi grumbulluesit e lajmeve dhe rrjetet sociale. Me këtë rast, dezinformatat dhe spekulimet lidhur me Covid-19 u treguan shumë të klikueshme, duke pasur parasysh nevojën e qytetarëve për t'u njoftuar me informatat e reja që mund të shpëtojnë jetë në kushtet e epidemisë vdekjeprurëse.

Nga aspekti i përparimit të interesit publik, situata e këtyllë është e paqëndrueshme. Zvogëlimi i kualitetit të gazetarisë ose shuarja e saj me shndërrime të medieve në makineri për propaganda politike apo ekonomike, pa zbatimin e standardeve etike, shpie në zvogëlimin e demokracisë dhe kualitetin e jetës. Praktika e marrjes së paaautorizuar të përmbajtjeve i vë pronarët para rrezikut të akuzave për shkeljen e të drejtave të autorit.

Ndikim plotësues ndaj biznesit mediatik ka dhe praktika endemike e pandëshkueshmërisë, sepse pronarët e

strukturave redaktoriale të një pjese të medieve, që në mënyrë të vetëdijshme përhapin dezinformata, janë të përziera në raste shkeljesh të të drejtave të njeriut (gjuha e urrejtjes, rrezikimi i sigurisë së gazetarëve ose këqpërdorimi i forcës mediatike për vepra të tjera penale, si reketimi) ose dyshimi për korrupsion gjatë financimit nga burimet vendore dhe të huaja.

Vetëm një pjesë e vogël e medieve komerciale si emisioni "360 shkallë" dhe portali "Sakam da kazham" (Dua të them) përgjithësisht i referohen praktikës së verifikimit të fakteve si pjesë e punës së tyre, me çka në mënyrë indirekte i kontribuojnë forcimit të vetëdijes publike për rëndësinë e konceptit.

Parë në tërësi, mediet komerciale më së shpeshti e injorojnë në mënyrë të vetëdijshme këtë fushë të gazetarisë (pavarësisht se i ndjekin me kujdes procedurat e verifikuesve të fakteve, që veprojnë publikisht), ose sillen ndaj saj si ndaj një kërcënimi, madje edhe vetëdijshëm ose pavetëdijshëm u bashkangjiten fushatave dezinformative kundër konceptit.


3.5. Roli i shoqërisë qytetare

Në raport me luftën kundër dezinformatave, organizatat qytetare në RMV kanë rol vendimtar si ngritës të iniciativave për promovimin e edukimit mediatic, mendimit kritik, standardeve gazetareske dhe verifikimit të fakteve. Numri i organizatave që janë aktive në vazhdimësi në këtë sferë është relativisht i kufizuar dhe shpreh edhe gjendjen e kapaciteteve të ulëta dhe mungesën e resurseve të përgjithshme në vend, veçmas jashtë kryeqytetit, në qytetet më të vogla dhe në meset rurale.

Përpjekjet për forcimin e kapaciteteve të sektorit të kësaj sfere zbatohen kryesisht nëpërmjet projekteve të përkrahura nga donatorët e jashtëm në të cilat organizatat më me përvojë drejtojnë programe për subvencione. Shembull është programi i Delegacionit

të Bashkimit Evropian për përkrahjen e projekteve të edukimit mediatic (IPA Civil Society Facility and Media Programme 2016-2017), nëpërmjet të cilit, në periudhën 2018 -2021 janë përkrahur tre subvencione të drejtuara nga "Metamorfozis", IMM dhe FRA.

Një pjesë e organizatave qytetare përmbahen nga pjesëmarrja në aktivitete kundër dezinformatave për shkak të frikës nga hakmarrja e qendrave të forcës që i përhapin ato. Për shembull, vetëm disa prej mijëra organizatave qytetare (OQ), me deklarata publike e kundërshtuan fushatën e verifikimit të fakteve, (SHGM, KEMM, SPGPM, MOST, Civil, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut).



Iniciativat qytetare për informim për aspektet e Kovid-19

Përgjithësisht, fokusi i iniciativave qytetare lidhur me pandeminë ishte sigurimi i informatave të sakta, kundrejt detektimit të dezinformatave dhe zbatimit të aktiviteteve kundër tyre. Shembull për projektet informative janë lokalizimi i aplikacionit jofitimprurës slloven për ndjekjen e të dhënave për përhapjen e Kovid-19 "Sledilnik" ose "Treker" për RMV, që përfshinte edhe angazhimet vullnetare për përkthim në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Shumë OQ të specializuara për fusha të ndryshme publikuan edicione informative për grupet e tyre të synuara (p.sh. HERA ka seksion të veçantë në ueb-faqen e saj për ndikimin e Kovid-19 në shëndetin seksual dhe reprodutiv⁷¹).

Kontrollimi i publikimeve mediatike në vitin 2020 nuk tregon shembuj reagimesh të organizatave qytetare për dezinformata që kanë pika të përbashkëta me fushën e ekspertizës së tyre.

Iniciativat qytetare për luftë të drejtëpërdrejtë kundër dezinformatave

Në dallim nga sektori komercial, gjatë periudhës së shkuar organizatat qytetare kishin rol vendimtar në njohjen dhe theksimin e problemit me dezinformatat, si dhe ngritjen e iniciativave për përbalim me atë

problem në mënyra të ndryshme. Kjo bëhej në dy mënyra – nëpërmjet angazhimit të medieve në pronësi të shoqatave qytetare ose, nëpërmjet projekteve të veçanta të lidhura më promovimin dhe zbatimin e verifikimit të fakteve si lloj i specializuar mediatik, edukimit mediatik ose analizimit të fenomenit të dezinformatave nga aspektet e ndryshme. Tabela në vijim ofron pasqyrën e projekteve dhe medieve të lidhura më këtë temë.

Për këtë tip aktivitete, organizatat qytetare sigurojnë mjete kryesisht nga burimet e jashtme, më saktësisht nga donatorët e vendeve të NATO-s dhe BE. Tanipërtani nuk ekzistojnë informata të arritshme publike për pjesëmarrje të donatorëve të brendshëm, veçanërisht atyre që janë të lidhur me sektorin privat të vendit dhe financimin e aktiviteteve për luftë kundër dezinformatave.

Projektet për luftë kundër dezinformatave ballafaqohen shpesh me injorim nga ana e medieve komerciale, por edhe nga ane e OJQ-ve. Përshtypja e përgjithshme është se organizatat qytetare më shumë gjurmojnë projektet e tyre që i kanë punuar për këtë temë sesa kontribuojnë për përhapjen më të gjerë të përmbajtjeve ekzistuese të krijuara kundër dezinformatave.

Mediet e tjera në pronësi të organizatave qytetare, ose personave të tjerë juridikë, kanë hapur rubrika të veçanta ose kategori në të cilat botojnë artikuj dedikuar luftës kundër dezinformatave, si verifikimi i fakteve, lajme ose përmbajtje të tjera analitike nga kjo fushë.

Projekti/medie e specializuar	Ueb-faqja	Implementuar nga	I themeluar	Gjuhët
Vërtetmatës	vertemates.mk	Metamorfozis	2011	Maq, shq, ang
Metamorfozis	2011	Maq, shq, ang	2012	Maq, shq, ang
Shërbimi për verifikimin e fakteve në medie	Verifikimiifakteve.mk	Metamorfozis	2012	Maq, shq, ang
Mendim kritik për qytetarët me shkathtësi mediatike - KriThnik	crithink.mk	IMM, IKS, SPGPM	2018	Maq
Metamorfozis, Eerothink	2018	Maq, shq	2018	Maq, shq, ang
Stop dezinformata	stop dezinformacii.mk	IMM, IKS, SPGPM	2018	Maq
Fighting Fake News Narratives	f2n2.mk	MOCT	2018	Maq, shq, ang

Medie	Ueb-adresa	Implementuar nga	I themeluar	Gjuhët
Portalb	portalb.mk	Metamorfozis	2012	Shq
Radio FRA	radiomof.mk	FRA	2013	Maq
Agjencia e lajmeve Meta.mk	meta.mk	Metamorfozis	2014	Maq, ang etj.
CIVIL MEDIE	civilmedie.mk	CIVIL	2015	Maq
Front Line (Vija e parë)	frontline.mk	Shortkat	2019	maq

Rol më të përgjithshëm në luftën kundër dezinformatave kanë dhe organizatat qytetare i pjesë esistemit **vetërregullues në kuadër të profesionit gazetaresk** (shih kapitullin 2.4), si dhe organizatat që konsiderohen si mediatike, përkatësisht të specializuara për **promovimin e standardeve profesionale gazetareske**. Këtu bëjnë pjesë organizatat ndërkombëtare që janë edhe pjesë e rrjeteve të sferës së tyre specifike:

- Këshilli për Etikë në Medie (semm.mk)
- Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (znm.org.mk)
- Instituti për Medie i Maqedonisë (www.mim.org.mk)
- Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë (ssnm.org.mk)

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut burimet e dezinformatave më së shpeshti janë të involvuara edhe në përhapjen e **gjuhës së urrejtjes** dhe format e ndryshme të diskriminimit si mjet të propagandës politike. Disa organizata janë aktive në kontinuitet në sferën e zbulimit dhe ballafaqimit me gjuhën e urrejtjes, ndërmjet tjerash edhe nëpërmjet kërkimit të llogarisë nga institucionet shtetërore të obliguara të zbatojnë Kodin Penal të kësaj fushe.

- Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut (mhc.org.mk) pëmban dhe dy platforma për raportimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes (govornaomraza.mk) dhe krimeve që vijnë nga urrejtja (zlostorstvaodomraza.com).

- Qendra për liri - CIVIL (civil.org.mk), e monitoron gjuhën e urrejtjes si pjesë të aktiviteteve të rregullta e posaçërisht gjatë monitorimit të zgjedhjeve dhe ngjarjeve të ngjashme të rëndësishme.
- “Metamorfozis”, ka në fokus gjuhën e urrejtjes në internet, nëpërmjet qendrës për resurse “Stop gjuhës së urrejtjes në internet”(nemrazi.mk).

Rrjetëzimi në nivel kombëtar

Në vitin 2017, me iniciativë të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike, u themelua **Rrjeti për edukim mediatik** (mediumskapismenost.mk).

Ky rrjet funksionon në nivel kombëtar, para së gjithash në drejtim të promovimit të edukimit mediatik si vlerë, promovimit të rezultateve dhe rritjes së ndikimit të punës së anëtarëve të fushës në kuptimin më të gjerë, veçanërisht nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të përbashkëta prej të cilave më i rëndësishëm gjer tani është manifestimi vjetor Ditët e edukimit mediatik, i cili është i harmonizuar me Javën e edukimit mediatik të UNESKO-s.

Rrjeti ka 62 anëtarë (institucione publike dhe ministri, organizata qytetare, institucione edukative dhe transmetues radiodifuzivë) dhe është i hapur në vazhdimësi për anëtarë të rinj. Gjatë vitit 2020 ky rrjet ndërmorri aktivitete për ngritjen e strukturave interne institucionale (trupa punuese, strategji për marrëdhënie me publikun) me të cilët do të mundësohet efikasiteti i tij më i lartë.

Rrjetëzimi në nivel ndërkombëtar


Disa prej organizatave të sipërpërmendura qytetare nga RMV janë edhe anëtare të rrjeteve ndërkombëtare të përkushtuara ndaj luftës kundër dezinformatave.

Rrjeti i tillë më i rëndësishëm, **Rrjeti Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve - RNVF** (International Fact-Checking Network - IFCN), është asociacioni i tillë më i madh në botë, i themeluar në shtator të vitit 2015. Në kuadër të Rrjetit është zhvilluar edhe Kodeksi i principeve⁷², që përfshin marrjen e obligimeve për sigurimin e kualitetit dhe transparencës së anëtarëve. Rrjeti bën licensimin e nënshkruesve në nivel vjetor. Fondacioni “Metamorfozis” mori pjesë në themelimin e RNVF, kurse shërbimi “Vërtetmatës” është njëri prej 75 redaksive të çertifikuara për verifikimin e fakteve në nivel botëror.

Si përgjigje e përhapjes së dezinformatave për Covid-19, anëtarët e IFCN, në janar të vitit 2020 e formuan **Aleancën e Fakteve për Koronavirusin** (Corona Virus Facts Alliance), iniciativën më të madhe të përbashkët të kësaj fushe në nivel botëror, së cilës, gjatë vitit pasues, iu bashkangjitën 99 organizata nga më shumë se 70 vende⁷³. Mjeti kryesor i Aleancës është baza e të dhënave⁷⁴, e cila për një vit mbledhi 10.300 verifikime të fakteve nga e gjithë bota, të bëra në mënyrë origjinale në 40 gjuhë, ndër të cilat “Vërtetmatës-i” kontribuoi me rreth 180 verifikime nga Maqedonia e Veriut. Të dhënat futen në bazë në gjuhën angleze e spanjolle dhe janë të krahasueshme me njëra-tjetrën, që mundëson bërjen e analizave dhe ndjekjen e tendencave. Aleanca

gjithashtu ofron forma të ndryshme të përkrahjes së projekteve nga anëtarët nëpërmjet organeve të donatorëve të ndryshëm, të cilët i administron RNVF. Në nivel rajonal, organizatat nga RMV janë aktive edhe në rrjetet në vijim të cilat kanë pika të përbashkëta ose fokus tematik për promovimin e luftës kundër dezinformatave.

- ACTION SEE - Accountability, Technology and Institutional Openness Network in the South East Europe region (actionsee.org), e themeluar nga organizatat që nisen të parat me projektet për verifikimin e fakteve në vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërmjet të cilave edhe “Metamorfozis”.
- ADN Balkans – Anti-Disinformation Network for the Balkans (antidisinfo.net) ka anëtarë heterogjenë, që përfshijnë organizata për verifikimin e fakteve, organizata mediatike dhe medie individuale edhe nga vendet kandidate edhe nga vendet anëtare në BE nga Ballkani. Është themeluar nga “Metamorfozis”, bashkë me 9 organizata nga Serbia, Kosova, Shqipëria, Greqia dhe Bullgaria.
- SEE Check (fb.me/See Check Network) është rrjet i portaleve për verifikimin e fakteve dhe luftën kundër dezinformatave nga vendet e ish-Jugosllavisë, me përjashtim të Kosovës. Anëtare e këtij rrjeti nga RMV është asociacioni MOST, me portalin F2N2.mk.



poynter.org/ifcn-Kovid-19-misinformation/

3.6. Roli i bashkësisë akademike

Përkundër potencialit të jashtëzakonshëm të institucioneve shkencore-hulumtuese, si dhe nevojës për përfshirjen e tyre në luftë kundër dezinformatave të lidhura me pandeminë, gjatë vitit 2020 institucionet akademike, si Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë - ASHAM, universitetet dhe institutet ishin tërësisht joprezepte në publik në këtë aspekt.

Informatat publike për punën e shkencëtarëve që merren me hulumtimin e kësaj teme janë të pakta dhe varen nga entuziazmi personal i krijuesve të tillë, që më së shpeshti janë të përfshirë edhe në rrjetet dhe projektet hulumtuese ndërkombëtare. Numri i shkencëtarëve gjatë vitit 2020 që u paraqitën me deklaratat publike si reagime për dezinformata të konkrete për Covid-19 është relativisht i vogël, veçanërisht në raport me numrin e përgjithshëm të veprimtarëve akademikë edhe në institucionet publike e private shkencore dhe arsimore.

Thirrja në autoritet

(ang. appeal to authority)
është gabim logjik ku mendimi i personalitetit të prezantuar si autoritet ofrohet si dëshmi për validitetin e një qëndrimi të caktuar, kurse shfrytëzohet në demagogjinë politike dhe marketingun komercial.

Për shembull, në “Udhëzuesin e mendimtarit për gabime logjike” është përmendur punësimi i shkencëtarëve që e mohojnë ose e minimizojnë veprimin e dëmshëm të duhanit të firmave që shesin cigare në SHBA, që e financuan edhe krijimin e Institutit të tyre Amerikan për Duhan.⁷⁵


Përkundër kësaj, gjatë vitit 2020, shumë medie vazhduan me promovimin e personave të sferës akademike si autoritete që, në të vërtetë, në cilësi të “ekspertëve” promovuan qëndrime politike dhe mendime personale paushalle, të pambështetura në hulumtime shkencore dhe të prezantuara pa verifikimin elementar të fakteve. Metodrat kryesore të promovimit ishin emetimi i deklaratave, veçmas statuset në rrjetet sociale dhe ftesat në emisionet *tok-show*.

Mediet e këtilla pa filtra gazetareske emetojnë deklarata të “autoriteteve” vendore dhe të huaja, në mesin e të cilëve, në fakt, nuk ka autoritete për një problematikë konkrete⁷⁶ ose autoritetin e tyre të fituar jo për shkak të profesionalizmit por në baza të tjera (për shemull, politikanë ose personalitete të famshëm). Kishte dhe shumë raste të promovimeve mediatike të personave me arsimim medicinal, që as nuk janë mjekë të licencuar dhe nuk kanë përvojë të drejtëpërdrejtë në punën me pacientë të sëmurë nga Covid-19, as nuk janë involvuar në hulumtimet kredibile shkencore të lidhura me sëmundjen..

Këta persona nxjerrin shpesh deklarata të kundërta me faktet e verifikuara shkencore, ose në rastet e profesorëve universitarë, që jepnin deklarata të bazuara në atë që e kanë dëgjuar prej medieve, pa bërë analiza sipas standardeve shkencore. Mënyra e emetimit të këtyre deklaratave gjithashtu ishte jo precize ose paushalle, dhe sillte gjer tek hutia e publikut ose mundësonte manipulimet e mëtutjeshme mediatike. Një pjesë e deklaratave të këtilla gjithashtu përmbanin dhe elemente të diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, që, përkundër reagimeve të organizatave për të drejtat e njeriut u injoruan përgjithësisht edhe nga mediet tradicionale edhe nga institucionet “amë” akademike, prej të cilave personat e tillë e fitojnë autoritetin publik.

Një shembull është skandali me akademikën Katica Qullavkova, anëtare e ASHAM, e cila në një tuit u përpoq ta hedhë fajin për përhapjen e Covid-19 mbi etnitë dhe bashkësitë e caktuara fetare duke e mohuar konceptin e bashkëjetesës në shoqërinë multietnike.⁷⁷ (përvoja e luftërave ballkanike e viteve të 90-ta, tregoi se “alternativa” e këtij koncepti është pastrimi etnik ose gjenocidi). Pas reagimit të qytetarëve akademikja e mbylli shpejt profilin e saj në “Twitter”. Në reagimin e Komitetit të Helsinkit⁷⁸ nuk kishte përgjigje institucionale as nga prokuroria as nga institucionet akademike, kurse

mediet e orientuara kombëtariste dhe rrjetet partiake të trolleve e paraqitën Qullavkovën si viktimë të ndjekjes politike.



Ashtu si në shumë raste të ngjashme, pjesa më e madhe e medieve nuk treguan interes dhe nuk kërkuan përgjegjësi nga personalitetet që përhapin dezinformata nga pozita e forcës në sferën akademike, e me këtë edhe kontrollin e resurseve dhe mundësive të rëndësishme shtetërore për ndikim edhe ndaj kolegëve edhe ndaj studentëve.

Nuk ekzistojnë informata të qasshme publike për asnjë iniciativë të nivelit institucional për kërkim përgjegjësie të anëtarit në institucionin akademik për deklarata publike në të cilat nëpërmjet përhapjes së dezinformatave ose promovimit të diskriminimit janë shkelur standardet themelore etike të bashkësisë shkencore, që përfshinë përkushtimin ndaj zbulimit të së vërtetës objektive.

3.7. Roli i sistemit shtetëror për arsimim formal

Procesi i reformave në nivel shtetëror

Në kontekst të përgjigjes ndaj pandemisë dhe infodemisë, lidhur me sistemin arsimor gjatë vitit 2020 rol kyç luajtën Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe, deri diku, Biroja për Zhvillimin e Arsimit, që është trup përmes të cilit zbatohen proceset e ndryshimit të planeve dhe programeve mësimore si dhe ngritja e kapaciteteve dhe vlerësimi i punës së arsimtarëve të shkollave fillore dhe të mesme.

Si masë kundër përhapjes së Covid-19, Qeveria i mbylli shkollat më 10 mars, kurse pas kësaj gradualisht u futën metodat e të mësuarit nga distanca.⁷⁹ Për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e vitit 2020-2021, sidomos për trajnimin e arsimtarëve për shfrytëzimin e sistemeve për mësimin online të instaluar ndërkohë. Fillimi i mësimin u shty nga 1 shtatori deri me 1 tetor.

Perveç zbatimit të vendimit për kalim nga mësimi fizik në mësim nga distanca, si masë preventive mbrojtëse për nxënësit dhe arsimtarët, nuk ka të dhëna të qasshme publike se në kuadër të sistemit arsimor shtetëror (arsimi fillor dhe i mesëm) janë zbatuar ndryshime tjera të lidhura me pandeminë. Nuk është vërejtur as ndonjë ndryshim i jashtëzakonshëm i planeve mësimore në drejtim të inkuadrimit të përmbytjeve të reja, me të cilat arsimtarëve dhe nxënësve do t'u sqarohet situata me pandeminë ose do të trajnohen për t'u ballafaquar me dezinformatat lidhur me të. Të dhëna për ndërmarrjen e masave të jashtëzakonshme dhe aktiviteteve arsimore të lidhura me infodeminë nuk ekzistojnë as për universitetet publike, që gëzojnë autonomi në raport me institucionet shtetërore, as për institucionet arsimore private të të gjitha niveleve.

Në nivel të sjelljes së politikave që do të kenë ndikim në të ardhmen, pandemia e Covid-19 e nxiti nevojën për fillimin e një sërë reformash për modernizimin e arsimit, mes të cilave dhe inkuadrimit e edukimit mediatik, që ndikoi pozitivisht në rritjen e vullnetit politik⁸⁰ për mbylljen përfundimtare të procesit të filluar në vitin 2019. Preokupimi me aktivitetet e ngutshme të të punësuarve në sistemin arsimor si përgjigje ndaj pandemisë vuri në dukje faktorin për shkak të të cilit gjatë pranverës nuk vazhdoi me punë Grupi punues multisektorial prej 16 anëtarësh me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, sferës akademike, organizatave qytetare që

punojnë në edukimin mediatik dhe bashkësisë mediatike si pjesë e Koalicionit për edukim mediatik të inicuar nga MIM.

Gatishmëria për ballafaqim me manipulimet mediatike “duhet të bëhet pjesë e reagimit institucional te çdo qytetar i ardhshëm, të cilin e ndërtojmë tani nëpërmjet sistemit arsimor dhe krijojmë personalitet që do të ketë mendim kritik dhe do të mund të përcaktojë çfarë është dhe çfarë nuk është e vërtetë”
– Milla Carovska, ministre e arsimit dhe shkencës në RMV.

Nga ana tjetër, rezultatet e procesit u shfytëzuan nga institucionet shtetërore për përgatitjen e reformave më gjithëpërfshirëse në sistemin arsimor, nëpërmjet futjes së Konceptit të ri për arsimin fillor. Gjatë paralajmërimit të procesit të konsultimeve për konceptin funksionarët relevantë shtetëror, duke nisur që nga ministrja Milla Carovska, theksojnë se qëllimi i reformave është integrimi i mendimit kritik dhe edukimit mediatik në kuadër të gjithë niveleve të arsimit, duke nisur që nga klasa e parë.⁸¹

Konsultimet plotësuese ndërmjet “Metamorfozis” dhe MASH treguan se koncepti i ri do ta mundësojë futjen e përmbajtjeve modulare për edukimin mediatik (të kuptuar në kontekst të gjerë, duke përfshirë edhe edukimin digjital dhe bërjen e rezistencës ndaj dezinformatave), si module në të gjitha lëndët, nëpërmjet ndryshimit

të planeve mësimore dhe krijimit të përmbajtjeve mësimore në gjysmën e parë të vitit 2021, me qëllim që zbatimi i tyre të fillojë nga viti i ardhshëm shkollor. Faktor i rëndësishëm për realizimin e këtij ndryshimi është sigurimi i resurseve për trajnimin e arsimtarëve, për çka është treguar gatishmëri për bashkëpunim me organizatat qytetare që kanë përvojë në arsimin joformal për edukimin mediatik dhe një sasi përmbajtjesh edukative të adaptuara në kontekstin lokal.

MASH planifikon që reformat në arsimin fillor të shërbejnë si model edhe për pjesët tjera të sistemit arsimor, për të cilat gjithashtu planifikohet integrimi i edukimit mediatik gjatë periudhës së viteve në vijim.

Roli i shkollave dhe arsimtarëve

Informatat e fituara prej prindërve dhe nxënësve të arsimit fillor tregojnë se gjatë pandemisë nga ana e shkollave dhe arsimtarëve atyre nuk u janë ofruar informata plotësuese në lidhje me pandeminë, me përjashtim të informatave që kishin të bëjnë me realizimin e mësimin.

Në mënyrë specifike, në kuadër të mësimin nuk janë vërejtur përpjekje nga arsimtarët që nxënësve dhe prindërve t’u ofrojnë sqarime për çështjet e lidhura me dezinformatat gjerësisht të përhapura për Covid-19 nga fusha e tyre profesionale. Për shembull, në orët e shkencave të natyrës. Në kuadër të lëndës së biologjisë për klasën e shtatë ka leksione për mikroorganizma dhe sëmundje që mund të plotësohen me diskutime për koronavirusin, kurse njohuritë nga leksionet për ujin në ambientin jetësor, në të cilat sqarohet se kondenzimi dhe cikli i ujit janë bazë për diskutimin e teorisë së konspiracionit për gjoja stërpikjet me aeroplanë.

3.8. Roli i platformave të rrjeteve sociale

Platformat më popullore të rrjeteve sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë "Facebook" dhe "Twitter" tek gjeneratat më të moshuara, kurse "YouTube" dhe "Instagram" tek më të rinjtë. Krahas tyre, mes fëmijëve janë të popullarizuara edhe "Tik-tok" dhe "Twitch". Si përgjigje ndaj pandemisë, në nivel global secila prej këtyre platformave ndërmori masa të caktuara të drejtuara kah informimi i shfrytëzuesve, kurse një pjesë e tyre inkuadroi dhe mekanizma për kundërshtimin e drejtpërdrejtë të vërshimit të dezinformatave.

Promovimi i burimeve kredibile të informatave për pandeminë

Një pjesë e këtyre aktiviteteve përfshijnë promovimin e burimeve zyrtare të dezinformatave si OBSH, por me vendosjen e burimeve zyrtare lokale nga ana e qeverive të shteteve të caktuara edhe ky tip informacioni u inkuadrua në komunikimin e shfrytëzuesve, i adaptuar sipas rrethanave të vendit. Për shembull, gjatë verifikimit të fjalëve kyçe lidhur me Covid-19, shfrytëzuesit u motivuan ta përdorin faqen e veçantë të quajtur "Qendra Informative për Koronavirusin Covid-19", në të cilën janë përmendur linqet e faqeve të institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare, nga MZ e deri tek UNICEF-i dhe OBSH-ja.

Një pjesë e platformave kanë mundësi për prani të caktuara në mediet sociale (faqe, profile, kanale) që t'i përcaktojnë si zyrtare, përkatësisht të lidhura me entitete të caktuara, me çka forcohet kredibiliteti i tyre para shfrytëzuesve dhe zvogëlohet mundësia që entitetet private të prezantohen rrejshëm si burime zyrtare, përkatësisht të bëjnë vjedhje të identitetit. Si përgjigje ndaj pandemisë, rrjetet sociale në bashkëpunim me autoritetet mundësuan shënimet shtesë në faqet zyrtare / profilet e institucioneve shtetërore, gjë që s'ishte e mundur të bëhej në të shkuarën, si për pjesëmarrjet speciale që u zhvilluan ndërkohë.

Shembull për bashkëpunimin e këtyre është vendosja e statusit të veçantë për kanalin e Qeverisë së RMV në "YouTube", mjet primar për emetimin e konferencave për medie të organizuara nga ministri i shëndetësisë ose përfaqësuesit tjerë relevantë. Sipas deklaratës së përfaqësuesit të Qeverisë së RMV,⁸² kanali i Qeverisë YouTube ishte caku i sulmeve të koordinuara, që përfshinin edhe keqpërdorimin e sistemit të paraqitjes së parregullsisve nga ana e shfrytëzuesve, nëpërmjet vërshimit të paraqitjeve të rreme. Pas paraqitjes së këtij kërcënimi "YouTube" siguroi status special për kanalin, i cili në kuadër të algoritmit të platformës e bën imun ndaj tipeve të caktuara të ankesave, që nëse janë të shumta, mund me automatizëm ta bllokojnë punën e tij, kurse pretendohet se mundëson mbrojtje teknike edhe nga llojet tjera të veprimeve dashakeqe.

The screenshot shows the Facebook page for the "Coronavirus (COVID-19) Information Center". The page has a blue header with a heart-shaped graphic and two figures. Below the header, there are sections for "Latest Updates" and "Recognized Health Organizations".

Latest Updates:

Entity	New Cases	Total Cases
Republic of Macedonia	+354 (Yesterday)	89,817
Global	(Bar chart)	(Bar chart)

Recognized Health Organizations:

- Министерство за здравство / Ministria e Shëndetësisë (Government Organization)
- Коронавирус МК / Koronavirus MK (Government Organization)
- UNICEF MK (Organization)

Për shfrytëzuesit e RMV, faqja speciale e "Facebook" për informacione lidhur me pandeminë (facebook.com/coronavirus_info) ofron të dhëna për gjendjen dhe institucionet zyrtare në vendin e tyre.

Lufta kundër dezinformatave në mediet sociale

Sipas informatave në dispozicion publik, aktivitetet kundër dezinformatave të disa platformave të rrjeteve sociale përgjithësisht bëjnë pjesë në dy fusha: njëra ka të bëjë me mbindërtimin e mekanizmave ekzistuese për denoncimin e shkeljes së rregullave për shfrytëzim, ndërsa tjetra me inkadrimin e aktiviteteve të reja të dedikuara enkas për zvogëlimin e ndikimit të dezinformatave të identifikuara.

Secili shfrytëzues i rrjeteve sociale, kur bëhet anëtar i një platforme të caktuar nënshkruan marrëveshje valide ligjore që përfshin obligimin e tij për të respektuar rregullat e shfrytëzimit. Parimi se shtypja e butonit "pajtohem" (I agree) në aplikacion ka të njëjtën peshë ligjore me nënshkrimin e marëveshjes në letër, është pjesë e ligjeve për tregti elektronike në RMV, BE dhe SHBA.

Vendosja aktuale e rrjeteve sociale i bëri ato platforma më me ndikim për shpërndarjen e përmbajtjeve në planet. Në këtë infrastrukturë "teknologjikisht neutrale", nga aspekti etik, deri tani nuk është gjetur mënyrë për vendosjen e etikës në algoritmet që të mund të njohin përmbajtjet "e mira" dhe "të këqija" pa intervenimin njerëzor. Njëkohësisht, situata e këtillë i bën algoritmet të varura edhe nga manipulimet e njerëzve që nuk i respektojnë principet etike në aktivitetin e tyre nëpër rrjetet sociale.

Në vijim janë dhënë shembuj të problemeve të njohura të lidhura me rregullat e shfrytëzimit të rrjeteve sociale që ndikojnë në përhapjen e dezinformatave për Covid-19.

- Një pjesë e medieve i promovon përmbajtjet e tyre jo vetëm nëpërmjet faqes zyrtare (nëpërmjet së cilës me regjistrim arrijnë raporte pune me "Facebook"), por nëpërmjet faqeve të tjera jozyrtare me përmbajtje përsëritëse. Kjo jollollojshmëri e përmbajtjeve në faqet e ndryshme mund të shfrytëzohet si indikator edhe për algoritmet (por edhe për qytetarët), për të kuptuar se bëhet fjalë për skemën e trolleve.
- Për momentin nuk ekziston kufizimi i numrit të faqeve që administrohen nga një administrator i vetëm. Ekzistojnë indikacione se ka administratorë që administrojnë nga dhjetë faqe (shumë më tepër se hapësira e interesave personale të një individi), që duket si makineri spinesh. Është vërejtur se algoritmet e "Facebook" e kufizojnë shpërndarjen e linqeve nëpër grupe-shfrytëzuesish që janë veçanërisht aktivë në shpërndarjen e linqeve nëpër grupe që marrin vërejtje, pastaj "tajmaut" ose periudhë tre ditore gjatë së cilës nuk mund të shpërndajmë asgjë. Por masa e këtillë nuk është vërejtur tek administratorët e faqeve.
- Deri më tani ekzistimi dhe puna në të ashtuquajturat ferma të faqeve në FB nuk është kufizuar. Ato janë ueb-faqe të konceptuara si disa faqe të lidhura me një internet-adresë të vetme (disa prej tyre nuk kanë identitet, madje janë në fazën e testimit), që vetëm postojnë artikuj klikbejt që pastaj përhapen nëpër faqet e FB me qëllim që të fitojnë sa më shumë pëlqime të mundshme dhe faqe që akumulojnë dhjetra mijëra pëlqime, të cilat pastaj ua shesin ueb-faqeve që kanë nevojë për to - për rritjen e shikueshmërisë, pa investuar asnjë mund për përfitimin e publikut.
- Nuk ka sanksione për **tregti me faqet e FB, që është pjesë e ekonomisë së hirtë** (as nga platformat e as nga institucionet shtetërore). Në Maqedoninë e Veriut, por edhe gjithandej botës ekziston një ekonomi e përhapur nëntokësore në të cilën tregtohet me faqe Facebook-u. Në RMV faqe me disa mijëra ndjekës shiten për 250 euro. Edhe në botë, faqet me përmbajtjet që mund të komercializohen dhe ku mund të promovohen prodhime të ndryshme me të cilat fitohen para nga reklamuesit e interesuar për temën e asaj faqe, mund të kushtojnë qindra mijëra euro. Këtu bëhet fjalë për tregti në të zehtë, e cila është në kundërshtim me politikat e bashkësisë së "Facebook-ut" dhe nuk është e lejuar as nga zyrtarë e vendeve të caktuara, sepse mund të jetë e lidhur me evazion tatimor dhe pastrim parash.

Varshmëria nga algoritmet gjatë zgjidhjes së problemeve të komunikimit me shfrytëzuesit e saj i bën rrjetet sociale të varura prej manipulimeve dhe keqpërdorimeve. Komunikimi ndërmjet njerëzve është kompleks dhe në masë të madhe varet nga instinkti, gjuha e trupit, ngjyra e zërit dhe tonit me të cilin thuhet porositë. Gjithë këto karakteristika dhe një sërë të tjerash janë ose të padukshme për algoritmet ose algoritmet ia dalin vështirë në krye me to, duke bërë shumë gabime ndërkohë. Historia e zhvillimit të teknologjive digjitale flet për rrugën e rëndomtë të zëvendësimit të punëtorëve/ të punësuarve me mjete digjitale ose me makina të drejtuara nga kompjuteri, por jo edhe për të kundërtën.

Si bashkëpunon Facebook-u me verifikuesit e fakteve



IDENTIFIKIMI

Facebook-u i identifikon lajmet e mundshme të rreme përmes sinjaleve të ndryshme

dhe

Verifikuesit e fakteve në mënyrë proaktive dhe të



SHQYRTIMI

Verifikuesit e fakteve e shqyrtojnë dhe e vlerësojnë saktësinë e storjeve.



VEPRIMI

Facebook-u ndërmerr veprime ashtu që lajmet e rreme i shfaq më poshtë të Lajmet dhe ofron kontekst

Parimet e funksionimit të Programit për verifikimin e fakteve nga palët e treta të "Facebook-ut"

Në vijimësi humbet koha e vlefshme dhe mjetet, sidomos nga ana e shfrytëzuesve që janë viktime të keqpërdorimeve nga shfrytëzuesit tjerë, sepse algoritmi i keq është më i shtrenjtë se personi i punësuar që e kryen punën shumë më mirë.

Për analizimin e komunikimit kompleks dhe të ndërsjellë ndërnjerëzor në rrjetet sociale mbetet nevoja e angazhimit të ekspertëve që e njohin kontekstin lokal të një bashkësie të caktuar. Algoritmet që mundësojnë funksionalitete të automatizuara duhet të zhvillohen në bashkëpunim me ekspertët dhe shfrytëzuesit pjesë pas pjesë, nëpërmjet qasjes inkluzive. Shpesh vendimet e imponuara në nivelin global bartin paragjykimet dhe anime të lidhura me kulturën nga e cila e kanë prejardhjen krijuesit e tyre ose bartësit tjerë të vendimeve.

Një pjesë e rrjeteve sociale e inkuadrojnë luftën kundër dezinformatave ose, thënë në mënyrë popullore, "lajmeve të rreme" në kuadër të infrastrukturës së tyre. Deri më tani veprimet e tilla zakonisht përfshinin shenjimin e përmbajtjeve të njohura si dezinformata jashtëzakonisht të dëmshme, **por jo dhe heqjen e tyre**, siç veprojnë në raste kur ekipet e tyre, sipas kriterëve interne, në konsultim me zyrtarët e vendeve të ndryshme ose entitetet tjera, vërejnë shkelje të rregullave të shfrytëzimit edhe të ligjeve kombëtare (Kodi Penal, Ligji për të Drejtat e Autorit).

Në qershor të vitit 2020 "Facebook-u" e zgjeroi Programin e tij për verifikimin e fakteve nga palët e treta (Third Party Fact-Checking Program)⁸³ edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe gjatë kësaj në Maqedoninë e Veriut filloi bashkëpunimi me Fondacionin "Metamorfosis" dhe shërbimin "Vërtetmatës"⁸⁴. Zgjedhja e partnerëve bëhet nga rradhët e organizatave që janë të çertifikuara nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare jopartiake për verifikimin e fakteve.

Fokusi i këtij programi është identifikimi dhe ballafaqimi me dezinformatat virale, veçmas ato që janë të lidhura me mashtrime të dukshme dhe që nuk mbështeten në fakte ("clear hoaxes that have no basis in fact").

Sipas **metodologjisë**, prioritet janë **pohimet pasaktësia e të cilëve mund të dëshmohet**, veçmas ato që janë aktuale ose të popullarizuara në rrjetet sociale dhe të rëndësishme për qytetarin e shtresës së mesme („prioritize provably false claims, especially those that are timely or trending and important to the average person.”)⁸⁵

Partnerët e “Facebook-ut” nuk kanë mundësi të drejtpërdrejtë të largojnë (fshijnë, bllokojnë) përmbajtje që do t’i marrin si të pasakta ose manipuluese në aspekte të tjera.

Përvoja e 5 muajve të parë të punës në RMV tregon se një pjesë e autorëve të përmbajtjeve të shenjuara më vonë vetë i largojnë në përpjekje të ndalimit të debatit publik, i cili intensifikohet me plotësimin e informatës se janë të pasakta, me link drejt sqarimit detal që është publikisht i qasshëm në ueb-faqen “Vërtetmatës” (vertetmates.mk) në rubrikën e veçantë „Verifikimi i fakteve”.

Politika e programit⁸⁶ gjithashtu qartësisht tregon cilat tipe përmbajtjesh nuk bëjnë pjesë në fushëveprimin e saj: ajo nuk i përfshin analizat e mendimeve ose interpretimet që nuk janë drejtpërdrejtë të mbështetura në fakte për të cilat mund të thuhet se janë të pavërteta në bazë të analizave objektive gazetareske, si dhe njoftime të postuara fillimisht nga politikanë dhe parti ose me praninë e tyre zyrtare në “Facebook”.

Kur verifikuesi i fakteve e radhit lajmin si të rremë, “Facebook-u” e pamundëson promovimin e tij nëpërmjet shpalljeve të paguara, por mund të vendos edhe ta paraqes më poshtë në lajme (news feed), me çka në mënyrë të dukshme zvogëlohet përhapja e tij e mëtutjeshme. Kjo pengon përhapjen e mashtrimit dhe zvogëlon numrin e njerëzve që e lexojnë lajmin. Faqet dhe domenet që vazhdimisht shpërndajnë lajme të reme, gjithashtu mund të kenë hapësirë të kufizuar dhe kështu humbet mundësia e tyre për përfitim dhe reklamim. Në mënyrë plotësuese, kur shpallja është shenjuar si e rreme, “Facebook-u” i paralajmëron njerëzit që e shohin ose përpiqen ta shpërndajnë shpalljen që është shenjuar si e tillë.

Për momentin, rrjetet sociale në rregullat për shfrytëzim nuk përfshijnë sanksione të rëndësishme për përhapjen e dezinformatave nga ana e **platformave personale**. Mund të parashikohet se pas nënvizimit të shpalljeve si dezinformata profili do të humb një pjesë të publikut që i ka besuar, por nuk ka dëshmi empirike për atë se sa dhe a u pakësohet komunikimi.

Ndryshe nga faqet e “Facebook-ut”, për të cilat faktor inkurajues i respektimit të rregullave të përdorimit është e dhëna se a janë të monetuara (a përfitojnë nga shpalljet e përmbajtjeve në platformë), përkatësisht se masat e demonetizimit nuk mund të zbatohen ndaj tyre, përhapësit e dezinformatave që shfrytëzojnë profile personale nuk kanë kufizime të tjera, ndaj mund ta përhapin dezinformatën drejtpërdrejt nëpërmjet videove dhe të vazhdojnë t’i shpërndajnë edhe dezinformatat që paraprakisht i shpërndanin si postime. Ata mund të krijojnë numër të pakufizuar grupesh dhe faqesh.

Në kuadër të përpjekjeve për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet platformave të rrjeteve sociale dhe gazetarëve profesionistë, përfshirë këtu edhe verifikuesit e fakteve, duhet të ngritet debat publik për metodat e sanksioneve të shkallë-shkallshme, që do të pakësonin gabimet e opsioneve të ndryshme të rrjeteve sociale (kufizimi i numrit të videove të drejtpërdrejta, kufizimi i të drejtës së administrimit të më shumë faqeve dhe grupeve, pamundësia për bërjen e anketave etj.) për profilet private që përhapin vazhdimisht dezinformata.

Për fat të keq, gjer më tani, shumica e medieve tradicionale dhe online në Maqedoninë e Veriut nuk treguan vullnet për inicim dhe pjesëmarrje në debate të këtilla, që duket edhe nga injorimi i aktiviteteve për verifikimin e fakteve (në “Facebook” dhe jashtë tij) dhe nga injorimi dhe moskundërvënia në fushatat që nëpërmjet dezinformatave, gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së dhunës kundër gazetarëve përpiqen ta diskriminojnë këtë veprimtari⁸⁸. Përgjashtim bëjnë shkrimet për debate të ngjashme nga vendet e jashtme të huazara nga mediet e huaja.

Në periudhën nga gushti gjer në dhjetor të vitit 2020, një pjesë e programit “Vërtetmatës” verifikoi gati 170 shpallje në “Facebook” nga RMV. 59% e verifikimeve kishin të bëjnë me dezinformatat e lidhura me pandeminë e Kovid-19, kryesisht me teori konspirative që kanë të bëjnë me sabotimin e masave të dedikuara për shpëtimin e jetëve, kurse një pjesë e shpalljeve të tilla nuk përmbajnë vetëm dezinformata, por i shkelin edhe në mënyra tjera rregullat e “Facebook-ut”, bie fjala me përhapjen e gjuhës së urrejtjes ose nxitjen e dhunës kundër punonjësve shëndetësorë.⁸⁷

Shfrytëzuesit nga RMV kanë shpërndarë përmbajtje të njohura në vendet tjera si dezinformata. Në shpalljet e tilla që paraqiten në faqet ose profilet e tyre gjithashtu do të qëndrojnë paralajmërimi se janë dezinformata dhe linqe artikujsh me sqarime, të bëra nga anëtarët e partneritetit për verifikim të fakteve nga vendet e huaja.

3.9. Specifikat e lidhura me karakterin multikulturor të Maqedonisë së Veriut

Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë së Veriut është multietnike, multikulturore, shumëgjuhësore dhe bashkësi multikonfesionale, shpesh shtrohet pyetja: vallë grupet e caktuara etnike dhe fetare qenë të targetuara në mënyrë specifike ose a reagues në mënyrë specifike në tipe të ndryshme dezinformatash lidhur me Kovid-19.

Përvojat paraprake tregojnë se ndarja gjuhësore e sferës mediatike në tri pjesë, në medie që e kanë gjuhë pune maqedonishten, në medie në gjuhën shqipe si dhe një sërë mediesh të vogla në gjuhët e bashkësive të tjera (të cilat kanë pikëmbërritje të vogël) është faktor në politikën e komunikimit nëpërmjet rasteve të dërgimit të porosive të ndryshme nga i njëjti burim në gjuhë të ndryshme. Faktor i informimit të pamjaftueshëm të qytetarëve janë dhe politikat redaktuese të medieve të caktuara, të cilat janë të orientuara të mbulojnë vetëm rajonet e caktuara ose grupet e synuara.

Hulumtimi me temë “Pandemia dhe infodemia” e projektit KriThink” e vitit 2020 tregoi dallime të caktuara në perceptimet e qytetarëve të anketuar, të cilët u deklaruan si maqedonas etnik apo si shqiptarë etnik. Kështu, në pyetjen “Vallë qeveria jonë i fsheh ose nuk i fsheh informatat?”, shqiptarët shprehën nivel më të ulët të mosbesimit sesa maqedonasit (43% kundrejt 49%), që mund të vendoset edhe në korelacion me dukurinë e asaj se a janë partitë politike që përkufizohen si etnike të angazhuara aktivisht për krijimin e perceptimeve të tilla ose jo.

Përvojat e gazetarëve që e mbulojnë luftën kundër dezinformatave përmendin raste të pohimeve të rreme arsyet e të cilave janë në një vijë me ato të grupeve të caktuara shoqërore, që krahas dezinformatave të shpeshta për mënyrën dhe barnat vendore me të cilat “shërohet” korona, flasin edhe për efektin e trilluar të 5G, “çipimin” nëpërmjet vaksinave dhe ndikimin e tyre “të keq”.

ДЕЗИНФОРМАЦИЈА!

Në qershor shumë medie shpërndanë dezinformatën se Greqia do të bëjë seleksionim etnik për hyrje të qytetarëve të RMV, si pjesë e masave kundër Kovid-19, me arsyetimin se shqiptarët dhe romët, përkatësisht muslimanët, janë fajtorë për përhapjen e virusit. Efekti i operacioneve të këtilla është nxitja e tensioneve etnike dhe fetare.⁹⁰

Njëra prej dezinformatave më të shpeshta dhe më të mëdha në mediet shqiptare në Maqedoninë e Veriut ishte pohimi se shqiptarëve u jepen nga 4000 euro për të thënë se dikush prej familjes së tyre ka vdekur nga koronavirusi. Ky lloj dezinformimi përhapëj fillimisht përmes komenteve në "Facebook" me qëllim që të binden njerëzit se koronavirusi nuk ekziston, se fjala është për fushatë qeveritare nëpërmjet të cilës do të rritet numri zyrtar i të infektuarve dhe me këtë, Qeveria do të fitojë para nga Evropa. Këto pohime nga profile të dyshimta u transmetuan edhe në disa portale.⁸⁹

Por, fenomeni i mësipërm nuk është i kufizuar vetëm te shqiptarët etnik. Pohimet e këtilla u përhapën edhe nëpërmjet profileve të maqedonasve etnik, kurse sipas bisedave me qytetarët nga Shkupi dhe nga Maqedonia Lindore, u pranuan si të sakta. Kështu, disa njerëz gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës së vitit 2020, madje edhe në komunikim me njëri-tjetrin përhapnin lajmet e tilla për disa të afërm - të sëmurë ose të vdekur, me të cilët paskan biseduar drejtpërdrejtë, e që paskan thënë se të afërmit e tyre kanë pasur simptoma të tjera, por në institucionet shëndetësore u janë ofruar nga 500 deri në 2000 euro që të nënshkruajnë se pacienti kishte Kovid-19.

Pohimet e këtilla dalin nga ekspozimi afatgjatë i njerëzve ndaj terrorive të ndryshme konspirative, që eskaluan me paraqitjet e para të mëdha të kundërshtarëve të vaksinave diku në vitin 2015.

Dezinformata se Greqia i mbyll kufijt vetëm për komunitat shqiptare në Maqedoninë e Veriut që kanë numër të madh të të infektuarve, fillimisht e publikuar në mediet në gjuhën maqonase⁹¹, mori hov të madh te mediet shqiptare. Me qëllim që të dezinformohet publiku, madje u botua edhe fotografia e rreme, gjoja nga Ministria për Punë të Jashtme e Greqisë, e cila tha se ka një ndalim të tillë, por lajmi u demantua nga MPJ e Greqisë dhe Maqedonisë.⁹²

Shkelja e rregullit të pacënueshmërisë së shtëpisë ishte gjithashtu njëri prej tipeve të manipulimit që veçanërisht ndikoi te publiku shqiptar. Shembull për këtë janë shpalljet mediatike të qershorit (tri ditë para zgjedhjeve) se policia me gjasë do të hyjë në shtëpitë private, për shkak të rritjes së numrit të të diagnostifikuarve me Kovid-19. Gjithë zinxhiri i kësaj dezinformate nisi nga

deklarata e zëvendësministrit për punë të brendshme Agim Nuhiut, që u nxorr nga konteksti dhe qëllimisht u manipulua kinse ai tha se policia do të hyjë në shtëpitë private. Por e vërteta është se ai bëri ftesë të mos organizohen dasma ose gëzime të tjera, sepse do të intervenojë policia me burgosje, dënime dhe vënie të pjesëmarrësve në karantin kolektiv. Lajmi u emetua madje edhe nga mediet në Shqipëri dhe Kosovë.⁹³

Dezinformatat e liferuara nga qendrat politike lokale dhe ekonomike të forcës janë veçmas efektive në meset që ballafaqohen edhe me nivel të ulët të zhvillimit socio-ekonomik, si varfëria dhe joarsimimi. Në meset e tilla faktori kryesor për përhapjen e informatave dhe dezinformatave janë bisedat mes shokësh dhe familjarësh në katër sy, të cilat, nëse shfrytëzohen mediet digjitale, kuptohen si fusha për komunikim të tillë. Rol në situata të këtilla luan edhe mungesa e medieve në gjuhën lokale ose varësia ose ndjeshmëria e medieve ekzistuese lokale nga ndikimi i njerëzve të fortë të lokalitetit. Si shembull mund të shërbejë përhapja e qëndrimit lidhur me vdekjen e politikanit dhe magnatit të biznesit Amdi Bajramit në komunën Shuto Orizari tek popullata e atjeshme me shumicë rome. Në tetor Bajrami shkaktoi skandal me organizimin e dasmës në një vend të huaj (Turqi) me qëllim që ta anashkalojë ndalimin për organizimin e tubimeve të tilla në vendin e tij⁹⁴, që ishte bërë pjesë e masave kundër pandemisë. Bajrami, që vuante nga më shumë sëmundje kronike⁹⁵ vdiq një javë më pas. Pas kësaj, nga klinika "Zhan Mitrev" u kuptua se kishte qenë pozitiv me Kovid-19⁹⁶. Familja e demantoi lidhjen me sëmundjen⁹⁷ dhe organizoi një varrim masiv kontravers që nuk ishte sipas protokollit të të vdekurve nga Covid-19⁹⁸. Intervista e bërë një muaj më pas me banorët e komunës tregoi se vazhdon të ekzistojë perceptimi i promovuar nga familja, që është në korelacion edhe me qëndrimet e përhapura paraprakisht për mohimin e pandemisë, për çka një e anketuar deklaroi se "Zhan Mitrevi ka thënë se Amdiu nuk ka koronë".

Përvojat e ekipit të "Metamorfozisë" në dekadën e fundit tregojnë se edhe në sferën e informimit gazetaresk ditor, edhe në sferën e verifikimit të fakteve, qytetarët i vlerësojnë informatat e sakta që ju ofrohen me kohë në gjuhën e tyre amtare ose kur ato përshtaten me kontekstin lokal (kur merret parasysh edhe identiteti rajonal).

3.10. Dezinformatat ndërkufitare

Një pjesë e dezinformatave të lidhura me pandeminë mund të klasifikohen si dezinformata ndërkufitare (cross border disinformation), përkatësisht si storje që paraqiten në një vend, huazohen nga vendi tjetër dhe atje pësojnë mutacion, përkatësisht përshtaten në kontekstin lokal ose për nevoja konspirative, që pastaj të vazhdojnë të përhapen nëpër rajon. Kur dezinformatat e këtilla kthehen sërish në vendin nga i cili burojnë, kanë shpesh një kredibilitet plotësues, sepse janë nga vendet e huaja ose nga vendi për të cilin popullata ka mendim të lartë.

Ballkani është në veçanti i goditur nga përhapja e dezinformatave të tilla për shkak të kombinimit të gjërave të përbashkëta (njohja e gjuhëve të disa shteteve dhe lidhjet kulturore nga e kaluara), me gjërat ndarrëse (bariera gjuhësore dhe kulturore ose izolimi mediatik për shkaqe historike apo politike). Të dy llojet e faktorëve janë të përshtatshëm për përhapjen e dezinformatave. Ato me lehtësi komentohen gabimisht ose spinohen si lajme orgjinale dhe transmetohen në gjuhën që nuk flitet nga shumica e një publiku të dhënë. Akoma më i lehtë është pranimi i dezinformatave në gjuhën e njohur apo kompatible.

Kështu për shembull mediet nga Serbia kanë ndikim të lartë në Mal të Zi, Bosnje dhe në Maqedoninë e Veriut, kurse mediet nga Shqipëria çmohen nga popullata etnike

shqiptare e Kosovës dhe e Maqedonisë së Veriut. Në të dy rastet mediet lokale huazojnë përmbajtje nëpërmjet të ashtuquajturave “gazetari copy-paste”, që në mënyrë senzacionale reciklojnë edhe të dhëna të pasakta, pa iu nënshtruar, të paktën, verifikimit elementar.

Një nga tiparet kryesore të dezinformatave ndërkufitare është mungesa e sqarimit të kontekstit, që është veçanërisht e përshtatshme për prezantimin e personave ose organizatave të parëndësishme dhe qëllimkëqia të vendeve të tjera, si burime të rëndësishme dhe të sigurta.

Shembuj të dezinformatave përtej kufirit

Shembuj të dezinformatave ndërkufitare janë dhe pohimet e pambështetura shkencore ose paushalle të dhëna gjatë fundit të marsit nga profesori maqedonas i mjekësisë në intervistën për medie që është pjesë e rrjetit lokal propagandistik, të financuar nëpërmjet Hungarisë. Pjesë të kësaj interviste ishin marrë nga organizata djathtiste serbe dhe në mënyrë plotësuese ishin rregulluar me manipulime dhe si klipe të shkurtëra u përhapën në gjithë ish Jugosllavinë me titra në gjuhën serbe.⁹⁹



Verifikimi i fakteve nga një video klip nga Maqedonia, që përhapte dezinformata në nivel rajonal.

Pas verifikimit të fakteve të bëra në bashkëpunim mes mediumit serb për verifikimin e fakteve "Istonomer" dhe ekipit të "Metamorfozis", përhapja e këtyre dezinformatave u ul dukshëm në Serbi. Videot e tilla ishin të popullarizuara edhe në Maqedoninë e Veriut, ku u emetuan si "dëshmi" për profesionalizmin dhe rëndësinë e personit, që, nëpërmjet procesit të promovimit të vazhdueshëm,¹⁰⁰ fitoi popullaritet plotësues, madje u emërua në detyrën e lartë të një funksionari partiak – u bë anëtar i Komitetit ekzekutiv të partisë VMRO-DPMNE.¹⁰¹

Në një rast tjetër, në dhjetor, verifikimi i fakteve të bëra si pjesë e programit për bashkëpunim në "Facebook" e pengoi përhapjen e dezinformatës ndërkufitare mes Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë.

Është fjala për videon virale me të pavërtetat për pasojat e padëshmuara të vdekjeve nga vaksinat kundër Kovid-19, të lansuar nga propagandisti maqedonas¹⁰². Por, drejtuesi bullgar i faqes kundër vaksinimit, me 83.000 ndjekës, vendosi të mos e emetojë¹⁰³, për shkak të frikës se kjo do të ndikojë në autoritetin e tij në "Facebook".

Око да види
December 11, 2020 · 🌐

Бобан Нонковик тврди на живо излчване от Европейския парламент, че .. ами не можем да кажем какво, защото виждате, че видеото се покрива от ФБ, а нас ни предупреждават, че ще ни изтрият страницата, ако го споделим. Споделихме го в телеграм, ето тук <https://t.me/okodavidi/93>

Boban Nonkovik war live — 🍌 stocksauer
hier: European Parliament.
am Dienstag · 🌐

👍❤️👏 3.407 5.337 Mal geteilt 269.476 Aufrufe

👍 Gefällt mir ➦ Teilen

Mehr zum Thema

VISTINOMER.MK · **Faktenprüfung**
ФДА не утврдила нус појави на вакцините против Ковид-19
Видео на Фејсбук шири дезинформации за ефек...

💬 Kommentare Als Nächstes

⚠️ Warnhinweis ansehen

Postim kundër vaksinës në faqen bullgare në FB "Ta shohë syri".

3.11. Roli i organizatave të donatorëve dhe bashkësisë ndërkombëtare

Merita e bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve interkombëtare që funksionojnë si donatorë të shoqërisë qytetare dhe medieve të pavarura në Maqedoninë e Veriut, nuk mund të neglizhohet, as gjatë vitit 2020. Në kushte të mungesës së qasjes në burimet vendore financiare (edhe shtetërore edhe private), pikërisht përkrahja e donatorëve mundësoi ndërprerjen e spirales së heshtjes, që ishte pasojë e dominimit të propagandës brenda vendit gjatë periudhës së kapjes së shtetit (2006-2017).

Kështu për shembull, FND ose Fondi Kombëtar për Demokraci nga SHBA (National Endowment for Democracy), që nga viti 2011 e përkrahu themelimin e "Vërtetmatës-it" si mjet për verifikimin e fakteve në fushën e politikës, puna e të cilit në vitet në vijim u përkrah pjesërisht edhe nga BTB (Balkan Trust for Democracy). Vitin e ardhshëm USAID e mundësoi themelimin e Shërbimit për verifikimin e fakteve në medie, si projekt i "Metamorfozis" (2012-2017).

Bashkimi Evropian në vitin 2017 e përkrahu formimin e rrjetit kombëtar për edukim mediatik, kurse në vitin e ardhshëm përkrahu organizimin e tre projekteve shumëvjeçare nga kjo fushë, të zbatuara nga "Metamorfozis", MIM dhe MOF.

Ambasadat dhe vendet anëtare të NATO-s, kanë përkrahur shumë iniciativa me përmasa më të vogla të lidhura me luftën kundër dezinformatave ose zhvillimin e pluralizmit mediatik, ndërmjet të cilave Ambasada e SHBA me projektin F2N2 të asociacionit MOST.

Organizatave donatore private, si Fondacioni "Shoqëria e hapur – Maqedoni" pjesë e rrjetit të Fondacioneve për shoqëri të hapur (Open Society Foundations) dhe Fondi "Sigrit Rausing" (Sigrit Rausing Trust), gjithashtu i kanë përkrahur aktivitetet e kësaj sfere.

Gjatë kohës së Covid-19 dhe infodemisë, nevojitet një rimendim kritik i mjeteve tradicionale për luftë kundër dezinformatave. Në arsyetimin e programeve dominojnë argumentet që merren të gatshme por që nuk bazohen mbi analizat dhe hulumtimet më të gjera, veçmas të atyre që i marrin parasysh faktorët strukturorë që një shoqëri e bëjnë më pak ose më shumë të qëndrueshme ndaj tyre. Debati për rritjen e lajmeve të rreme zhvillohet në binarë të ndryshëm në raport me debatin për krizën e demokracisë liberale, rritjen e pluralizmit djathtist dhe dominimin e frymës populiste të kohës, marrë në përgjithësi. Debati për rritjen e narrativeve alternative ndodh ndaras nga debati i pabarazisë raciste (veçmas në botën e zhvilluar) dhe korrupsionit të elitave si kërcënim për sigurinë etj.

Gjatë dizajnit të politikave lokale duhet të kihet parasysh konteksti lokal në vend se të forcohen qasjet që e shpjegojnë rritjen e dezinformatave si pasojë e mungesave individuale të njerëzve (si analfabetizmi, arsimimi, informimi etj) dhe që kufizohen në përfundime paushalle të lidhura me gjëra të përgjithshme, si kualiteti i ulët i arsimit të qytetarëve të moshuar, që përkundër konceptit të BE-së për shkollim gjatë gjithë jetës, shpeshherë në mënyrë implicite konsiderohet si gjendje e pandryshueshme. Për këtë është i nevojshëm zgjerimi i debatit nëpërmjet investimit në themelet e hulumtimeve sociologjike.



4

REKOMANDIME

Rekomandime të përgjithshme për të gjithë anëtarët

- Nevojitet qasje sistematike për ngritjen e kulturës së mendimit kritik dhe dialogut shoqëror në të gjitha nivelet, duke nisur nga sistemi arsimor, marrëdhëniet e institucioneve dhe palëve të interesit të të gjithë sektorëve, përfshirë dhe nivelin familjar dhe individual.
- Duke e pasur parasysh polarizimin e lartë në shoqëri në më shumë linja, gjatë përgatitjeve për veprim kundër dezinformatave është me rëndësi të sillen vendime të mbështetura në të dhënat për atë se vallë në situatën e caktuar ka efekt zbatimi, qasja konfrontuese (nëpërmjet së cilës mund të forcohet polarizimi) ose të vazhdojë përpjekja, nëpërmjet dialogut të gjerë inkluziv shoqëror, t'u jepet rasti të gjitha palëve që ta rivlerësojnë një pjesë të vlerave, perceptimeve dhe mendimeve të tyre.
- Varshmëria prej teorive konspirative dhe rrëfimet tjera alternative është pasojë e faktorëve strukturorë, që duhet të adresohen me programe konkrete, në vend të patologjizimit ose praktikave të politizimit, shmangies ose injorimit.
- Informatat për Covid-19, veçmas ato që burojnë nga institucionet shtetërore dhe medicinale, duhet të aftësohen për edukimin e publikut të gjerë, me forma të sqarimeve të kuptueshme për publikun, veçmas për qytetarët laikë të medicinës ose që kanë nivel më të ulët të arsimimit të përgjithshëm. Në një sërë rastesh përdorimi i shprehjeve profesionale

mjekësore ose zhargoneve të tjera i bën të koklavitura sqarimet dhe nxit refuzimin e qytetarëve që nuk posedojnë nivel të lartë arsimimi. Për shkak të kësaj ata u kthehen teorive konspirative, të cilat janë rishtjelluar dhe përshtatur për ta si grup i synuar. Prandaj sqarimet duhet të jenë të kuptueshme dhe edukative, kurse sipas mundësive të mbështeten me përmbajtje grafike ose multimediale, që do ta ilustronjë, do ta mundësojnë dhe do ta lehtësojnë kuptimin nga të gjithë.

Rekomandime për institucionet shtetërore

- Institucionet në partneritet me mediet dhe organizatat qytetare duhet të krijojnë politika dhe mekanizma për zhvillimin e edukimit mediatic dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj dezinformatave.
- Gjatë kësaj, duhet t'i mbindërtojnë edhe kodekset etike që kanë të bëjnë me të punësuarit e tyre me qëllim të inkorporimit të luftës kundër dezinformatave si vlerë bazike dhe më pas të zhvillojnë procedura adekuate të punës.
- Të gjitha institucionet, veçmas ato të fushës së mjekësisë, duhet t'i përkrahin mediet, serviset, organizatat që drejtëpërdrejtë punojnë në zbulimin e dezinformatave të lidhura me Covid-19, nëpërmjet promovimit të përmbajtjeve të përgatitura në profilet e tyre në rrjetet sociale dhe ueb-faqet.
- Institucionet shtetërore të pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, duhet të luajnë rol proaktiv në forcimin e

kapaciteteve financiare të medie dhe në krijimin e hapësirës së përshtatshme për investime financiare në industrinë mediatike.

- Në veçanti është e rëndësishme të investohet në forcimin e vetëdijes dhe rolit të medie si forca shtytëse të demokracisë në shoqëri, kurse përmirësimi i gjendjes së medie duhet të trajtohet si qëllim strategjik.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, duhet të themelojë fond të veçantë për mundësinë e bashkëpunimit me bashkësinë akademike, universitetet dhe institucionet shkencore në drejtim të implementimit të hulumtimeve shkencore për prezencën e dezinformatave të lidhura me Covid-19.
- Qeveria e RMV, duhet sa më parë ta zbatojë në tërësi "Planin aksional për aksion vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave", propozim versioni i të cilit i është prezantuar publikut më 24 qershor të vitit 2019, por implementimi ka ngecur veçmas në pjesën e dytë të planit aksional me titull "Masa proaktive". Është koha e fundit që Qeveria t'i reket implementimit të planit të saj aksional edhe atë:
- të aktivizojë grupin aksional të përbërë nga funksionarë të nivelit më të lartë;
- të zbatohen fushatat e parapara edukative të dedikuara për publikun, por edhe për të punësuarit dhe funksionarët në administratën publike;
- të hapet debati me mediet dhe organizatat joqeveritare për mënyrën e përkrahjes së prodhimit dhe përmbajtjeve mediatike për temën e luftës kundër dezinformatave.
- Institucionet shtetërore duhet të inicojnë procese për krijimin e strategjisë shtetërore për luftë kundër dezinformatave, që do t'i kenë parasysh edhe përvojat e zbatimit të planit aksional, edhe nevojat për mbindërtimin e tij në kushte pandemie.
- Është e patjetërsueshme ruajtja e konsistencës së mesazheve dhe informatave, të shpërndara nga autoritetet kombëtare dhe institucionet medicinale, jo vetëm për ngjarjet lokale, por edhe në lidhje me aktivitetet në nivel rajonal dhe botëror, veçmas me afrimin e informatave që vijnë drejtpërdrejt nga OBSH-ja tek publiku lokal (njerëzit që nuk flasin anglisht dhe nuk mund t'i konsumojnë drejtpërdrejt) si dhe reaksionet e dezinformatave të lidhura me ngjarjet në vendet fqinje (mundësisht në koordinim me institucionet e atjeshme relevante).

Rekomandime për institucionet shëndetësore dhe punonjësit shëndetësorë

- Institucionet përgjegjëse të sferës së shëndetësisë si: Ministria e Shëndetësisë, Instituti për shëndet publik, Qendra për shëndet publik dhe qendrat tjera shëndetësore të vendosin bashkëpunim formal (nëpërmjet marrëveshjes, memorandumit etj.) me organizatat qytetare, mediet dhe shërbimet për verifikim të fakteve, që drejtpërdrejtë punojnë në zbulimin e dezinformatave të lidhura me Covid-19 në kuptimin e sigurimit me kohë të informatave të detajizuara dhe përgjigjeve në pyetjet e lidhura me trajtimin e temave të lidhura me demaskimin e dezinformatave;
- Institucionet shëndetësore (edhe publike edhe private) duhet rregullisht të ndjekin çfarë botohet në publik lidhur me pandeminë e Covid-19. Kjo lidhet edhe me informatat edhe me dezinformatat, por edhe me atë që nuk është publikuar, e do të duhej të publikohej që të ndihmojë pengimin e përhapjes së pandemisë.
- Institucionet shëndetësore dhe shoqatat profesionale, duhet rregullisht t'i publikojnë mendimet profesionale të lidhura me përhapjen e dezinformatave, veçmas ato që lidhen me vaksinimin dhe terapinë e shërimit të koronavirusit, me qëllim të publikimit të lajmërimeve dhe shpjegimeve që janë shumë të rëndësishme si burime që argumentojnë dhe verifikojnë faktet.
- Gjithashtu është me rëndësi të rritet veprimi publik i strukturave për vetërregullim profesional në shëndetësi, mes të cilave Dhoma e Mjekëve dhe trupat përgjegjëse për etikë në kuadër të institucioneve shëndetësore dhe arsimore e shkencore, sidomos në rastet e sjelljes joprofesionale dhe deklaratave paushalle të individëve që promovohen nëpërmjet medie dhe rrjeteve sociale si ekspertë medicinalë.
- Mjekët që drejtpërdrejtë punojnë me pacientët, duhet të jenë të informuar për dezinformatat kryesore që ndikojnë në punën e tyre, që të mund të japin udhëzime dhe këshilla, si dhe t'i paralajmërojnë me kohë qetëtarët që të mos marrin barna kokë më vete.
- Me qëllim që institucionet shëndetësore të mund ta ndjekin rrjedhën e lajmeve dhe informatave lidhur me këtë temë, ata duhet të kenë të paktën njerëz të trajnuar (në varësi nga numri i ndërrimeve) për punë me kërkuesit në internet, rrjetet sociale dhe aplikacionet RSS.
- Qendrat për shëndet publik dhe spitalet, duhet të kenë kujdes të veçantë për lajmet dhe informacionet

nga vendet ku jetojnë dhe të reagojnë ndaj dezinformatave ose për shkak të mungesës së informatave të dobishme në nivel lokal ose në fushën/meset/rajonin prej ku vijnë pacientët e tyre.

- Institucionet shëndetësore duhet të zhvillojnë procedura dhe të përgatisin kuadro për komunikim me publikun, vet ose me ndihmën e Ministrisë së Shëndetësisë. Për çdo rast më e rëndësishme është të jenë të njohur me “pulsin e publikut” në raport me pandeminë në meset e tyre dhe të kenë njerëz të trajnuar që mund të përgjigjen në pyetjet e gazetarëve dhe t'i zbulojnë dezinformatat që paraqiten në nivel lokal.
- Si gjithë instituconet tjera, sidomos spitalet duhet të kenë plane të zhvilluara dhe procedura për të përballuar rreziqet në rastet kur mund të jenë viktimë e dezinformatave ose sulmeve të hakerëve. Të paktën, institucionet shëndetësore duhet patjetër të zhvillojnë skema të sulmeve dhe zgjidhjeve të mundshme në rast të dezinformatave, polarizimeve politike dhe formave të tjera të forcimit të sentimenteve negative kundër spitalit, sulme hakerësh ndaj infrastrukturës me qëllim të bllokimit të punës dhe publikime të dhënash të marra nëpërmjet depërtimit të palejuar në mjetet informatike të spitalit (hack and leak operations).

Rekomandime për funksionarët shtetërorë e publikë dhe për nëpunësit shtetërorë

- Ngjashëm si partive politike, edhe funksionarëve shtetërorë dhe publikë, të punësuarve në institucionet dhe trupat shtetërore si dhe nëpunësve dhe të tjerëve, duhet t'u ofrohet mundësia të nënshkruajnë vullnetarisht Deklaratë kundër lajmeve të rreme lidhur më Covid-19, me të cilën do të obligohen se nuk do të shpërndajnë dhe nuk do ta nxisin përhapjen e dezinformatave të lidhura me Covid-19.
- Gjatë paraqitjeve publike, funksionarët duhet të kufizohen tek ajo që është fusha dhe specialiteti i tyre, kurse për sqarimin e çështjeve të lidhura me pandeminë t'ua lëshojnë podiumin ekspertëve relevantë të fushës së mjekësisë ose të degëve të tjera të përafërta shkencore.

Rekomandime për partitë politike

- Ngjashëm si nënshkrimi i Deklaratës për zgjedhje të drejta, të lira dhe demokratike para çdo procesi zgjedhor, partitë politike duhet të nënshkruajnë edhe daklarata publike kundër lajmeve të rreme,

me të cilat, bashkë më drejtuesit e lartë, do të obligohen që në periudhën e ardhshme, nuk do të përhapin ose nxisin përhapjen e dezinformatave lidhur me Covid-19. Edhe pse për ta nuk do të ishte një dokument obligativ, respektimi i tij do të mund t'u shërbejë medieve si temë shkrimesh në rast shkeljesh eventuale të asaj që kanë nënshkruar.

- Në funksion të edukimit të përkrahësve të tyre, partitë duhet në vazhdimësi ta përsërisin përkrahjen e pakusht të masave të propozuara prej OBSH-së për ndalimin e përhapjes së pandemisë dhe të ndërmarrin masa konkrete për mospërhapjen e dezinformatave për Covid-19, që janë të lidhura me fushën e mjekësisë.
- Partitë politike duhet ta ndërpresin shfrytëzimin e krizës shëndetësore botërore për qërime hesapësh ndërmjet tyre dhe të mos i bllokojnë proceset me çështje të lidhura me pandeminë. Shembulli i gjetjes së gjuhës së përbashkët dhe pajtimit për votimin e Ligjit për Finansimin e Partive Politike tregoi se partitë janë të afta ta ndërpresin fushatën negative aktuale të orientuar nga katranosja e kundërshtarëve të tyre politikë. Qasja e mbështetur në bashkim është mënyra e vetme që shoqëria të ballafaqohet me pandeminë me sa më pak viktima.
- Partitë politike duhet ta ndalojnë të qenit përkrahës, madje dhe financues portalesh, pjesëmarrës në rrjetet sociale dhe nxitës të përhapjes së dezinformatave për Covid-19, para së gjithash, nëpërmjet publikimit të deklaratave që nuk u përmbahen fakteve dhe janë në kundërshtim me udhëzimet e institucioneve relevante ndërkombëtare e vendore.
- Partitë duhet ta ndalojnë praktikën e tolerimit dhe trimërit të funksionarëve të tyre që të dalin me dezinformata për Covid-19. Në këso rastesh partitë duhet të bëjnë deklaratat me të cilat do të distancohen prej sjelljes së dëmshme të anëtarëve të tyre dhe t'i theksojnë faktet e mbështetura në shkencë, veçmas në raport me gjendjen shëndetësore dhe masat mbrojtëse.
- Partitë duhet ta ndërpresin traditën e tolerimit, madje dhe trimërit të portaleve dhe pjesëmarrjet në rrjetet sociale tek të cilat kanë ndikim të publikojnë dezinformata për Covid-19 si “karem për klikime”, që bëhen me qëllim të rritjes së ndikimit partiak në publik.
- Partitë që në të shkuarën e kanë bërë këtë duhet t'i ndërpresin të gjithë kontaktet me forma trillesh të ajshme dhe vendore. Përvoja e fushatës kundër referendumit të vitit 2018 tregoi se huazimi i

formave të këtylla të manipulimit të percipcionit për çështje të rëndësishme dhe aktuale të politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit kanë pasojë shumë afatgjate për komprometimin e shtetit.¹⁰⁴

- Ndërprerja e praksës së koordinuar të shpërndarjes Ndërprerja e praktikës së koordinuar të shpërndarjes në rrjetet sociale të përmbyturëve të përditshme me dezinformata për Covid-19, madje dhe shpifjeve dhe fyerjeve të lidhura me epideminë nga ana e degëve lokale të partive, me ose pa urdhër të drejtuesve të lartë,* bëhen me qëllim të fitimit të pikëve politike në publik në llogari të së vërtetës.

Rekomandime për kompanitë private, agjencitë e marketingut dhe reklamuesit e tjerë që e mundësojnë punën e shtëpive mediatike.

- Reklamuesit duhet t'i avansojnë parimet e tyre etike dhe politike për përgjegjësi shoqërore korporative me kriteret që do ta mundësojnë verifikimin e rregullt, nëse me mjetet e tyre sponsorizohen mediet që përhapin dezinformata.

Rekomandime për drejtuesit e medieeve – pronarët dhe redaktorët

Pronarët dhe drejtuesit e medieeve duhet ta rrisin bashkëpunimin me shërbimet për verifikimin e fakteve dhe trupat tjerë që luftojnë kundër dezinformatave. Një formë e bashkëpunimit të tillë është ajo nëpërmjet marrjes së artikujve me fakte të verifikuara. Shembull pozitiv në këtë drejtim japin mediet që kanë formuar rubrika të veçanta për verifikimin e fakteve në të cilat publikojnë edhe verifikimet personale ose marrin përmbyturje prej shërbimeve për verifikimin e fakteve në vend ose rajon, të përzgjedhura nga redaktorët e tyre.

- Mediet duhet ta ndërpresin publikimin e përmbyturjeve që ndikojnë në përhapjen e pasigurisë dhe refuzimin e njerëzve për ta marrin vaksinën kundër Covid-19. Shembull për sjelljen e tillë është moskundërshtimi i masave të rekomanduara nga OBSH, që pengojnë përhapjen e epidemisë dhe që janë miratuar edhe nga ana e Qeverisë.
- Për sa i përket vaksinimit, mediet duhet ta promovojnë qasjen shkencore para publikut të tyre, përkatësisht para grupeve të caktuara të popullatës të cilave u dedikohet. Qytetarët duhet të udhëzohen që vaksinimi të bëhet në konsultim me mjekun. Ato nuk duhet të zgjedhin vaksinë të preferuar ndërmjet vaksinave të prodhuesve të ndryshëm, nëse ato

janë miratuar për përdorim brenda territorit të vendit nga organet kompetente si Byroja e Barërave, as ta mundësojnë reklamimin e fshehtë të cilitdo prodhim shëndetësor nga distributorët komercialë nëpërmjet licitimeve joprofesionale.

Rekomandime për punonjësit individualë mediatikë, përkatësisht për gazetarët

- Punonjësit mediatikë, si dhe mediet në tërësi, duhet të përpiqen për rritjen e respektit ndaj standardeve etike dhe profesionale në gazetari, si dhe për rritjen e zbatimit të mjeteve rregullatore.
- Mediet duhet të marrin pjesë aktive në luftën kundër gjithë llojeve të dezinformatave dhe në promovimin e edukimit mediatik nëpërmjet rritjes së kualitetit dhe llojllojshmërisë së programeve mediatike me karakter informativo-edukativ.
- Nëse nuk kanë përmbyturje të vetat, të përpiqen të emetojnë përmbyturje të përgatitura nga gjithë shërbimet tjera për verifikimin e fakteve ose mediet që rregullisht sfidojnë dezinformatat në kuadër të vepërtarisë së tyre.

Rekomandime për organizatat profesionale mediatike dhe trupat e ngjashëm

- Duhet të rritet bashkëpunimi ndërmjet organizatave profesionale mediatike dhe institucioneve tjera relevante për sektorin mediatik.
- Është shumë i rëndësishëm promovimi më i madh i mekanizmave të vetërregullimit si mjet nëpërmjet të cilit qytetarët do të kenë rast të shprehin për keqpërdorimet nga ana e medieeve joetike.
- Është me rëndësi afirmimi i aktiviteteve publike për verifikimin e fakteve si formë e vetërregullimit në kuadër të bashkësisë mediatike, por edhe si mjet për nxitjen e debateve publike për kualitetin e përmbyturjeve mediatike dhe llojin e edukimit mediatik me të cilin standardet profesionale afrohen në mënyrë praktike me publikun e gjerë.

Rekomandime për organizatat qytetare

- Organizatat qytetare duhet të vazhdojnë të krijojnë dhe akumulojnë dije lidhur me problemin e dezinformatave, duke ndërtuar arkivat e përmbyturjeve në të cilat do të mblidhen njohuritë dhe sqarimet për manipulimet dhe dezinformatat e zbuluara, që do të publikohen me licenca të organeve që lejojnë shfrytëzimin e tyre. Shembull

i një resursi të këtyllë është ueb-faqja i KriThink” (crithink.mk), e cila ka dhe arkivin e artikujve analitikë e edukativë dhe bibliotekën elektronike me përmbajtje multimediale, botime digjitale dhe materiale për trajnime. Kësisoj, secila prej organizatave qytetare do të mund t’i marë përmbajtjet dhe t’i shpërndajë në ueb-faqet e saj ose nëpër rrjetet sociale, të nxisë dhe udhëheqë projekte për trajnimin e grupeve të synuara, dhe të ndikojë në të njëjtën mënyrë me përmbajtjet e saj.

- Sa më shumë organizata të përpicën të fillojnë me projektet e tyre me të cilat do të punojnë për vetëdijen publike për dezinformatat ose do t’u bashkangjiten projekteve në pjesën e sektorit joqeveritar, që tani më punon në demantimin e dezinformatave. Njëkohësisht duhet të punojnë në dezinformatat e grupeve të synuara të bashkësive të tyre për të cilat do të konstatojnë se janë më të rrezikuara prej ndikimeve negative të dezinformatave. Të mendojnë për qasje të ndryshme për sqarimin e dëmeve nga dezinformatat tek grupmoshat e ndryshme, veçmas tek të rinjtë;
- Organizatat qytetare duhet të krijojnë përmbajtje dhe të organizojnë fushata promovuese, me të cilat publikut do t’ia prezantojnë me narrative pozitive, të mbështetura në fakte, masat për ndërprerjen e përhapjes së epidemisë dhe dobisë nga vaksinimi, me qëllim që të zvogëlohet hamendësia nga vaksinimi (vaccine hesitancy), por edhe kundërvënja ndaj shfrytëzimit të vaksinave kundër Covid-19.
- Në përpjekjet për rritjen e edukimit mediatic dhe mendimit kritik në të gjitha nivelet, në bashkësitë e tyre duhet të përfshihen më shumë organizata qytetare. Kjo duhet të bëhet nëpërmjet kurikulave që do t’i përpilojnë vetë ose në bashkëpunim me bashkësinë akademike. Ato duhet të përgatiten enkas për luftë kundër dezinformatave për Covid-19, duke iu referuar praktikës aktuale të verifikuesve të fakteve brenda vendit.
- Organizatat qytetare që punojnë në sektorin e edukimit mediatic dhe verifikimit të fakteve do të risin ndikimin dhe mundësitë e tyre për bashkëpunim duke u bashkuar në Rrjetin kombëtar për edukim mediatic, ose në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare që luftojnë kundër dezinformatave.
- Organizatat qytetare duhet të fillojnë aktivitetet e lobimit dhe përfaqësimit para autoriteteve me qëllim të rritjes së përkrahjes së institucioneve publike e shtetërore në luftën kundër dezinformatave dhe forcimin e edukimit mediatic dhe mendimit


kritik, si dhe të insistojnë që organet e caktuara shtetërore (prokuroria dhe gjykata) t’i zbatojnë ligjet relevante kundrejt paligjshmërive, kurse Qeveria të respektojë politikën publike, duke nisur nga pjesa e dytë e Planit aksional për luftë të vendosur kundër dezinformatave.

Rekomandime për hartuesit e politikave arsimore dhe programeve mësimore

- Është shumë i rëndësishëm rishikimi i programit mësimor të studimeve për gazetari me qëllim të stimulimit të zhvillimit të edukimit mediatic dhe mendimit kritik.
- Është shumë i rëndësishëm përmirësimi i kapacitetit të institucioneve të arsimit të lartë në harmoni me gjendjen aktuale teknike e teknologjike të medieve.

Arsimtarët e shkollave fillore dhe të mesme duhet:

- Të jenë të vetëdijshëm për nevojën e përfshirjes së shembujve bashkëkohorë në mësimdhënie, veçanërisht për kombinimin e përmbajtjeve aktuale mësimore me informacionet për Covid-19.
- Të kontribuojnë për zhvillimin e mendimit kritik tek më të rinjtë.
- Të llobojnë haptazi për përfshirjen e edukimit mediatic në procesin mësimor.
- Bashkësia akademike duhet të marë pjesë aktive në pengimin e përhapjes së dezinformatave lidhur me Covid-19 nëpërmjet përhapjes, promovimit dhe përkrahjes së të dhënave dhe informacioneve të mbështetura shkencërisht, si edhe nëpërmjet përkrahjes së qartë dhe të paluhatshme të masave të pranuar ndërkombëtarisht që ndihmojnë pengimin e përhapjes së pandemisë, sqarimin e tyre, arsyetimin shkencor të mënyrës sesi funksionojnë në publikun e gjerë dhe nëpërmjet demaskimit të mbështetur shkencërisht të dezinformatave të lidhura me Covid-19, që janë të përshtatshme dhe adekuate për bashkësinë akademike dhe që mund të realizohen nëpërmjet debateve virtuale, paneleve dhe seminareve.
- Shkencëtarët dhe edukatorët duhet t’i përkrahin organizatat aktuale qytetare, mediet dhe shërbimet për verifikimin e fakteve, si dhe gjithë mediet tjera profesionale, nëpërmjet gjetjes së formave të bashkëpunimit me ta, veçanërisht duke i vënë në dispozicion kapacitetet e tyre profesionale, si



“Kovid-19 ndikon mbi të gjithë” ilustrim i rëndësisë së luftës së përbashkët kundër pandemisë nga CriThink (CriThink.mk).

burimet e informatave të verifikuara dhe të vërtetat shkencore.

- Njëri prej aktiviteteve më të rëndësishme që bashkësia akademike mund ta bëjë në luftë kundër dezinformatave është ballafaqimi me dezinformatat, që burojnë nga mesi i tyre. Ajo është e pozicionuar në mënyrë unike për t'u ballafaquar me dezinformatat e individëve me prapavijë akademike, që shkaktojnë dëme të mëdha në diskursin publik dhe janë relativisht virale duke pasur parasysh profesionalizmin e burimit. Kjo është pjesë e luftës kundër Kovid-19. Betejën kundër dezinformatave, bashkësia akademike duhet ta bëjë urgjentisht dhe në mënyrë të gjithanshme edhe atë me përkrahje institucionale që, krahas komponentës profesionale në zbardhjen e këtyre dezinformatave të kihet kujdes edhe për komponentën institucionale.
- Anëtarët e bashkësisë akademike duhet të llojnë publikisht për themelimin e një fondi të posaçëm nga ana e shtetit për përgatitjen e hulumtimeve shkencore që do të trajtonin tema të ndryshme të lidhura me prezencën dhe përhapjen e dezinformatave.
- Bashkësia akademike duhet të përfshihet në zhvillimin e resurseve të hapura arsimore për edukimin mediatic dhe forcimin e mendimit kritik që udhëhiqen nga organizatat qytetare. Theksi i këtyre përpjekjeve për sigurimin e lirë të planeve

të arritshme mësimore dhe materialeve edukative në gjuhët lokale duhet të jetë kundërshtimi i dezinformatave që ndikojnë në publikun e ndryshëm siç janë fëmijët, të rriturit dhe pjesa e moshuar e popullatës, edhe kjo në formë analoge (të shtypur) dhe digjitale. Për këtë aktivitet bashkësia akademike është e pozicionuar në mënyrë unike, duke pasur parasysh përvojën në përgatitjen e materialeve didaktike, por edhe për shkak të njohjes së fushës së psikologjisë, e cila prej kohësh ka sqaruar një sërë fenomenesh dhe karakteristikash në raport me sjelljen e njeriut kur ballafaqohet me dezinformatat dhe mënyrat e tejkalimit të tyre.

Rekomandime për platformat e medieve sociale

- Platformat për medie sociale duhet të ndërtojnë kriteret e qarta dhe të dërgojnë informacione të qarta tek pronarët e profileve, faqeve dhe grupeve për sa u përket sanksioneve të cilat i zbatojnë në raste të përhapjes së dezinformatave në ato platforma. Gjatë implementimit të këtyre sanksioneve ekziston huti e madhe tek të sanksionuarit, para së gjithash, në raport me kohëzgjatjen e sanksionit ose nëse është ajo me kohëzgjatje të kufizuar apo të pakufizuar. Por edhe në raport me llojin dhe gjithëpërfshirjen e sanksionit.

- Platformat duhet t'i përparojnë politikat e tyre interne dhe rregullat në drejtim të ndërmarrjes së masave edukative për pronarët e platformave individuale, të cilat sipas sistemeve aktuale nuk janë përfshirë në shumë forma të sanksioneve të shkallëshkallshme, të cilave u nënshtrohen faqet ose profilet zyrtare të institucioneve.
- Krahas "Facebook-ut", edhe platformat tjera të rrjeteve sociale duhet të krijojnë programet e tyre për verifikimin e fakteve, përkatësisht të bashkëpunojnë me verifikuesit e fakteve gjithandej botës dhe këtë bashkëpunim ta forcojnë dhe ta mirëmbajnë rregullisht.
- Të krijojnë mjete për transkriptin e videove në sa më shumë gjuhë të mundshme, nëpërmjet të cilave verifikuesit e fakteve do të mund të analizojnë përmbajtjet e videove nëpërmjet kërkimit me fjalët çelësa në vend të kontrollimit të videoklipeve nga fillimi gjer në fund në kërkim të dezinformatave.
- Platformat e medieve sociale duhet t'i forcojnë përpjekjet e tyre kundër "sjelljes joautentike", përkatësisht kundër shfrytëzimit të formave të trolleve, profileve të rrejshme dhe formave të tjera të ndërtimit të koordinuar dhe orkestruar të pamjeve të rrejshme për popullaritet dhe për interes të publikut për përmbajtje të caktuara.
- Në bashkëpunim me pushtetin, platformat duhet të zhvillojnë mekanizma për pengimin e tregtisë me faqe ose profile që stërshiten me qëllim të shfrytëzimit të publikut për qëllime komerciale ose politike.
- Rrjetet sociale duhet të zhvillojnë mekanizma më efikasë për komunikim të drejtëpërdrejtë me shfrytëzuesit e algoritmeve aktuale, që u nënshtrohen manipulimeve nëpërmjet paraqitjes së rrejshme ose gjatë zgjidhjes së situatave diskutabile, duke mos përfshirë në masë të mjaftueshme kontribute të njerëzve profesionistë të cilët e kanë të qartë kontekstin lokal, veçanërisht nga aspekti i kornizave kombëtare për mbrojtjen e të drejtave njerëzore.




BIBLIOGRAFIA

- 1 Reidel, C.A. (2020) Behind Closed Curtains: Disinformation on messenger services. Freidrich Naumann Foundation for Freedom.
- 2 Turse. N. (06.04.2020) Misinformation Hampered Ebola Response. The Same Thing Could Happen ëith Coronavirus. The Intercept.
- 3 Дезинформација. Одредница во рамки на Дигитален речник на македонскиот јазик.
- 4 Блажевски, Т. (08.10.2020) Контраспин: Фактите се ирелевантни за ВМРО-ДПМНЕ – за нив Филипче е секогаш виновен. „Вистиномер“.
- 5 Милош Драгојевиќ. (18.4.2020) „Стрипом против диктатуре“. Преведено од „Критинк“ на македонски и албански јазик со дозвола на авторот. Оригиналното објавено на српски.
- 6 Трлевска С. (2020) Мапирање на нивоата на медиумска писменост во Република Северна Македонија кај популацијата на возраст над 16 години, Ресис и Организација за безбедност и соработка во Европа – Мисија во Скопје.
- 7 Стефановски И., Дамјановска М. (2020). Значењето, присуството и свеста за критичко мислење и медумска умешност во медиумската индустрија. „Евротинк“ и „Метаморфозис“.
- 8 Хелсиншки комитет за човекови права. (22.4.2020) Говор на омраза во време на пандемија – зголемен број на пријави по основа на етничка и политичка припадност.
- 9 Никодиновска, В. (септември 2020) Политичка и економска основа на медиумските и на комуникациските модели што шират дезинформации и говор на омраза. Македонски институт за медиуми - МИМ.
- 10 Совет за етика во медиумите на Македонија. (9.10.2020). Истражување на СЕММ: Најчести прекршувања на новинарските стандарди за време на пандемијата.
- 11 Петковски, Љ. (2020) Пандемија или инфодемија? Критичкото мислење и теориите на заговор во време на пандемија. „Евротинк“ и „Метаморфозис“.
- 12 European Policies Initiative (EuPI) of the Open Society Institute – Sofia. (29.11.2019) The Media Literacy Index 2019: Just think about it.
- 13 OECD. PISA.
- 14 Reporters Without Borders. Detailed methodology.
- 15 European Parliament. (2020) Study Requested by the AFET committee: Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them.
- 16 „Мета.мк“ (7.12.202) Во Западен Балкан и Северна Македонија дезинформациите многу често се шират од домашни фактори.
- 17 Hajdu, D. et al. (10.10.2020) GLOBSEC Trends 2020: Central Europe, Eastern Europe and Eastern Balkans at the Times of Pandemic
- 18 „Мета.мк“ (10.10.2020) Анкета: Секој трет граѓанин на земјава верува во теориите за заговори за ковид-19.
- 19 BiEPAG. (15.12.2020) The Suspicious Virus: Conspiracies and COVID19 in the Balkans.
- 20 DW на македонски. (15.12.2020) Во што веруваат Македонците: „Не“ за вакцина против ковид-19, „Да“ за теории на заговор. <https://www.dw.com/mk/a-55947868>.
- 21 „Критинк“. (18.12.2020) Мрежата за медиумска писменост усвои Насоки за етика во истражувањата.

- 22 Влада на РСМ. (27.7.2019). Предлог-план за одлучна акција против ширење дезинформации и против напади врз демократијата.
- 23 "Metamorfozis". (29.1.2020) Publikohet Strategjia për transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019-2021).
- 24 Кривичен законик, пречистен текст од pravo.org.mk. Објавен на веб-сајтот на WIPO.
- 25 МИОА. Закон за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги - консолидиран текст.
- 26 Собрание на Република Северна Македонија. Закон за изменување и дополнување на законот за заштита на населението од заразни болести. Собрание на Република Северна Македонија.
- 27 Shërbimi për Verifikimin e Fakteve në Media. (19.3.2014) Gjuha e urretjes është vepër penale në Republikën e Maqedonisë.
- 28 Bllazheski, T. (12.3.2020) Për shpërndarjen e lajmeve të rrejshme për "Covid 19" mund të përfundohet edhe në burg. "Vërtetmatës".
- 29 Костовски, Љ. (22.3.2019) Антивакцинални кампањи: Требаат ли бели мантили во ААВМУ? „Критинк“. <https://crithink.mk/antivakcinalni-kampa-i-trebaat-li-beli-mantili-vo-aavmu/>
- 30 „Мета.мк“ (27.2.2020) Советот за етика во медиумите повикува за одговорно известување околу корона-вирусот.
- 31 „Мета.мк“ (12.3.2020). ЗНМ и СЕММ со препораки за заштита на медиумските работници во време на ковид-19.
- 32 СЕММ. (15.12.2020) Насоки за инклузивно медиумско известување за ковид-19.
- 33 Kostovski, Lj. (16.3.2020) Epidemia e virusit korona përhapet paralelisht me lajmet e rrejshme. "Vërtetmatës".
- 34 Dervishi, F. (14.3.2020) Si të bëhet raportimi i përgjegjshëm për virusin korona. "KriThink".
- 35 Curi, F. (16.3.2020) Virusi Korona, edhe qytetarët kanë përgjegjësi morale për zhvillimin e "infodemisë" – panikut. "KriThink".
- 36 "Vërtetmatës". (26.10.2020) Filipçes nuk i erdhi në majë të hundës, statusi në Facebook është i rremë.
- 37 "KriThink". (29.10.2020) Dezinformatat nuk u njohën me kohë si kërcënim për demokracinë .
- 38 Jovanovic, N. (22.06.2020) Serbia Under-Reported COVID-19 Deaths and Infections, Data Shoës. BIRN.
- 39 „Струмица денес“. (8.5.2020) НАКЕ ЧУЛЕВ: БАРААТ ДА ГИ КАЗНУВАМ ГРАЃАНИТЕ, НО НЕМА ТОА ДА ГО ПРАВАМ – ИЛЈАДНИЦИ ГРАЃАНИ СЕ БЕЗ РАБОТА И ВО ЛОША ПСИХИЧКА СОСТОЈБА!
- 40 „360 степени“. (16.6.2020) Манчевски: Одговорноста за ширењето на ковид-19 е кај сите, особено кај НакеЧулев.
- „360 степени“. (16.6.2020) Манчевски: Одговорноста за ширењето на ковид-19 е кај сите, особено кај НакеЧулев.
- 41 „Критинк“. (16.6.2020). Како преку дезинформации беше саботирано користењето на апликацијата „Стоп корона“.
- 42 Al Jazeera Balkans. (10.06.2020) Armija troluva protiv aplikacije 'Stop korona'.
- 43 ТВ „Алфа“. (22.04.2020). Заспиј ако можеш?.
- 44 „Мета.мк“ (5.10.2020) „Порталб“: Не е познато колку беше ефикасна апликацијата „Стоп корона“, малку инсталации во споредба со најавеното; Portalb.mk (04.10.2020) S'dihet sa ka qenë efikas aplikacioni "Stop Korona", shumë pak instalime në krahasim me atë çka u paralajmërua.
- 45 Википедија на македонски јазик: Епидемија на големи сипаници во Југославија, 1972.
- 46 Đurić, P. (13.6.2019) Zovem se Žistis... Doktor Benžamen Žistis! Striposlavija.
- 47 „Мета.мк“ (12.4.2019) Списанија за алтернативна медицина ја промовираат Русија на Балканот. „Мета.мк“ (15.1.2020) Списанија за алтернативна медицина продолжуваат да го промовираат култот на Путин во Македонија и во регионот.
- 48 ААВМУ (8.6.2020) Да не се фаворизираат медиуми при споделување информации.
- 49 Лекарска комора на Македонија. (10.6.2020) Соопштение на „Фејсбук“.
- 50 Лекарска комора на Македонија. (8.6.2020) Соопштение на „Фејсбук“.
- 51 Мемети, А. (20.11.2020) Дванаесет часа со Брза помош: Долга и заморна ноќ со исцрпувачка динамика и неиздржлив притисок [фоторепортаж]. „Мета.мк“.
- 52 Grid.mk (5.12.2020) Филипче: „Ремдесивир“ и „фавира“ да се земаат само во консултација со лекарите.
- 53 Лекарска комора на Македонија (14.10.2020) Некролог за д-р Трајче Нешковски.
- 54 Мемети, А. (7.6.2020) Заборавените херои во борбата со ковид-19: портрети на вработените во Итната медицинска помош. „Мета.мк“.
- 55 Bllazhevski, T. (28.2.2020) Kundërs핀: Nuk bëhet fushatë zgjedhore me virusin korona!. "Vërtetmatës".
- 56 Sinadinov, S. (28.4.2020) Kur manipulohet me shëndetin publik: Kush (nuk) dëshiron më shumë zgjedhje këtë verë?. "KriThink".
- 57 Bllazhevski, T. (15.5.2020) Kundërs핀: Nëse mbahen zgjedhjet atëherë sa viktima më pak do të ketë në korrik në raport me qershorin?. "Vërtetmatës".
- 58 Бурнс, М. (14.5.2020) СДСМ и Заев не го подготвиле протоколот за избори. „КриТинк“.
- 59 Блажевски, Т. (26.6.2020) Контраспин: ДУИ како и ВМРО-ДПМНЕ – епидемијата им е ринг за изборни цели. „Вистиномер“.
- 60 #DFRLab. (25.6.2020) Неавтентични фејсбук-страници ја таргетираат Северна Македонија. „Вистиномер“.
- 61 „Мета.мк“ (11.11.2019). Функционери на ВМРО-ДПМНЕ го потврдуваат постоењето на партиска армија на тролови платени да линчуваат по социјалните мрежи.

- 62 „Мета.мк“ (20.7.2018). Руска сајбер-шпионка роварела во Македонија по кумановските настани.
- 63 „Мета.мк“ (30.5.2020). Не е прв пат македонски „фарми на тролови“ да се поврзуваат со „колеги“ од југоисточна Азија.
- 64 „Мета.мк“ (29.5.2020). „Фарми на тролови“ од Македонија работеле за еден од најголемите споделувачи на дезинформации за ковид-19 на „Фејсбук“.
- 65 „Мета.мк“ (4.1.2021) СЕММ одлучи по жалби на „Метаморфозис“: Порталите „Лидер“, „Курир“ и „Нетпрес“ прекршиле членови од Кодексот на новинарите.
- 66 „Нетпрес“. (8.1.2021) Мицкоски во интервју за „Нетпрес“: Заев нека распише избори ако е убеден во својот висок рејтинг, со кој се фали на своите медиуми.
- 67 „Мета.мк“ (7.12.2020) Говорот на омраза против „Метаморфозис“ останува неказнет: „Да ги стреламе или дома да им носиме посмртни венци?“
- 68 СЕММ. (17.2019) Здружението на новинари на Македонија (ЗНМ) и Советот за етика во медиумите на Македонија (СЕММ), на 18 ноември (среда), со почеток во 11 часот.
- 69 „Критинк“. (11.6.2020) Кој прв почна да шири дезинформации за 5Г?
- 70 Ковид-19 Трекер МК. (20.12.2020) Графикон за споредба на нови случаи меѓу земји од регионот на македонски и на албански јазик.
- 71 ХЕРА. (2020) Ковид-19 и СРЗ.
- 72 IFCN.Code of Principles.
- 73 Poynter. (25.1.2021) 10,300 documented falsehoods in 12 months: the CoronaVirusFacts Alliance enters its second year.
- 74 Poynter.The CoronaVirusFacts/DatosCoronaVirus Alliance Database.
- 75 Пол, Р. и Елдер, Л. (2013) Водич на мислителот за логички грешки. НВО-Инфоцентар.
- 76 Спасовски, С. (4.5.2020) Дезинформацијата за 5Г и корона-вирусот ја „засеа“ човек што речиси ништо точно не кажа. „Вистиномер“.
- 77 „Мета.мк“ (6.6.2020) Академик Ќулавкова објави твит со говор на омраза, по неколку часа го избриша.
- 78 Хелсиншки комитет за човекови права. (8.6.2020) Здравствената криза не смее да се претвори во меѓуетничка.
- 79 Хок, А. (26.3.2020) Продолжување на образованието во Северна Македонија за време на пандемијата од КОВИД-19. УНИЦЕФ.
- 80 „Мета.мк“ (14.9.2020) Мила Царовска: Ковид-19 ни покажува зошто ни треба цврст образовен систем (видео).
- 81 „Критинк“. (14.9.2020) Мила Царовска: Децата уште од прво одделение треба да се оспособат да препознаваат дезинформации.
- 82 „Телма ТВ“. (14.1.2021) „Вин-вин“.
- 83 Facebook. Facebook’s Third Party Fact-Checking Program.
- 84 „Метаморфозис“. (30.7.2020) „Фејсбук“ во партнерство со „Метаморфозис“ и „Вистиномер“ започна програма за проверка на факти во Северна Македонија.
- 85 Facebook. Fact-Checking on Facebook.
- 86 Facebook. Program Policies.
- 87 „Вистиномер“. (21.12.2020) Ноторна невестина е дека никој жив не излегол од ковид-центрите.
- 88 „Метаморфозис“. (13.11.2020) Клевета е дека вработени во „Метаморфозис“ бришат содржини од „Фејсбук“.
- 89 Ramadani, A. (25.06.2020) Askush nuk ofron 4,000 mijë euro për të thënë se familjari juaj vdiq nga virusi korona. KriThink.
- 90 „Критинк“. (4.6.2020) Поттикнување етнички и верски тензии со манипулативната лажна вест за Грција.
- 91 „Критинк“. (3.6.2020) „Вечер“ и „Сител“ објавија дезинформација дека Грција забрани влез за жителите од македонските општини со најмногу заразени.
- 92 Bafqari, A. (04.06.2020) Nuk është e vërtetë që Greqia ka mbyllur kufirin për banorët e disa komunave të Maqedonisë së Veriut!. KriThink.
- 93 Даути, Н. (13.7.2020) Полицијата нема да влезе по приватни куќи поради ковид-19. „Критинк“.
- 94 СДК (17.10.2020) Амди Бајрам прави свадба за внуката во Истанбул со 200 гости од Македонија, поради ковид-забраната за семејни собирања дома.
- 95 „Мета.мк“ (24.10.2020) Филипче: Амди Бајрам имаше многу хронични болести.
- 96 „360 степени“. (24.10.2020) Амди Бајрам бил позитивен на ковид-19.
- 97 „Фокус“ (25.10.2020) Синот на Амди Бајрам за „Фокус“: Ова е нашата вистина!
- 98 Бурнс, М. (26.10.2020) Никој не е ни крив ни должен што Амди Бајрам не беше погребан по протокол за починати од ковид-19. „Слободен печат“.
- 99 Istinomer (8.4.2020) Mediji u regionu prenose neutemeljene tvrdnje makedonskog profesora. „Мета.мк“ (8.4.2020) Медиуми во регионот пренесуваат невтемелени тврдења на македонскиот професор.
- 100 Кукубајска, М.Е. (1.10.2021) Проф. д-р ВЕЛО МАРКОВСКИ, добитник на награда за проучување на ковид-19. Македонска нација.
- 101 Time.mk. Истакнатиот епидемиолог Вело Марковски нов член во Извршен Комитет на ВМРО-ДПМНЕ.
- 102 „Вистиномер“. (9.12.2020) FDA не утврдила нус-појави на вакцините против ковид-19.
- 103 Око да види. (11.12.2020) Пост на „Фејсбук“.
- 104 DFRLab. (30.09.2018) #ElectionEatch: Inauthentic Activity Tested Ahead Naming Referendum.



ANALIZA E DEZINFORMATAVE LIDHUR ME COVID-19 NË MAqedoninë E VERIUT



**FRIEDRICH NAUMANN
FOUNDATION** For Freedom.
North Macedonia

METAMORPHOSIS 
Fondacion për internet dhe shoqëri